


BIBLIOTEKA

E

854-32
JM 62

SHTETIT

GJIROKASTËR



" SHKALLËT E GURTA

BIBLIOTEKA E RINISË

SHKALLËT E GURTA

~~465117~~

2478

BIBLIOTEKA E SHKOLLËS
GJIRKASIA

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

FYTYRAT E THJESHTA TË HEROIZMIT

Është natë. Bën ftohtë.

Ne jemi mbledhur rreth zjarrit. Disa i ka zënë gjumi të mbështjellë me kapotat e trasha ushtarake. Të tjerët zgjatin duart drejt flakëve dhe ndjekin lodrën e tyre gazmore nëpër errësirë.

Lodra e flakëve të shtie në mendime edhe kur je i lodhur nga një marshim i gjatë e i vështirë.

— Sa duar të lëmuara paske ti, — më drejtohet një fshatar dhe buzëqesh. — Duar të pvrara...

Të tjerët vështrojnë duart e mia, siç do të kishin parë një eksponat interesant muzeumi. Edhe unë vështroj pëllëmbët dhe qesh. Pak gjurmë ka lënë koha e punës fizike.

Fshatari më rrëfen pëllëmbët e veta. Duar më të mëdha kisha parë, po kallo të atilla nuk më kish zënë syri ndonjëherë. Gjithë pëllëmba ishte mbuluar nga një shtresë e verdhë, e trashë, e ashpër dhe e plasaritur.

— Kam katër vjet që punoj në kanale, — i përgjigjet ai hutimit tim. — Dhe kryej dy, nganjëherë edhe dy norma e gjysmë në ditë...

Fytyra e pjekur nga dielli ka marrë atë ngjyrë të bukur, që u shton hijeshinë bardhoshëve. Faqet i ka të rreshkëta. Dallohen mirë eshtrat e mollzave. Vetullat e trasha ngjyrë kashte u qëndrojnë përsipër syve të mëdhenj e të menduar. Sa ka mbushur të tridhjetat.

E kisha vënë re edhe më parë. Ishte i hedhur, i qetë, i sjellshëm dhe i gatshëm për të kryer çdo detyrë, edhe kur të tjerët ankoheshin prej lodhjes.

Të them të drejtën, për këto arsye, edhe pyetja e tij m'u duk e çuditshme dhe e papritur.

Duke kujtuar se u preka në sedër, ai shtoi:

— Nga këmbët, ama, qenke i fortë... Nuk ma priste mendja të mbaheshe gjatë marshimit... Si thonë shaka: njëqind e dyzetë kilometra rrugë malore...

Dhe kështu lindi një bisedë e zjarhtë për punën fizike e për intelektualët, për ekonominë dhe për jetën ushtarake.

Pas pak dikush tha:

— Mirë, o Shahin, po tregona atë historinë me diversantët.

Shahini, kështu e quajné fshatarin me duar të mëdha, kroi kokën:

— Histori e vjetër ajo... dhe pa rëndësi... Kushdo ashtu do të kish vepruar...

Prej të tjerëve mora vesh se ai e kish kryer shërbimin ushtarak në një nga postat kufitare të veriut.

Një natë, duke patrulluar, kish rënë në gjurmët e një grupi diversantësh. Ndodheshin në mes të pyllit. Dy ushtarët e patrullës i vendosi në shtigjet nga mund të kalonin shkelësit e kufirit dhe vetë ecte me hamendje nëpër errësirë me automati-

kun gati për zjarr. Diku ndaloi dhe u mbështet pas trungut të një pishe. Qe larguar shumë prej shokëve dhe, ndërsa mendonte në duhej shkuar më thellë, apo në do të qe më mirë të kthehej te ushtarët, para tij dolën tri hije të mëdha e të zeza, më të zeza se nata. Ecnin ngadalë, në heshtje, pranë njëra tjetrës.

Shahinit i rrahu zemra. Gjer atëhere ai kish qëlluar me automatik kundër tabelave prej letre, qe përlëshur me dordoleca mësimorë dhe kish dëgjuar nga oficerët si duhet luftuar kur gjendesh vetëm dhe si duhet përballuar armiku në ndeshjet trup me trup... Po ndryshe është kur ndodhesh për herë të parë në rrethana të tilla.

Hijet ndalën. Një kërcitje degësh të thata i trembi...

— Tre me një, — mendoj Shahini. — Rrugë tjetër nuk ka... — dhe zbrazi kundër hijeve gjithë krëhërin e fishekëve.

U ndie një britmë, ca ulërime dhe lëvizje të shpeshta e të shpejta gjethesh. Pastaj qetësi. Qetësi dhe errësirë.

— Po tani?

Tani fillonte pjesa më e vështirë e ngjarjes. Prapë dy rrugë: të kthehej prapa, ose të shkonte përpara, drejt errësirës, drejt rrezikut. Llambën e dorës nuk mund ta ndizte.

— Duhet parë ç'ka ndodhur, — vendosi ai dhe eci përpara me ngadalë dhe i shqetësuar.

Në mes të shtegut dalloj diçka të zezë, që përpëlitej. Ju hodh përsipër. Ishte njeri.

— Në Jugosllavi ndodhem? — pyeti njeriu serbisht; po Shahini s'kish nge t'i përgjigjej. I përdrodhi krahun, gjersa i krisi kocka e shpatullës dhe e lidhi.

Ndërsa shokët flisnin, heroi i kësaj historie ngrohte duart e mëdha, i hidhte shkarpa zjarrit dhe dridhte cigare të trasha me duhan kaçak.

— Ç'fytyrë të thjeshtë kanë trimëria dhe heroizmi, — më shkrepri në kokë dhe aty, pranë zjarrit, m'u kujtua një tjetër ndodhi burrërie.

U ndodha para disa ditësh në një mbrëmje gazmare të të rinjve të artizanatit të Lushnjës. Ata këndonin, kërcenin, recitonin vjersha, bisedonin shok me shok. Ngado shihje fytyra të qeshura e dëgjoje zëra të gëzuar. Mbrëmjen e kishin organizuar për të festuar së bashku shtatëmbëdhjetë vjetorin e lindjes së shokut të tyre, Stavrit, i cili, kohë më parë, për të shpëtuar një automjet, që i kish marrë zjarr motori, u hodh në mes të flakëve të benzinës. Automjeti shpëtoi, po ai u dogj keq dhe u dergj disa muaj në spital. Mjekët luftuan me vdekjen, ashtu siç pat luftuar Stavri me flakët. Në fillim shpresat e shpëtimit qenë të pakta, por kalonin javët, kalonin muajt dhe vdekja sa vente largohej.

Për këtë trimëri të djaloshit gjashtëmbëdhjetëvjeçar kisha dëgjuar edhe nga një raport i mbajtur në mbledhjen e komitetit të partisë së rrethit, edhe në konferencën e rinisë. Lexova edhe dy artikuj gazetash, po nuk e kisha njohur.

I hodha një sy sallës së mbrëmjes dhe, ndër **mjet të rinjve e të rejave**, nuk dallova dot ndonjë «hero». Të gjithë qenë të thjeshtë, të gëzuar. Dëshja të pyes ata që kisha pranë, po vendosa ta gjeja vetë cili ishte heroi.

Një përfaqësues i organizatës së rinisë foli diçka për Stavri Priftin, lëvdoi guximin dhe vetmohimin e tij. Të rinjtë duartrokëtinin. Unë vësh-

troja i hutuar dhe nuk e zbuloja që nuk e zbuloja dot atë që më interesonte aq shumë.

Orkestra mori një valle popullore. Ndër ata që u ngritën të vallzojnë ishte edhe një çunak me flokë të qethura, me fytyrë të bardhë e rrumbullake. Kish veshur një palë rrobe të reja, që i rrinin të gjëra. Siç dukej, i kish blerë të gatshme dhe nuk qe kujdesur t'i provonte në i rrinin pas trupit. Ai kapi valltarin e fundit nga dora dhe vinte rrotull, duke u munduar ta hedhë hapin sipas ritmit të valles.

Ndjeva një erë të fortë formaline.

— Po kjo, ç'është ?

— Ende nuk është shëruar mirë, — më tha ai që kisha pranë.

— Kush?

— Stavri, — dhe më tregoi me dorë çunakun, që mundohej të ndiqte ritmin e valles.

Kështu më ndodhi në atë mbrëmje, kështu po më ndodhte me Shahinin dhe, për çudi, edhe dy ditë më vonë, një tjetër ngjarje ma forcoi bindjen se fytyra e heroizmit është aq e thjeshtë, sa edhe e madhërishtë.

Po kalonim Shkumbinin me repartin e rezervistëve. Dielli kish perënduar. Uji ishte i ftohtë. Thellësia e kalonte metrin.

Ushtari rezervist, Tafili, hyri në lumë duke tërhequr për kapistre kalin e ngarkuar me pajisje lufitarake dhe me një arkë predha mortaje.

Kafsha ecte me vështirësi; hidhte dy hapa dhe ngulte këmbët e para në zall, tundte kokën me kryeneçësi dhe e mundonte ushtarin, që e mbante fare pranë gojzës.

Kur mbritën në mes të lumit dhe uji preku barkun e kalit, ky u tremb, turfulloi e u hodh për-pjetë i egërsuar. Samari kërciti. Arka dhe pajisjet u shkundën fort. Tafilit ju morën këmbët dhe e mbuluan djersët. E shtrëngoi edhe më shumë litarin me një dorë, kurse me dorën tjetër mundohet të mbante samarin, që zu të anonte nga e djathta. Pa bregun. Kishin mbetur edhe njëzet e ca metra gjer në zall. Sa pak dhe sa shumë!..

Kafsha, e egërsuar, që ndofta nuk kish kaluar herë tjetër nëpër lumë, hidhej për-pjetë dhe nuk i bindej më ushtarit. Ajo donte t'i shpëtonte nga duart dhe të vraponte ku të mundte. Po ai nuk e lëshonte. Hiqej zvarë prej saj dhe i kish vënë supin barrës, që anonte gjithnjë më tepër. Rripat qenë liru-ruar e këputur.

— Ja, edhe pak, — i jepte zemër vetes Tafil Mango, i kanosur nga lumi dhe nga kafsha e hazdisur. Vdekja e priste në çdo sekondë, në çdo hap që hidhte.

— Lëshoje kalin. Shpëto veten, — i thoshte një zë.

— Jo. Unë jam ushtar; unë do të kryej detyrën, — i përgjigjej ai thjesht dhe me vendosmëri ndjenjës së frikës dhe zvarrisej bashkë me kalin drejt bregut të lumit. Nuk trembej se do ta ndëshkonin, se askush nuk do ta bënte fajtor në atë rast, po ndjenja e detyrës e shtynte të shtrëngojë dhëmbët, të tendoste nerva e muskuj dhe të shpëtonte pasurinë e popullit.

Pas disa minutash vetmohimi e gjakftohtësie, Tafili doli në zall bashkë me kalin që shkumëzonte ende. Ai mori frymë thellë dhe ndjeu drithma të forta në të gjithë trupin e lagur. Djersë të ftohta i

mbuluan ballin. U zverdh. Kërkoj vend të ulej dhe, sakaq, humbi ndjenjat.

Ta shohësh edhe Tafil Mangon, zor të mendosh se mund të bëjë heroizma. Është trupvogël, i zeshkët dhe i rreshkur. Po a ka rëndësi gjatësia e pesha e trupit?

Është natë. Bën ftohtë.

Tani ushtarët kanë fjetur. Edhe unë jam mbështjellë me kapotën e trashë ushtarake dhe mundohem të dremit. Si edhe dy net më parë, prapë më vërtiten në kokë mendime për thjeshtësinë e për madhësinë e heroizmit, që tani e gjen kudo në jetën tonë të përditshme.

ATJE KU NDAHEN DY BOTË

Pas një rruge të gjatë e të lodhshme, mbrritëm më në fund atje ku ndahen dy botë. Cili është ky vend? A ka këtu diçka të jashtëzakonshme? Po, ka! Me të vërtetë këtu ndodhin ngjarje që nuk takohen në çdo vend e që të mbushin me frymzim të zjarrtë.

Hedhim sytë rreth e rrotull dhe na lindin në shpirt emocione të forta. Këto emocione na i shkaktojnë pikësëpari njerëzit tanë, fytyrat e të cilëve, qysh në vështrimin e parë, duket sikur pasqyrojnë krenarinë dhe ashpërsinë e maleve. Natyra mëmë çfaqet para nesh me një madhështi të heshur: malet këtu u ngjajnë jataganëve të mprehtë, që çajnë tufat e bardha të reve, ndërsa kodrat, me atë kurorën e blertë të bredhave mbi krye, na paraqiten me një pamje më pak të ashpër. Në një kodër të tillë, të mbështjellë nga «rroba» e gjelbër e një flore të pasur e të gjallë, dallojmë një shenjë të gurtë. Ç'është ajo? Afrohemi së bashku me shoqëruesin dhe shohim në njërin faqe të saj stemën e Republikës sonë Popullore. Është piramida e kufirit. Pra, ne kemi arritur në një nga pikat më ekstreme të atdheut tonë. Kemi të drejtë të vimë deri këtu. Është toka jonë, ajo tokë e lagur me gjak e

Jjersë, që na e kanë lënë gjyshrit dhe stërgjyshrit. Ne emocionohemi. Dikur kjo piramidë shërbente vetëm si një shenjë e thjeshtë kufiri, që ndante gjeografikisht dy shtete. Tani ajo ndan dy botë, dy sisteme të kundërt, dy ideologji. Andej jeta është një epokë prapa jetës sonë, shkurt, tjetër jetë. Kënde jeta socialiste i ka fshirë e shkallmuar themelet e botës së vjetër, ku një aparat tiranësh pinte gjakun e njerëzve të thjeshtë. Dhe është kjo piramidë që i vë përballë këto dy botë, duke i prerë si një kufi gjeografik dhe, në të njëjtën kohë, politik. Bri kësaj shenje të thjeshtë qëndron kufitar Deda. Aty ja ka caktuar vendin atdheu. Dhe brezi gjarpërues i piramidave, që qarkon trupin e mëmës Shqipëri, i ka falur atij emrin simbolik «kufitar». Për këtë truall të rilindur, për këtë tokë shqiptare, që Xhorxh Bajroni e quajti «mëmë e ashpër e burrave të rreptë», kufitarët vigjilojnë ditë e natë me një ndjenjë përgjegjësie shumë të thellë.

Guxim dhe gjakftohtësi

Dy të panjohur lëviznin në brendësi të kufirit tonë, duke rrëshqitur ngadalë nëpër gjethe, si ujku në mjegull. Ishin të vëmendshëm e të përqendruar dhe hetonin rreth e rrotull tërë sy e veshë, si të donin të gjenin një send të humbur me vlerë. Dikush i pa nga larg dhe s'u bëri zë. Ishte pionier Engjëllushi, që i vuri re gati sa po hodhën këmbë për t'u futur në pyll. «Ç'të jenë këta?» — mendoi ky djallë i vogël 11 vjeçar. Ndënji një copë herë në përgjim dhe, duke ju shmangur shikimit të tyre, da-

lloi se të panjohurit nuk ishin banorë të fshatrave kufitare, po njerëz të veshur krejt ndryshe, të armatosur me pistoletë dhe të pajisur me çanta shpine. Mjaftoi vetëm kaq për ta bërë këtë fëmijë serioz. Naiviteti miturak ju largua në çast dhe fytyra i mori një pamje të rreptë. Zemra e njomë filloi t'i rrihte me forcë. Faqet po i digjnin. Një nxehtësi e brendshme ja pushtoi gjithë trupin. Ishte trubulluar. Po e brente një shqetësim i natyrshëm. «Këta janë shkelësa», — tha me vete, — dhe para tyre ndodhem vetëm unë. Ç'të bëj? T'u afrohem, t'i pyes cilët janë e ç'kërkojnë që sillen poshtë e lart? Mirë, le ta zemë se duhet vepruar kështu, por ç'del nga kjo? Ata janë dy. Unë jam vetëm. Ata kanë armë, unë s'kam asgjë. Ata janë burra, unë... Jo, jo kështu, se nuk fitoj, pohumbas. Duhet të lajmëroj kufitarët. Duhet t'i le ata të ecin, ndërsa vetë të zmbrespem».

Dhe «u tërhoq» në fshehtësi të plotë e pa u ndjerë. Kur doli pas një kthese, ja dha vrapit. Njeriu i parë, që takoi në këtë maratonë të shpejtë, ishte Deda.

— Shkelësit, shoku rreshter! — foli pionieri.

— Ku, mor Engjëll?

— Pas meje, shoku rreshter!

Dedë Markut i tingëlluan këto dy fjalë si një urdhër.

Ai e dëgjoi pionierin dhe, të dy së bashku, si dy kufitarë të regjur, u nisën me shpejtësi.

Më në fund, para syve të Dedës, gjithçka doli e qartë si në pëllëmbë të dorës. Engjëllushi nuk kishte gabuar. Rreshteri mori frymë thellë dhe zuri pozicion. Pionieri filloi të vepronte sipas porosive të Dedës, kurse ky jepte udhëzime me zë të ulët:

«Vrojto, Engjëll, mos lëviz! Qendro si trim!...»
Dhe fëmija e dëgjonte rreshterin si një ushtar i bindur.

Shkelësit vazhdonin të afroheshin. Ata nuk kishin nuhatur se aty pranë ndodheshin dy roje. Kur largësia u shkurtua së tepërmi, Engjëllushi ktheu sytë nga kufitari dhe e pa me një vështrim pyetës.

— Bjeru, Dedë!... Çfarë pret akoma? Ja ku i ke. Janë afruar shumë. Bjerul!...

Kështu deshte të fliste pionieri, po një zë i heshtur, i brendshëm, e ndaloi. Ishte zëri i ndërgegjes që e urdhëronte të heshte: «Deda është kufitar dhe e di mirë si duhet vepruar», — mendoi pionieri me vetvete.

Pranë tij ndjehej i sigurtë dhe i fortë. Mirëpo bebet ngjyrë gështenjë i qenë zmadhuar dhe i shkrepëtinin. Në to dukej sikur qe ndezur një flakë e furishme. Ishte flaka e urrejtjes, që pasqyrohej me aq duf.

Minutat rrëshqisnin ngadalë, shumë ngadalë. Në çaste të tilla të krijohet përshtypja sikur gjithçka gozhdohet në vend, s'ecën! Vëmendja e Dedës përqëndrohet vetëm në një pikë. Gjithë mendimi i tij punonte vetëm atje, te shkelësit. Asgjë s'pipërinte dhe s'lëvizte përveç tyre. Vetëm ata rrëshqisnin si hije dhe afroheshin pa u ndjerë. Po! Gjithmonë afroheshin. Deri kur vallë kështu? Deda pret. Deda qendron. Ai disiplinon dhe shtyp çdo pasion të brendshëm, që çon krye në thellësinë e shpirtit të vet. Atdheu e urdhëron të durojë, të përmbahet e të mos shpërthejë ende. Kjo vetpërmbajtje e rreptë e ka burimin në vetëdijen e tij; ajo rrjedh nga mendimi i kthjellët dhe i palëkundur se shke-

lësit duhet të kapen të gjallë. Atdheu ka nevojë për gjuhën e tyre. Po, për gjuhën. Po, në çaste kaq dramatike, zemra nuk i nënshtrohet me lehtësi mendjes. Ajo preket shpejt e thellë, ajo dhëmb e digjet nga një flakë ndjenjash, që ngrihen si një tallaz i furishëm rrëmbyes. Kjo flakë gati e përfshiu edhe Dedën kur shkelësit ju afruan jo më shumë se 30 metra. I dukej se këta të panjohur tani nuk po shkelnin më në tokë, po mbi trupin e tij.

Ishin sekondat më të rënda. I bëhej sikur çdo «tik-tak» i zemrës shndërrohej në tinguj dhe sikur këta tinguj kishin këtë kuptim: «Ç'pret, ç'pret!» Me të vërtetë kufitarit po i fliste zemra e po i thoshte: «Ata janë dy, ti je vetëm. Mos prit sa të të hidhen në fyt e të të zënë frymën. Asgjësoi, pra! Tik-tak... Ç'pret! Tik-tak... Bjeru! Tik-tak... Qëllor!»

Dhe, ndërsa përballonte këtë tallaz të brendshëm të shpirtit, ju kujtuan fjalët e zjarrita të Çajupit, të cilat kufitarët i kanë bërë si të tyret:

*Luftën, që prish njerëzinë,
nuk do ta doja kurrë!
Po, në më shkelshin kufinë,
do luftoja si burrë!*

«Ja, kufirin e kanë shkelur. Prejua duart këtyre prishësve të qetësisë. Mos u ngut Dedë, — i thoshte një zë tjetër. — Duhet të presësh ende. Durim deri në fund, deri atje ku s'mban. Le të aviten, hesht. Le të hedhin hapa të tjera, hesht. Le të afrohen deri 10 metra, prapë hesht. Edhe 7 metra të vijnë, mos nxirr zë. Pastaj asnjë centimetër më tepër.»

Dhe, me këto mendime në kokë, rreshteri nën-

shtroi gjithë ndjenjat e mendimet e tjera. Kuptohet se atij ju desh një vullnet i hekurt për të qendruar në këtë gjendje. Ky ishte një duel i heshtur, që vinte në provë vetitë e tij më të larta si kufitar, një duel plot ankth, ku kërkohet gjakftohtësi shembullore dhe trimëri, ndjenjë përgjegjësie dhe nerva shumë të forta. Merrni me mend vetë ç'do të thotë t'i lesh dy kundërshtarë të armatosur të afrohen aq pranë, sa mund t'u ndiesh madje edhe frymëmarrjen.

Po, kështu ngjau. Pikërisht në ato çaste kur ai po ndjente me të vërtetë frymëmarrjen e tyre, u bë ballafaqimi i befasishëm dhe i rreptë. Një thirrje e furishme urdhëronjëse u duk sikur buçiti nga dheu: «Ndal! Duart lart». Ata ngrinë në vend. Ngrinë si dy qenie të dobëta dhe fytyra u mori menjëherë ngjyrën e dheut.

Fjalët e prera «Mos lëvizni, duart lart, kthehuni prapa», në fillim sikur nuk u kuptuan mirë nga këta «mysafirë» të paftuar, sepse njeri prej tyre vuri dorën, dorën që i dridhej, te pistoleta, po nuk arriti, pasi një zë i hollë, i mprehtë si thikë, u bëri të qartë të dyve të mos luanin me zjarrin. Ky ishte zëri i Engjëllushit, i cili përsëriti në gjuhën e shtetit fqinj fjalët e prera të Dedës: «Duart lart! Asnjë lëvizje tjetër! Përndryshe do të qëllojmë!»

Shkelësit u detyruan të vepronin pikërisht kështu: ngritën duart dhe ulën kryet, duke mbajtur mbi supe barrën e turpit.

Ishte ditë vjeshte e tetorit 1964. Nga drurët binin gjethet e verdha. Frynte erë dhe atyre u dridhej trupi si një purtekë e thatë.

Lajmi se Deda kapi dy shkelësa kufiri u përhap

me shpejtësinë e rrufesë. Atë ditë, në postë, jeta mori një notë epike më të fuqishme dhe zemrat kufitare, që rrahin vazhdimisht për atdhenë, i falën trimit shprehjet më të zjarra të dashurisë e të mirënjohjes. Kurse pionierin, vëllain e tyre të mitur, kufitarët e puthnin dhe e shtrëngonin në gjoksin e fortë si ta kishin birin dhe vllastarin më të njomë të familjes së tyre, duke e pagëzuar me emrin e bukur: «Kufitar i vogël». Dhe në këtë ngazëllim ndjenjash, sytë e mprehtë, të gjallë e plot dritë, si shpuzë, të fëmijës ngjanin me të vërtetë si dy sy shqiponje.

Ky lajm mbushi plot frymëzim edhe banorët e brezit kufitar.

Sa e sa herë këta njerëz të thjeshtë janë ndodhur në të njëjtat pozicione me kufitarët, sa e sa herë këta kanë dalë në të njëjtën vijë për të mbrojtur kufirin nga shkelësit. Mjafton një shenjë, mjafton një krismë pushke, që radhët e kufitarëve të dhjetfishohen në çast. Populli, ky popull që punon dhe jeton me kazmë e pushkë bashkë, është i lidhur ngushtë me ta. Prandaj edhe gëzimet i ndajnë së bashku. Këtu, më shumë se në çdo vend tjetër, njeriu e ka të vështirë të dallojë ku fillon reparti e ku mbaron kooperativa. Të gjithë janë ushtarë, të gjithë çohen menjëherë në këmbë kur i thërret atdheu. Pra, këtë truall arbëresh nuk e ruajnë vetëm kufitarët, po e ruan gjithë populli. Për këtë arsye një diversant tha njëherë: «Popullit s'kishim si t'ja bënim! Popullin s'e vret dot. Mund të vrasësh një, por qindra të tjerë të dalin përpara e të zënë frymën».

«Ku jemi këtu?» pyet një i panjohur

Bariu Kristofor, me brucën krahëve dhe i mbështetur në kërrabën, vështronte shpërthimin e zemërimit të natyrës. Bubullimat tronditnin dheun dhe shkëmbin, sikur atje lart, mbi retë e ngarkuara me shi, të bënin qitje bateritë e rënda të artilerisë. Rrufetë, si thika të zjarrta, çanin kryq e tërthoras qiellin mbi male. Shiu filloi të binte me shtëmbë. Ujrat rridhnin gjithnjë e më rrëmbyeshëm tatëpjetë e përrrenjtë erdhën duke u fryrë e duke zbritur poshtë me zhurmë. Papritmas, ai pa në të dalë të pyllit një njeri, që, pasi eci disa çapa, u struk prapa një shkëmbi. «Po ky pse u fsheh? — tha me vete Kristofori. — Duhet të tregohem i kujdesshëm e gjakftohtë». Pa e hequr vështrimin nga shkëmbi, nxori thikën e filloi të presë një ashkël.

«Me thikën është vështirë të bëj gjë. Sigurisht që ai do të jetë i armatosur». Hodhi sytë nga vija kufitare, e cila nuk ishte më larg se dy km. «Ah, të shkretën, që nuk shoh asnjë kufitar. Si të veproj, ta le të iki?!» Në këto çaste ju kujtua i vëllai, që vdiq nga torturat në kampet naziste në Gjermani, ju kujtua i nipi, Theodhori, që, gjatë Operacionit të qershorit të vitit 1944, u plagos dhe jetoi 9 ditë vetëm në një shpellë, pa mjekim dhe ushqim, po që nuk ju dorëzua vdekjes, se atdheu e thërriste sërishmi në beteja të tjera dhe ai jetoi e u vra më vonë, si burrat, në tokat e Jugosllavisë. «Jo, jo, kurrë! Kjo do të ishte një mohim i gjakut që ata derdhën për të jetuar ne të gëzuar e të lumtur. Jo! Si do të dilja para gruas, djalit, vajzës, fshatarëve dhe kufitarëve që më duan e më respektojnë. Jo! Më mirë të vdes me nder, se sa me damkën e turp

në shpinë. Do të kacafytem me të derisa të më rrahë zemra. Le ta dinë armiqtë se me kë kanë të bëjnë».

Fillin e mendimeve Kristoforit ja ndërpreu lëvizja e të panjohurit. Megjithëse 62 vjeç, sytë i kishte të fortë. E pa atë të vraponte nga një shkëmb në tjetrin. I panjohuri ishte zverdhur në fytyrë. Me sy të çakërritur shikonte vetëm në drejtim të bariut.

Në çast Kristoforit i erdhi një mendim: të fliste me të në gjuhën e shtetit fqinjë, të cilën ai e zotëronte.

— Mirëmbërëma, zotëri!

I panjohuri, duke mbajtur njërën dorë në xhepin e xhakëtës, ku linte të dukej arma, tha duke skërmitur dhëmbët e tij të mëdhenj:

— Ç'bën ti këtu?

— Nuk ju kuptoj.

— Si, nuk dini të flisni shqip? — pyeti ai me një greqishte të kulluar.

— Jo! Megjithëse jemi në kufi me Shqipërinë, di vetëm disa fjalë shqip.

— Pse, ku jemi këtu?

— Në Greqi. Pse ti ku kujton se je?

I panjohuri qeshi me të madhe. Por në çast, me një lëvizje të shpejtë, e kapi Kristoforin për gryke dhe, duke i ngulur sytë e tij të venitur, tha:

— Në rast se më gënjen, nuk ke për të shpëtuar i gjallë. Prandaj, sa nuk është vonë, thuam të vërtetën se ku ndodhemi, sepse nuk më leverdis të të vras.

Kristoforit i hipi gjaku në kokë: «Po sikur ta qëlloj me thikë? Jo, ai është i armatosur dhe përpjekja ime do të shkonte kot. Prandaj më mirë të vazhdoj «lojën».

— Mor po ti qenke i çuditshëm. Pse ç'interes kam që të gënjej? Ja këtej, — vazhdoi ai duke zgjatur dorën nga e djathta, ndodhet posta greke, që nuk mban as gjysmë ore që këtu.

I panjohuri tërhoqi dorën dhe, duke qeshur si me zor, tha:

— Mos m'u zemëro. Mendoja se isha ende në tokën shqiptare. Tri ditë e tri net u sorollata nëpër male e pyje. Më kalbi shiu, u thava nga të ftohtit. U mundova të kaloj kufirin nga ai sektor që hyra në Shqipëri, po qe e pamundur. Kufitarët e tyre e ruajnë mirë kufirin dhe nuk ua hedh dot. Pastaj ata kanë me vete edhe popullin. Edhe ai që të duket si i humbur është gati të japë edhe jetën, bile pa para, për të ndihmuar kufitarët.

— Po, kam dëgjuar se, kush hyn në Shqipëri, zor se kthehet i gjallë këtu. Po ty të lumtë, se ke shpëtuar për mrekulli. Të ka ndihmuar zoti.

— Kam nevojë të pushoj sa më parë, — tha i panjohuri duke u dridhur nga të ftohtit. — Prandaj të lutem më përcill deri në postën greke.

— Mirë, po të shoqëroj, vetëm më ndihmo të vë bagëtinë në vath.

Ndërkaq, errësira e natës pushtoi gjithë vendin, ndërsa shiu vazhdonte të binte me rrëmbim. Kristofori mbylli lesën, hodhi torbën krahëve dhe ai para e i panjohuri nga pas filluan të ecin drejt një rruge të ngushtë këmbësore, që varej drejt malit të thepisur.

... Rrezet e dritës, që dilnin jashtë një shtëpie të vogël, ja ngrohën zemrën Kristoforit. «Rëndësi ka që ta kapim të gjallë», — tha me vete.

— E kujt është kjo shtëpi? — tha i panjohuri.

— E imja.

— Po posta ku është?

— Ja atje, pas asaj bregores.

«Do ta çoj drejt e te kufitarët tanë. Po bëri përçapje të largohet, do t'i hidhem në fyt», — mendoi me vete. Duke zgjatur kërrabën në drejtim të shtëpisë, ju drejtua të huajit:

— Na urdhëroni për një vizitë në shtëpi.

— Jo, të faleminderit.

«Po tani si të veprojmë? E gjeta».

— Atëhere pritni një minutë që t'i them gruas të mos mendojë djalin në mal për të më sjellë darkën.

E ndërkaq u nis në drejtim të shtëpisë.

I panjohuri nuk pati kohë as të ulej mbi një gur. Një zë nga errësira e bëri të dridhej si purteka. Sa bëri çapin e parë, ndjeu një zë tjetër, këtë radhë fare afër dhe nga prapa:

— Duart lart! Mos lëviz!

PËR JETËN E SHOKUT

Përgjegjësi i ndresës hodhi armën në krah, rregulloi rripin e mesit e tha me gjallëri:

— Shërbimin e kryem. Po njëri nga ne duhet të qëndrojë këtu derisa të vinë shokët. Qendro ti, Gjon.

Ushtar Gjoni u mat të fliste, po u mbajt. Nuk desh t'i pengonte shokët. Ata duhet të ktheheshin sa më parë në repart.

Ashtu si ish, i veshur e i ngjeshur me kapotë dhe armë, përcolli me sy shokët. Nuk ndjehej fort mirë atë ditë. Herëpashere i kalonin mornica në trup. «Pagjumësia..., lodhja...» mendonte. Mbledhi një dorë bluashka dhe shkoi pranë zjarrit, që ta ushqente edhe njëherë flakën e kuqe që po venitej. Po, kur arriti aty, ju bë sikur një dorë e hekurt ja shtrëngoi trupin dhe, me një fuqi të pabesueshme e shpejtësi të tmershme, që shtohej pareshtur, e rrotulloi, në fillim në rrathë të mëdhenj, koncentrikë, pastaj në rrathë gjithnjë më të vegjël e më të vegjël, gjersa, më në fund e përplasi me vrazhdësi në qendër të këtyre rrathëve... Gjon Lleshi u shemb pa ndjenja mbi zjarr.

Në repart ka rënë heshtja. Bisedat, këngët, shakatë janë prerë, sikur të jenë djegur në zjarr bashkë me shokun e tyre. Ata e dinin që mjekët atje, në spital, përpiqeshin t'i shpëtonin jetën ushtar Gjon Lleshit dhe prisnin tërë ankth lajme... Ja, borizani thërret repartin të rreshtohet. Vështrimet e ushtarëve pyesin komisararin: «A do të shpëtojë?» «A do të shpëtojë?». Po komisarari nuk i jep dot përgjigje kësaj pyetje, nuk i ngroh dot zemrat që përpëliten në ankth. U foli siç i tha zemra.

— Ju e dini ç'ka ndodhur... Një ushtar, një shoku ynë, është në rrezik të madh. Mjekët kërkojnë ndihmën tonë.

— Ç'duhet të bëjmë? — ja preu dikush fjalën, që nga rreshti.

— Duhet t'i japim shokut nga lëkura jonë. Kush është gati të operohet bashkë me Gjon Lleshin, t'i japë atij diçka nga trupi i vet, ta armatosë që të luftojë më mirë me vdekjen?

— Unë! — thirri dikush. Pastaj u dëgjua: «Të gjithë jemi gati». Tërë reparti ishte gati të luftonte për jetën e shokut.

Komisari u mallëngjye dhe i erdhën ndërmend këto fjalë, që kish lexuar diku: «Miqësia, shoqëria e vërtetë është poezia e jetës».

— Nuk duhen shumë për sot. Vetëm gjashtë, — tha mjeku.

— Atëhere, më parë se kujdo, na takon ne, mirditasve.

— Edhe ne, malësorë si ju jemi, e na takon, — thanë disa të tjerë.

— Ai u dogj në krahinën tonë e ne do të japim çdo gjë për të, — u hodhën beratasit.

Po syri i mjekut zgjodhi shpejt gjashtë ndër-
mjet repartit vullnetar. Me të tjerët u nda me një
premtim: do t'i thërriste kur të paraqitej prapë
nevoja.

* * *

Tre ushtarë qendrojnë të palëvizur në shtre-
terit e tyre. Duken të «qetë», po sytë e ndezur, si
ndër ethe, i tradhëtojnë.

— Fejzi Saljani, nga Moglica e Korçës, Bezat
Xhaxhi, nga Dushniku i Beratit, Dilaver Beçaj,
cakranjot — m'i paraqiti mjeku dhe i pyeti se si e
ndjenin veten. Edhe përgjigjia qe një pyetje:

— Si është ai... shoku ynë?

Mjeku i qetëson. Ata heshtin e unë pres:

— Kush e njuh Gjon Lleshin nga ju?

— Asnjë në nënrepartin tonë nuk e njuh atë.
Po kjo nuk do të thotë gjë. Ai është pjestar i njësisë,
është ushtar i Ushtrisë Popullore, bashkëluftëtari
ynë. Kjo mjafton, — m'u përgjegj Fejzi Saljani
për të gjithë.

Po, mjafton. M'u kujtua dialogu në sallën e
operacionit...

— Ju nuk jeni shumë i përshtatshëm që t'ju
marrim lëkurë, more djalosh; e keni me qime. Më
mirë të marrim nga ndonjë tjetër derisa vullnetarët
nuk mungojnë, — i tha mjeku Bezatit, që ishte
shtrirë dhe priste t'i bënin anestezinë.

Bezati shtangu për një çast dhe i pa këmbët
me keqardhje. Po, vërtet ashtu i kishte, leshtore.
Po ç'të bënte ai! Kish hyrë në sallë. Shoku i djegur,

aty pranë, dukej si i vdekur nën pushtetin e narkozës. Të delte që aty, nga ajo sallë, pa e ndihmuar, do t'i mbetej peng për tërë jetën... Po nuk thonë kot se miqësia, shoqëria dhe dashuria janë jo vetëm në zemër, po edhe në kokë.

— Më merrni lëkurë gjetiu, doktor, — u kujtua Bezati. — Dhe vazhdoi me zjarr: — Më rripni ku të doni e sa të doni. Po të merrni një tjetër në vend tim, do të humbisni kohë.

Ushtari kishte të drejtë. Transplatimi kish filluar. Koha vërtet nuk priste.

— Anestezia! — urdhëroi mjeku. Dhe Bezatin e operuan në shpatull...

Tani ai rri shtrirë. Ndjen dhëmbje të fortë, pse nuk doli koha që anestezia ta bënte efektin të plotë.

— Të djeg? — e pyeti mjeku.

— Do të kalojë, — përgjigjet ai.

— Ushtarë të çeliktë, ushtarë revolucionarë. — thotë instrumentistja e sallës së operacionit dhe premtori: — Kur të bëhet mbledhja e organizatës së rinisë në repart, unë do të kërkoj të vete e t'u them që të jenë krenarë për ta.

Po instrumentistja nuk do t'u thotë ndonjë gjë të re të rinjve për të tre shokët e tyre.

Dhe unë lexoj nëpër faqet e mbushura me shkrim të imtë. Shokët e kanë lavdëruar shpesh herë Fejziun, që punon përherë atje ku është më vështirë... Diskutimet vërtiten rreth planit. Normat janë tejkuluar. Po Fejziu nuk tregohet i kënaqur.

— Duhet ta përmirësojmë më tej cilësinë e betonimit, — u tërheq vëmendjen ai shokëve.

— Vibrimi është një punë që do me të vërtetë kujdes. Ai që do t'i dalë zot detyrës së vibruesit,

të ketë parasysh se do të punojë në ujë. Kush prej jush e ndjen veten të fortë për këtë punë dhe e merr përsipër me vullnet të lirë? — kish folur oficeri që merrte pjesë në mbledhje.

— Unë mund ta bëj, po të mos kenë kundërshtim shokët, ishte hedhur Fejziu.

E asnjë nuk kishte kundërshtuar. Të nesërmen i qe nënshtruar provës dhe që atë ditë mbeti në vibrim...

Të fortë si trupin ka edhe karakterin.

Nikollë Pjetri dhe Gjergj Deda nuk ishin paraqitur mirë në «shkatërrim fushor» e në «pengesat me mina». Këta bënë autokritikë që nuk ishin përpjekur sa duhet për të ecur në një hap me shokët. Të gjithë diskutantët i kritikuan dhe u dhanë shembull Fejzinë, që kish dalë shkëlqyeshëm. Ish ngritur edhe Fejziu vetë e kish folur kështu:

— Këtu, shokët kritikuan Nikollën e Gjergjin. Kanë të drejtë. Po unë do të bëj një pyetje: «Vetëm Nikolla e Gjergji janë fajtorë për prapambetjen e tyre?». Unë them se jo. Për mendimin tim, fajtorë jemi që të gjithë, pa përjashtim, që nga sekretari. Pa të ndalemi një çast e të pyesim: «Ç'bëri secili nga ne e ç'bëri gjithë kolektivi ynë për ta?». Asgjë! Kemi «larë gojën», si i thonë fjalës, me ca këshilla dhe jemi ngushëlluar e vetkënaqur me shkëlqimin e dy tre vetëve. Po behari nuk vjen me dy tri lule. Unë bëj autokritikë para organizatës që jam kënaqur me rezultatet e mia e nuk mendova për kolektivin, për nënrepartin.

Dhe, me ndihmën e organizatës, të shokëve shembullorë si Fejziu, Nikolla e Gjergji u bënë xhenjerë të mirë.

Drugës, kur po ktheheshim nga spitali, nde-

shëm në kompaninë ku bëjnë pjesë Fejziu, Bezati e Dilaveri. Ajo ish nisur për në stërvitje. Ushtarët na rrethuan e na sulmuan me pyetje për Gjonin e për shokët e tjerë. Mjeku i qetësoi me lajme që u dëshironte zemra, dhe ata shprehën gatishmërinë e tyre të plotë, që t'i shkojnë në ndihmë shokut, kur të jetë nevoja.

* * *

Po kush është Gjon Lleshi, ushtari për të cilin rrahin këto ditë zemrat e tërë ushtarëve të njësisë?.. Kur kish vajtur në repart, Gjoni e njihte shumë pak pistoletën. Pal Zefi, Idriz Meshi e ndihmuan të bëhej minator. Gani Bushi e bëri mjeshtër dhe që atëhere Gjoni nuk e lëshoi më pistoletën nga dora. Ai ua ka shpërblyer mundin shokëve. Që t'u hapte front, ai ngrihej që në ora tre të natës dhe çelte brimat për mina. Vetëm njëherë kish ndenjor pushim me raport mjeku, po edhe atë radhë jo deri në fund. Me të dëgjuar se nënreparti kish ndeshur në shkëmb të fortë dhe ishte prapa me normën, ai ishte ngritur dhe ishte bashkuar me shokët. Njëherë marshimi kish qenë i lodhshëm dhe i vështirë. Në buzë të lumit, një shok kish folur:

— Gjoni i ka këmbët me plagë.

Oficeri e lejoi Gjonin të kalonte mbi urë. Po nuk pranoi. — Pa sakrifica s'ka ushtri populllore... Ne na duhet ushtri e fortë, — ka thënë shoku Enver. Në luftë, edhe me plagë plumbi duhet të futesh në lumë. — Dhe kaloi rrymën së bashku me nënrepartin.

...Mbi jastëkun e bardhë shikojmë një fytyrë

që është aq e verdhë, aq e ngrirë dhe e palëvizshme, sa duket si një maskë prej dylli. E vë re mirë këtë fytyrë. Malësia ka skalitur në të tiparin e vet: të gjitha tiparet janë të theksuara, eshtake, mollzat të kërcyera, nofullat të fuqishme.

— Po vjen në vete, — më paralajmëroi mjeku.

Qepallat lëvizën të parat në atë maskë dylli. Pastaj buzët e thara e të verdha. Po, Gjon Lleshi po vinte në vete dalngadalë. Si ai polombari që ngjitet nga thellësitë e errëta të detit drejt sipërfaqes së ujit, edhe ai po voziste dalngadalë drejt jetës e, ndërsa po delte mbi sipërfaqe të saj, truri filloi t'i punonte përsëri. Hapi sytë dhe hodhi vështrimin rreth e rrotull. U kujtua për gjithçka. Mjegulla po davaritej nga vështrimi i të operuarit. Kjo tregonte se edhe mendimi po kthjellohej. I hodhi edhe njëherë sytë rreth e qark. Pa të jëmën, të jatin, të vëllanë... e diçka tha. E ëma nuk e dëgjoi dot atë pëshpëritje dhe drejtoi sytë nga mjeku. Ky u përkul mbi ushtarin.

— Ç'ka po thue, Gjon? Si je? A e ndjen veten ma mirë?

— Mirë jam... Ku janë... shokët?

— Shokët? Kanë ardhë e vijnë papushim, po nuk mund t'i lamë të gjithë me hy. Ja tek ke nanën, babën, të gjithë të dashtunit.

Gjoni hesht. Krahërori i ngrihet e i ulet me të shpejtë. Zemra e gjoksi i tij nuk luftojnë kësaj here me shkëmbin, po me vdekjen. E ka vështirë. Po lufton, ama, dhe qendron për t'ja patur zili. Mjekët, që më parë tundnin kokën me dyshim, tani kanë filluar të shpresojnë.

— I fortë si guri! Ushtar i çeliktë! T'i kesh kështu të gjithë të sëmurët, vdekja vdes nga uria.

— Kështu thonë mjekët kur dalin nga dhoma e Gjonit.

Nëna, i ati, vëllai e motra, shokët, komisarët dhe komandantët dalin e hyjnë, ndërrohen aty pranë shtratit të tij, si rojet pranë objektit. Ata s'mund të bëjnë asgjë që t'ja lehtësojnë Gjonit vuajtjet, dhëmbjet dhe e shprehin dashurinë për të duke mos ja hequr sytë nga fytyra... Qetësi në dhomën e bardhë që bie erë jod dhe eter. Ushtari merr frymë thellë, dihat, lëviz nganjëherë kokën, po nuk flet, nuk rënkon, nuk kërkon gjë. Mjeku na fton të dalim.

— Ka dhimbje të forta dhe djegie, po i duron. Është e qartë se i vjen turp të rënkojë në sytë tonë. Kështu e kanë trimat. E përbuzin çdo shprehje dobësie, edhe atë më të natyrshmen, më njerëzoren. Të dalim e t'i japim liri të paktën të rënkojë.

...Kalojnë minutat, orët... ngrysët e gdhihet... e Gjoni vazhdon të luftojë me vdekjen për jetën e tij me atë durim e atë ngulm që luftonte edhe me shkëmbin. Dhe nuk është çudi që ta prapsë, që të fitojë, ashtu siç fitonte në tunel. Duke dëgjuar ç'më tregojnë shokët e tij për të, mua më forcohet besimi se ai do ta fitojë dyluftimin me vdekjen.

Dhëmbjen e mposht Gjoni, po mallëngjimin nuk e ka lehtë ta fshehë. Kur ju afruan te shtrati shokë nga kompania e tij, u mallëngjye.

— Gjon, kemi ardhur të të shohim e të të përshëndesim nga ana e gjithë kompanisë. Të kemi sjellë edhe një letër, — i foli oficer Villasi dhe shtoi: — Ç'po ndodh kështu me ty, Gjon? Ti nuk i ke pasur zakon kurrë lotët.

— Nuk më dalin nga dhimbjet. Janë lot gëzimi. Më ka marrë malli me ju pa.. të gjithëve... të

jem me ju... kudo që të shkoni... Ma lexoni letrën...

Dëgjon ushtari në heshtje, me sytë të mbërthyer në tavanin e bardhë. Dëgjon dhe preket, mallëngjehet, po merr edhe kurajo, forcohet. Shokët nuk e harrojnë. I ka aty afër, te shtrati, të përkulur mbi të. I sheh nëpërmjet çdo gërme të letrës. Oh, po, me shokë është më lehtë të luftosh e të fitosh. Ju kthye mjekut, që i rregullonte plagët me kujdes.

— Doktor! Mos u shqetësoni për mue. Jam në gjendje me durue çdo dhimbje. Nuk kam nevojë për asnjë bar. Shokët më duen të fortë dhe unë do të jem i fortë. Nuk do t'i turpnoj.

Mjeku i flet me dashuri, i tregon se si, kur të shërohet, do t'i venë protezën e ai do të fillojë të ecë e të punojë përsëri. Gjonit i çelet fytyra. Lehtësohet në shpirt edhe babai i tij, Llesh Syziu. Atij i mbushen sytë me lot dhe na drejtohet të gjithë neve, ushtarë, oficerë e mjekë me këto fjalë, që i dalin nga zemra:

— Edhe të më vdesë djali, nuk kam asnjë pishmanllik. Djalin e paskam pas çue në një shkollë të madhe të ditunisë e të trimnisë. E paskam pas çue te prind e te shokë që e kanë dashtë si vedin. Për djalin tem, djalin e një malcori prej Mirdite, u çue në qiell një aeroplan. Këtë mrekulli e ka bënë në këtë vendin tonë Partia e Punës, i kjoftim falë. Të rrojë sa malet e të na prijë, se ajo na bashkon e na ban të fortë e të pathyeshëm. Na të gjithë, pleq e të rinj, jena bijt e saj, ushtarët e saj sot, mot e gjithëherë. Në mos kjoftë në gjendje me e mbajtë një pushkë ndër duer Gjoni, do ta mbaj unë. — E na përqafton me radhë, me dashuri atë-

rore. Pastaj ai kthehet nga djali e ja ngul sytë me dashuri. Gjoni i buzëqesh. Si të gjithë njerëzit e fortë, si të gjithë revolucionarët, ai e don jetën, e çmon dhe është i gatshëm të luftojë për të me vdekjen, derisa t'i rrahë edhe një damar. Prandaj ai meriton të rrojë. Shokët kanë besim se do të rrojë. Ata thonë:

— Duke luftuar me shkëmbin, Gjoni është bërë i fortë si ai. Duke luftuar i armatosur me idetë e partisë, ai është bërë i pathyeshëm.

SHOKËT

Ata ishin vetëm dy. Qenë nga skaje të ndryshme të vendit. Njëri quhej Kujtim, tjetri Shpend. U njohën në ushtri, plot një vit më parë. Atje u bënë shokë. Dhe tani Shpendi qendronte pranë radios e përgjonte zërat e largët, që mund ta thërrisnin, ndërsa Kujtimi, shtrirë e me sytë e mbyllur, dukej sikur ëndërronte. Ai duhej të ishte pranë radios, po Shpendi e dinte se shoku i tij kish qejf të rrinte e të ëndërronte gjatë, ndonëse s'thosh kurrë se ç'mendonte.

— Eh, — psherëtiu papritur Kujtimi. — Ditë e shënuar sot.

— Pooo; duhet festuar përvjetori i parë i jetës sonë ushtarake. Po me se?

Kujtimi u ngrit nga shtrati dhe u shtriq.

— Si nuk e menduam më parë këtë punë.

— Ty të takonte, Kujtim, se të vjen ndoresh për kësi punësh.

— Ç'mund të bëja unë?

— Të kishe porositur shokët të na binin ndonjë send.

— Po ti nuk pi as raki, as pije të tjera.

Shpendi vuri buzën në gaz.

— Besa festa është festë dhe unë kam dëshirë t'i përplasim gotat.

Kujtimi u ngrit në këmbë.

— Mirë pra, ti qendro këtu, unë po shkoj të blej një shishe.

— Je në vete? I thonë gjashtë orë udhë.

— Punë e madhe; kur ke kaq qejf ta kthesh një gotë, unë s'po ta prish.

— Jo, bre burrë, bëra shaka.

— Sidoqoftë, këtë përvjetor ne do ta festojmë edhe pa pije. Do të hartojmë një program të pasur; madje një program interesant. Shkruaj. E para, radiogram: Përhëndetje shokëve tanë njëvjeçarë.

— Bukur!

— E dyta, kërkesë radio Tiranës: të transmetojë këngën më të bukur. E treta: të dëgjojmë në radio emisionin me muzikë të kërkuar.

— Kjo sikur... s'është e lejueshme gjatë kohës së shërbimit. Pastaj edhe koha...

— Vazhdojmë më tej: ndërsa ti do të rrish në përgjim, unë do të përgatis një ekspozitë.

— Ekspozitë!? E kush do ta vizitojë?

— Plot njerëz. Në radhë të parë ne të dy, pastaj mund të vijë komandanti me... — Kujtimi e la fjalën përgjysmë dhe drejtoi sytë nga aparati. —

Dikushi po na thërrret.

Shpendi preku çelësat e radios.

— Qenka komandanti... Ç'kohë e keqe! S'dëgjohet mirë... Prit!... Po... Komandanti uron përvjetorin tonë në ushtri.

Kujtimi rregulloi uniformën dhe ju drejtua shokut:

— Transmetoi përgjigjen: «Ne, radistët e majës

më të lartë, dy shokët tuaj të armëve, ju dërgojmë urimet tona më të përzemërta, luftarake. Kujtimi — Shpendi»... Tani kalo në marrje!

Komandanti pyet për kohën.

— I thuaj kohë e keqe.

— Ai pyet: a janë lidhur gjithë tokëzuesat e aparateve?

— Po.

— Komandanti porositi: të ulen antenat:

Më tej ata s'mundën të flasin. Një shpërthim i afërt i bëri të largoheshin nga aparati. Një vetëtimë gati sa s'i verboi dhe në tjetër bubullimë tronditi godinën...

* * *

Në fillim të dy shokët nuk u shqetësuan shumë që jashtë natyrë turfullonte e tërbuar. Për një gjë ishin në merak: mos ndoshta koha do t'i pengonte të kryenin detyrën. Sepse me natyrën ushtari ndeshet çdo ditë. Dhe, kur koha është e keqe, ushtari as që do t'ja dijë. Madje ai bën luftë të ashpër me të. Ai e përbuz shtërgatën. Vetëtimat i duket si një prozhektor, që i ndriçon vendin ku bën roje. Bubullimat janë për të si gjëmime të artillerisë, që tregojnë se armiku diku përgatitet të sulmojë...

Po, në majë të malit, në godinën e vetmuar, atë ditë beteja që më e egër. Shtërgata sa vinte e bëhej më e furishme. Vetëtimat s'pushonin dhe bubullimat e tronditnin ndërtesën, i bënë muret të dridheshin e ciflat e gëlqeres të përshkënditeshin nga muret.

— Kujtim, dëgjon ç'bëhet? Më duket se na kanë vënë në shenjstër.

— Dihet ajo.

— Është e rrezikshme të qendrosh pranë aparateve me shtërgatë të tillë.

— Ashtu është.

Shpendi rrinte pranë radios. Kujtimi përgjonte nga dritarja. Shkrepëtimi një vetëtimë verbonjëse e një gjëmim i mprehtë sokëlliti menjëherë.

«Artileri e rëndë!» — pëshpëriti Kujtimi.

Pa mbaruar mirë fjalën, një tjetër vetëtimë e një tjetër shkrepëtimë edhe më e fortë lëkundën dheun. Kujtimi zuri sytë me duar. Shpendi u drodh.

— Shpend, largoju që andej.

— Pse?

— E kam radhën unë. Ti shtrihu.

— Jo, jo.

Kujtimi u kollit, shtërngoi rripin e mesit dhe ju afrua shokut:

— Unë jam komandant këtu; prandaj zbato urdhërin tim; marsh në shtrat!

Shpendi u ngrit në këmbë dhe mori drejtqendrim.

— Siurdhëron, veç në shtrat nuk shkoj. Po dal jashtë të ul antenën.

— Unë s'të lejoj të hysh në zonën e rrezikshme të rrufepritisit. Prandaj...

Kujtimi desh të thosh edhe diçka, po një gjëmim i fortë shpërtheu papritur. Atij i ra gypi nga dora. Shpendi u përplas në cepin e murit.

— U vrave?

Shpendi u ngrit dhe ju drejtua shokut.

— Largohu nga aparati. Aty do të rri vetë.

— Tani shërbimin e kam unë. Madje nuk du-

het as të më rrish afër, sepse, po të më ndodhi gjë
mua, mbetesh ti përgjegjës këtu.

— Mos folë marrëzira.

* * *

Erdhi nata. Jashtë era fishkëllinte pa pushim. Vetëtimat s'pushonin, krismat sa s'të shurdhonin. Të dy shokët s'flisnin më. E kishin pisk. Ata e dinin se ndërtesa e vogël, si me magnet, tërhiqte drejt vetes ngarkesat e rrezikshme. Nga çasti në çast ata mund të shkrumëzoheshin nga rrufeja. Vdekja u rrinte mbi kokë. Po, pak hapa më tej, ata mund t'i shpëtonin vdekjes. Ja, tej derës, jeta ishte e sigurtë. Megjithatë, ata nuk lëviznin nga vendi, qëndronin pranë aparateve pa e përfillur vdekjen.

Shpendi herëpashere vështronte derën.

— Që andej Kujtimi mund të shpëtojë, — thoshte me vete, — ndërsa posti luftarak nuk braktiset. Po, Kujtimi duhet të largohet, — vendosi ai. — Këtu do të qëndroj unë.

— Shpend, — ja ndërpreu mendimin Kujtimi.

— Urdhëro!

— Vishu shpejt dhe zbrit poshtë. Të pak-tën ti...

— Më urdhëron kështu?

— Jo, të lutem si shok.

— Dhe unë si shok të them, nuk largohem.

— Atëhere të urdhëroj.

— Edhe unë këtë urdhër...

Vetëtima u verboi sytë. Shpërtheu një krismë e madhe. Rryma e fuqishme e përplasi Kujtimin me forcë në dysheme. Shpendit, që, pa u kujtuar

as vetë, kish fshehur kryet midis krahëve, ju morën mëntë, u lëkund; pastaj duke vënë dorën te muri, u mbajt në këmbë. Një çast më vonë ai hapi sytë dhe pa shokun tek dergjej në dysHEME. U turr tek ai. Kujtimi merrte frymë me vështirësi.

* * *

Shiu i madh sikur i largoi me dorë vetëtimat. Më të rrallë qielli llamburiste e diku larg dëgjoeshin gjëmime. Shpendi vazhdonte t'i bënte shokut frymëmarrjen artificiale, duke vështruar me ankth gjendjen e tij, duke e pyetur herëpashere:

— Kujtim, si je, Kujtim?

— Ç'bëhet jashtë, — foli me zë të ulët më në fund Kujtimi, duke u përpjekur të ngrihet. — Sikur s'dëgjoj më bubullima.

— Mos luaj! S'duhet të flasësh. Tani po lajmëroj komandantin që të dërgojë njerëz të të marrin.

Kujtimi u ngrit në bërryla.

— Në asnjë mënyrë, Shpend!

Jashtë u dëgjua një fishkëllimë. Shpendi u ngrit më këmbë.

— Dikush po vjen!

— Dil e prit jashtë.

— Ti mos luaj nga vendi.

Shpendi doli jashtë. Ai s'u zuri besë syve kur pa gjithë atë ndryshim të natyrës përreth. Gropa të mëdha e shkëmbinj të rrëzuar.

Drejt ndërtesës po afroreshin tre njerëz. Midis tyre ai dalloi komandantin. U mat t'i raportonte, po oficeri e kapi nga dora:

— Shpend, shëndoshë jini të dy?

— Gjallë, shoku komandant.

Oficeri me dy ushtarët që e shoqëronin morën frymë thellë dhe zunë të fshijnë ballin dhe faqet nga djersët që u rridhnin çurk.

Kur u futën brenda, Kujtimi ndodhej pranë radios. Ai i shkeli synë Shpendit që po e shihte me habi, dhe ju kthye oficerit:

— Shoku komandant, gjatë shërbimit...

Oficeri e ndërpreu:

— S'ka nevojë; Shpendi më raportoi njëherë.

Shpendi i doli përpara komandantit.

— Më lejoni të marr shërbimin, kam radhën...

Komandanti buzëqeshi:

— Vazhdoni sipas planit, ushtarë të popullit.

Jashtë kishte zbardhëlluar. Qielli po çabej dhe retë e copëtuara po rendnin si të çakërdisura, të shpartalluara tutje malit.

SHOQËRUESI

I

Nëpër rrugët e betonuara, aeroplanët vinin dy e nga dy, njëri pas tjetrit. Zhurmonin gjer te vendqendrimi, pastaj ndaheshin nëpër sheshet e vegjël, zinin vend dhe turbinat pushonin.

Pilotët, që gjer atëhere kishin fluturuar me një shpejtësi të rrufeshme, ecnin më nge përmbi pllakat e mëdha të betonit, në drejtim të zyrave të komandës. Mbanin në dorë kokoret e lëkurta dhe kuvendonin duke bërë lëvizje me duar e me këmbë. Djersa ende s'u qe tharë nga fytyra e megji-thëkëtë, sikur rruga nga vendqendrimi i avionave e gjer tek zyrat e komandës të zgjaste me kilometra të tëra, ata as që do ta ndjenin. Kishin aq shumë gjëra për të shkoqitur pas atyre fluturimeve, sa që mund të flisnin gjithë ditën. Shumë prej tyre, duke ecur, nxirrnin nga xhepi blokun e vogël dhe i zbërthenin fluturimet në elemente të shumta, në copëza-copëza.

Përmbi aerodrom kaloi vërshëllima e fundit e turbinave. Pista u shpaloj para syve të pilotëve dhe i priti ata butë-butë. Aeroplanët nisën t'i mbu-

9-10
lonin. Zogjtë e shumtë që ardallisheshin rotull vendqendrimit, kërcenin në krahët e vëllezërve metalikë, çukisnin e kruanin sqepin në duralumin dhe, pasi qendronin një copë herë, iknin në punë të tyre.

Pilotët u përshëndetën me teknikët dhe muarën pas shokëve.

— E vështirë? — pyeti Bardhyli duke u çapitur përpara me hap të sigurtë.

— E vështirë, — tha piloti shoqërues, një djallë fare i ri, rreth të njëzetave, po me trup të hedhur e të bëshëm.

— S'ka dyshim... S'ka si të jetë ndryshe... Më bie ndërmend se njëherë komandanti...

Bardhyli ecte i mbytur nga mendimet. Me sa dukej, më tepër fliste me vete, se sa me aviatorin që i shkonte përkrah. Piloti shoqërues e kuptoi dhe e la për disa çaste ashtu. Ai druhej se, po ta pyeste komandantin, nuk do të dëgjonte atë që duhej. Dukej se në kujtesën e aviatorit të vjetër po mugullonte diçka e largët...

II

Kur u emërua pilot, Bardhyli dinte vetëm vendin e repartit ku po shkonte, aerodromin e të cilit i kish qëlluar ta shihte nga lart. Asgjë më shumë. Të tjerat qenë ëndërrime.

Kur u gjend në mes të pilotëve, për ca kohë e ndjeu veten më të vogël se ç'qe, më të imtë, madje edhe zëri ju duk si i mekur. Ata ishin të zeshkët, me gjymtyrë të mëdha, të ngjeshur me rrip, pistoletën e çizmet s'i hiqnin. Këta qenë pilotët.

Komandanti kishte një fytyrë serioze, ca të ashpër, dhe një zë që i buçiste nga gjoksi i fryrë. Kur thoshte: «Në aviona, djema!» dukej si një kalorës që jepte komandën: «Në kuaj!» Mustaqet e kërleshura nuk i fërkonte kurrë me gishta. Para rreshtit fliste pak. Me dy fjalë spjegonte detyrën. Dhe këtë e bënte jo se s'dinte më shumë, po donte t'i linte pilotët të mendonin me kokën e tyre.

Bardhyli qysh në ditët e para e njohu komandantin e repartit më mirë se kushdo tjetër. Ato ditë komandanti hijerëndë kishte thirrur në zyrë të gjithë aviatorët e rinj. Ai bisedoi me ta. Në fillim u duk mjaft i qeshur. Më pas zu të ndryshojë dhe e mbaroi atë bisedë aq papritur, sa që pilotët mbetën të habitur.

— Ashtu djema; mirë e kini nisur! Shkoni çap pas çapi me të vjetrit.

«Kjo qe e tëra?!, — menduan ata, — apo ka më?!»

Komandanti ra në mendime. Diçka kërkonte të sillte në mend. Dendur shikonte Bardhylin. I shikonte të tërë, siç e kishte zakon, nga koka te këmbët. Po Bardhylin zu ta vështrojë në dritë të syrit. Mendonte. Rrudhte ballin.

«Ç'është ky djalë?! Si nuk i kam vërejtur më parë këto tipare!... Vetulla të bashkuara, sy të zinj, hundë të mprehtë, shtatgjatë... Po më kujton dikë ky djalë... Po, po... Ky më kujton Perlatin, Perlat Ostrovën. Ky është gjallë ai... Ç'ta këtë?! Të jetë djali i tij?!... Hej vite, vite!»

Ai solli në mend se, tamam disa ditë para vrasjes, Perlati i kishte lexuar një letër nga e shoqja, ku ndër të tjera i thoshte se së shpejti do të bëhej nënë.

«Këtë letër do ta ruaj dhe t'ja rrëfej fëmijës kur të rritet», kishte thënë ai i mbushur me lumturi e me urrejtje kundër nazistëve.

«Ky është i biri, ky është gjallë Perlati! Ai është... I ngjan kaq shumë!»

Aviatorët e rinj e shikuan një copë herë në pritje. Ata nisën ta ndejnë veten ngushtë në atë zyrë, para komandantit.

— Mund të shkoni, djema, — tha ai, duke vënë pëllëmbën mbi ballin e rrudhur.

Ata e nderuan njëherësh dhe të tërë bënë një prapaktheu, si me komandë. Njëri pas tjetrit zunë të dalin nga ajo zyrë.

Bardhyli, që mbeti i fundit, sa bëri të dalë nga dera, dëgjoi:

— Ktheu! Qenke rreshtor i dobët.

Sytë e tij ndeshën me vështrimin e komandantit. Megjithëse që hera e parë që e shihte aq pranë, Bardhyli kuptoi se nuk qenë ato fjalë që e kthyen.

— Ti djalosh më the se je nga Tirana...

— Po, — tha ai menjëherë, pa i shkuar në mendje asgjë.

— Prit! Në ushtri ka rregulla. Përgjigju kur të pyesin. Dalloje mirë pyetjen që kërkon përgjigje.

Ndonëse fliste për rregullore, komandanti dukej tepër i butë, më shumë se një baba i urtë. Ai e shikonte në sy aviatorin e ri, që qendronte më këmbë gatitu.

— E qartë, shoku komandant.

— Ulu!

— Siurdhëron! — dhe hoqi kapën. Leshrat e zeza i ranë mbi ballë.

Ai e shikoi përsëri me ngulm. «Ti je djali i Perlatit... Eh, ç'po më çmall...»

— Ti nuk je Tiranas.

Bardhyli heshti. «Kjo pyetje nuk kërkon përgjigje», mendoi.

— Apo jo?

— Siurdhëron! Ne jemi shpërngulur nga jugu, pas çlirimit...

— Sa ju kam kërkuar!... — tha si me vete komandanti. — Dhe ti më erdhe vetë, djali i Perlatit! Goxha burrë qenke bërë!...

Bardhyli, që gjer atëhere nuk po kuptonte se ku qëndronte puna, ndjeu se i kaluan mornica në trup. Uli kokën dhe leshrat e zeza i ranë përmbi ballë.

Dhe, ashtu ndenjtur, ai mësoi se si i qe vrarë i ati. Një predhë mortaje e heshtur, si një zog grabitqar, kish ardhur nga prapa malit e qe zbrazur aty në lëndinë, mu te këmbët e mësuesit partizan.

— Kjo ngjau te Qafa e Kuqe, — tha komandanti dhe shtoi me një frymë:

— Nga aerodromi ynë, në jugë lindje duken tri gryka; ajo e mesit të nxjerr tamam te ajo qafë.

— Po, — tha Bardhyli, i cili s'kishte bërë zë për një kohë të gjatë. — I kam vënë re ato gryka.

Komandanti sikur u kujtua për diçka, hapi sirtarin dhe nxori paqetën. Vuri një cigare në gojë. Ja zgjati edhe Bardhylit.

— Faleminderit! Nuk e pi, — tha ky dhe luajti vendit.

«Gjallë i ati... Eh, sa më çmalli!...» mendonte komandanti. Bardhyli doli nga zyra afër

drekës. Ecte pa ditur se ku shkonte, gjersa takoi përsëri shokët.

Nuk kaloi shumë dhe një ditë komandanti i repartit e kërkoi Bardhylin që të fluturonte me të në çift.

Pasi i shpjegoi pak gjëra pilotit të ri, komandanti u kthye te aeroplani dhe e hodhi shikimin rrotull aerodromit, në drejtim të tri grykave, andej nga jugëljndja. Ca re të bardha, që ishin zvaritur tërë mëngjezin rrëzë maleve, tani qenë ngritur e qenë dëndësuar përmbi maja.

Uturinë turbinat, aeroplanët u shkëputën nga toka, lanë prapa një vërshtëllimë që e shtyri era tutje dhe kaq. Pilotët u ndanë nga toka, po, në çizmet e tyre, bashkë me ta fluturonte balta e kuge. Atyre u venin sytë gjithmonë te ajo baltë, dhe ajo baltë u kujtonte tokën e madhe, që dukej sikur rrëshqiste atje poshtë. Malet s'të hiqen nga sytë. Ç'male shkëmbore! Shkëmbenjtë janë masivë, të pacënuar, pa çarje, janë bloqe të tërë. Vendi malor është beton për bazamentin e tërë globit.

Komandanti fluturonte përpara. Bardhyli nuk i ndahej. Ngjante sikur një fije e padukshme i lidhte krah më krah aeroplanët. Piloti i ri dallonte kokën e komandantit, që kthehej pas dhe pastaj dëgjonte zërin e tij: «Mirë je. Ashtu, mbahu!» Këtë ja përsëriti disa herë dhe më s'u ndje. Fluturonin në grykë. Hieja e maleve dhe e reve përmbi ta e errësoi pamjen.

«Grykë... — mendoi piloti shoqërues. — Detyra ime është të mos i ndaj sytë nga komandanti... Dhe sa më afër, sa më pranë tij».

Ishte me të vërtetë një grykë e ngushtë, e ashpër, e errët. Kur u futën atje, atij i ngjau si-

kur ju shtrënguan brinjët, ju muar fryma, ju errën sytë. Nuk i thonë shaka të zbresësh nga hapësirat e stratosferës e të kredhesh në një grykë si kjo. Dëgjonte fishkëllimën e rrymave të ajrit që përplaseshin në ballin e kabinës dhe, megjithëse ndodhej në një kabinë hermetike i dukej sikur marshonte më këmbë nëpër atë grykë.

«Ja ku qenka Qafa e Kuqe», mendoi Bardhyli.

Të dy aeroplanët gjarpëronin si për të hyrë në birë të gjilpërës. Nga stratosfera e paanë, në një grykë si kjo. «Mos i ndaj sytë... Hajde më pranë...» dëgjohej në kufje.

Filli që bashkonte krahët, u këput papritur. Aeroplani shoqërues u vërvit përpjetë dhe, pasi u fut në një të çarë të reve, u fsheh përmbi to.

Turbina la prapa një vërshëllimë, që u këput aty te Qafa e Kuqe, dhe oshëtima e saj gjarpëroi grykës, andej nga kish ardhur çifti i aeroplanëve.

Pasi doli sipër, përmbi maja, përmbi re, Bardhyli u qetësua. Era e fortë e asaj gryke kërciste, trokëllinte e fshikullonte përçark aeroplanit. Sytë i vanë te këmbët, te çizmet e llangosura me baltën e kuqe të aerodromit. Padashur, i shkoi në mendje se ajo baltë ishte njësoj si e Qafës së Kuqe. Ju duk se ishte larguar nga një betejë, nga pozicionet dhe atje pat lënë vetëm partizanët tanë... Nuk mund të mendonte asgjë më të egër, më të ashpër... Ai ndjeu një rrënoqethje në trup, sa u drodh i tëri...

«Pse zgjodha këtë udhë?!... Nuk e mendova mirë. Ndoshta, as që më shkoi në mend!... Si u ndava nga komandanti?!... Kjo është njësoj... Kjo është...»

Po, pa sosur mirë mendimet, dëgjoji sikur i fo-

lën që prapa kurrizit dhe i hodhën dorën në shpatulla.

— Ndoshtë sipër teje, — dëgjoi Bardhyli dhe u habit, kur pa aeroplanin e komandantit aq pranë. Ky lëkundim krahët, gjersa shoqëruesi zuri vend siç kishin ardhur në fillim nga aerodromi. U afrua edhe ca. Pastaj që të dy njëherësh u varën si në pikatë dhe muarën grykës...

— Qëndro afër. Ashtu... — foli komandanti dhe më s'u ndje.

Fytyra e Bardhylit u mbush përnjëherësh me bula djerse. Veshët i gjëmuan sikur atje poshtë të qe ndezur një luftim i ashpër me batare të dendura. Tani kabina hermetike e aeroplanit sikur qe hapur dhe rrymat e forta të ajrit sikur fishkullonin ballin e pilotit të ri. Brinjët e maleve rrëshqisnin prapa dhe krijonin një perde laramane. Qafa e Kuqe zu të afrohet me një shpejtësi të rrufeshme, duke e mbuluar fare horizontin. Aeroplani i komandantit, që shkëlqente në gjysmëerrësirën e grykës, dukej sikur ikte në punë të tij.

«Nuk iki, jo!... Ajo që ndodhi, s'ka për të ngjarë më... Të largohesh që këtej, është njësoj si të... të lësh përgjysmë një betejë...»

Pilotit të ri ju bë sikur nëpër maja qenë ngrihur qindra njerëz, që shikonin nga ai dhe thoshin me zë të lartë:

«Djali i Perlatit... Goxha burrë qenke bërë?!»

Gryka oshëtiu më fort. Zhurma e turbinave brodhi tutje nëpër atë luginë të ngushtë, gjersa doli dhe u përhap atje ku nis hapësira e madhe e fushës dhe sipërfaqja e rrafshëtë e detit.

Kur dolën matanë dhe u ngritën shumë, Bardhyli ndjeu një zbrazëti dhe ngathësi.

— Ikim!... — tha komandanti dhe u duk se u largua ca nga formacioni.

Karburanti ishte në të sosur. Duhej kthyer. Po Bardhylit nuk ja kishte ënda; nuk i bëhej që të ndahesh nga ajo grykë...

«Nuk iki, jo!...» mendonte.

— Edhe një herë... — foli ashtu pa të keq, siç mund t'i fliste një shoku.

Komandanti në fillim s'u përgjegj. Lëkundi vetëm krahët paksa.

— Në aerodrom! — tha prerazi siç e kish zakon.

* * *

Aviatorët e rinj u ambientuan shpejt me jetën e re. Flitej se duhej zbritur nga lartësitë e mëdha dhe të futeshin grykave. Gjë e re kjo, dhe e reja ngjall gjithmonë kureshtje. Pastaj ajo bëhet qëllimi i jetës dhe ndeshet fytpërfyt me të vjetrën.

— Gjë e vështirë kjo...

— Në shkollë s'qe dëgjuar ndonjëherë...

— Po edhe këtu: «Mos u ulni shumë, — na thoshin, — se kemi sinjalizime...»

Pati edhe ndonjë shaka.

Nga stratosfera ulemi në zero...

— S'na kish vajtur në mend. Në zero jemi ulur, po në pistë, ose fushave të Myzeqesë, jo grykave të ashpëra!

Pastaj ju vunë punës.

Që ato ditë, atyre anëve u panë shumë e më shumë aeroplanë dhe oshëtinë turbinat reaktive varg e varg. Edhe vëmëndja e aviatorëve u shpër-

ngul nga pista me pllaka të mëdha betoni dhe zbriti nga stratosfera grykave me shkëmbinj masivë, rrëzë maleve me teraca, që ngjanin si të pështjella me bandazhe kadifeje.

III

Dhe ja tani, pas disa vjetësh, Bardhyli fluturonte me shoqëruesin e tij. Pilotët e rinj kishin nisur të futeshin edhe ata grykave, duke qendruar përkrah aviatorëve të vjetër.

— E vështirë? — pyeti Bardhyli.

— E vështirë, — tha shoqëruesi.

Pastaj ndenjën një copë herë të madhe në heshtje. Ecnin krah më krah, ashtu siç kishin fluturuar pranë njëri tjetrit.

Kështu arritën te pista, te ajo rrugë e gjerë dhe e gjatë, e betonuar me pllaka të mëdha. Kjo rrugë është kufiri në mes tokës dhe qiellit për pilotin. Ajo është krah i tokës sonë, që ngre lart pilotët dhe prehëri i kësaj toke, që i pret butë-butë bijt e saj. Sa gjurmë kanë lënë aty pilotët! Aty është shkruar biografia e secilit... Në pllakat e para të saj, rrotat e aeroplanëve kanë lënë qindra e mijra gjurmë.

Vetëm aty, ndanë pistës, Bardhyli qendroi. Edhe piloti shoqërues ndenji në krah të tij.

— Kur u ul këtu një ekuipazh i huaj, që u kap si shkelës i kufijve tanë, një prej tyre tha: «Ju qofshi që fluturoni këtu!» Dhe më kujtohet fare mirë, vuri edhe duart në kokë...

Piloti shoqërues qeshi, siç e kish zakon. I pëlqente humori dhe mezi e duronte heshtjen.

— Kush? — tha. — Ai mjekëroshi anglez? Kam dëgjuar.

— Po, ai... U trembën nga malet rreth e rrotull, se mos i përpinin, dhe, kur zbritën dridheshin si minjtë. Ishin zverdhur, sikur të kishin pirë farmak... .

Shoqëruesi qeshi përsëri. Këtë herë me zë të lartë, me një notë ironie dhe seç tha duke qeshur. Kur pa fytyrën e komandantit të tij, i vuri fre gazit dhe heshti.

— Po mos kujto se ata nuk mund të futen grykave... .

Ai tundi kokën dhe ngrysi vetullat. Nisi të ecë në drejtim të zyrave, duke tundur në dorë kokoren e lëkurtë.

Grykave janë zvaritur varganët me çallma, grykave kanë gjetur shteg edhe autokolonat fashiste... . Po gurët dhe plumbat i rrëzuan përdhe atje në fund, në këmbët e maleve, duke krijuar pirgje kufomash të kërmosura.

Nëpër rrugën e betonuar po largohet çifti i fundit i pilotëve. Dita e fluturimit mbaroi. Po kjo s'do të thotë se çdo gjë mori fund. Pilotët do të jetojnë me çastet e kësaj dite, gjersa të vijë fluturimi tjetër. E megjithëkëtë, ka fluturime dhe çaste që për pilotin mbeten për tërë jetën të paharruara... .

NDËRGJEGJIA E USHTARIT

Dhjetor. Mot i zyrtë. Ngado shihen re të zeza, të rënduara me shi. Malet janë ngarkuar me borë. Gjëmime të forta dhe shi. Kështu është moti sot, ditën e katërt të muajit dhjetor.

Ora 14. 30'. Në stacionin e trenit në Tiranë, edhe pse është ditë dimri, ka shumë lëvizje. Çdo të dielë, kryeqyteti pret e përcjell njerëzit që banojnë në fshatrat dhe qytetet e afërta. Treni i Laçit është mbushur plot me njerëz. Me këtë tren nisem me shërbim në një garnizon ushtarak të dislokuar diku në veri. Hyj në një vagon dhe nis bisedën me bashku-dhëtarët. Menjëherë më tërheq vëmendjen një ushtar. Qendron në koridor, i mbështetur mbi parmakun e dritares. Duket se është i shqetësuar, diçka e mundon.

Duke filluar nga Vora, udhëtarët zënë të rrallohen një nga një, vagoni po zbrazet. Ndërsa treni nisët, sërishmi ndizen biseda në vagonin tonë; veç ushtari hesht. Ai, i mbështetur në parmakun e dritares, shikon gjithmonë përpara, si të donte të thoshte:
— Sa ngadalë që ecën treni!

Kalon traseja e hekurudhës së re midis ish kënetës. Kemi bërë më shumë se gjysmën e rrugës.

Shiu që filloi në Tiranë, jo vetëm që s'po pushon, po kokrra të mëdha breshëri rrahin xhamet e vagonit. Dritaret i kanë mbyllur të gjitha, vetëm ajo e ushtarit është e çelur. Ushtari shikon përpara në ballin e vargut të vagonave, sikur kërkon t'i thotë dizelistit:

— Më shpejt, më shpejt!

Arritëm në stacionin e Laçit me ditë, po, ngaqë retë kanë rënë thuajse në tokë, ngjan si të jetë muzgu i mbrëmjes. Nuk guxon njeri të dalë një çast nga treni, aq shi i madh bie dhe aq me rrëmbim fryn era...

Ja tek ndodhem pranë peshores. Është natë. Shiu vazhdon të bjerë, po jo me rrëmbimin e parë. Kalon afër meje një burrë mesatar nga shtati, pak i dobët në fytyrë. E quajnë Gjokë. Është mekanik.

— Ku do të shkosh? — më pyet. Pasi mori përgjigjen time, më drejtoi te një shofer që nisej për në Bulqizë. E quajnë Refat, është nga Shupenza e Peshkopisë. Ngjitemi të dy në kabinë. Nata është e errët pus, po Laçi ndrit nga drita të fuqishme. Oxhaqet e uzinës, Kombinati i drurit, parku, qyteti, stacioni i trenit dhe Uzina e ferrokromit dhe fabrikat e tjera që do të ngrihen në Laç gjatë pesëvjeçarit të ri, e rritën, e zbukuruan dhe do ta rrisin e zbukurojnë edhe më shumë Laçin. Maqina niset. Largohehet nga qyteti. Rrugët janë të mbushura plot me ujë. Vetëtimat çajnë errësirën e madhe. Nuk shikon njeri në rrugë, edhe maqinat kanë ndaluar, aq me rrëmbim fryn era në afërsitë e Milotit. Mendohem:

— Ç'u bë ai ushtar që ishte në tren, a gjeti maqinë vallë?

Ballin e shytës e godasin kokrra breshëri, pa-

mja kufizohet, po Refati e njeh mirë këtë rrugë. Sapo morëm kthesat për në Milot, në rrugë, larg, shquam siluetën e një njeriu. Ishte ushtari, po ecte në drejtim të qytetit. Përsëri më lindi pyetja: «Ku shkon ky ushtar?»

— Ta marrim, — i thashë shoferit. Ai frenoi.
— Vështirë të udhëtosh më këmbë në kohë si kjo, — ju drejtua shoferi ushtarit.

— Ashtu e kam punën!

Shofer Refati nuk foli. Ai ka qenë vetë ushtar dhe ushtria ka rregullat e disiplinën e saj. Desh të fliste më shumë, po heshti.

... Ushtarit i kullojnë rrobat, është lagur, si thuhet, edhe nën sjetull. Buzëve të tij është formuar një rreth si i zi. Fërkon duart.

— Ke ftohtë, urdhëro ndize një cigare.

Ushtari e ndezi dhe cigarja sikur i dha shkak kuvendit midis të dyve.

Unë dëgjoja.

— Nga të kena, shoku ushtar?

— Nga Kavaja.

— Prej qyteti?

— Jo, nga Luzi i Vogël.

— Në shtëpi ke qenë?

— Po, isha disa ditë me leje, se kisha babën shumë të sëmurë.

Ushtari flet dhe thith cigaren. Shoferi ndez një llambushkë të vogël dhe kabina ndrit. Dalloj më mirë fytyrën rrumbullake të ushtarit, sytë e çiltër, tiparet e rregullta.

— Kur je nisur nga Kavaja?

— Sot në drekë.

— Pse kaq ngutshëm?

— Më mbaron leja.

— Kur?

— Sonte.

Sakaq kishim kaluar një rrugë të gjatë përmjet grykës. «Skoda» hyri në grykën e Shkopetit. Nata, si gjithnjë, është e zezë, mjegulla kufizon pamjen. Në lapidar, në anë të rrugës, lexoj emrin e një dëshmori. Ai u vra këtu në përleshje me diversantët. Në këtë rrugë, kësaj lugine, është goditur edhe shoferi.

Mbi vetull shoferi ka shenjën e një plumbi, ka edhe një goditje tjetër. S'ka shumë vite që, në përleshje me armiqtë, në këtë rrugë dhe kësaj gryke, ai është plagosur.

Maqina ecën. Ata të dy bisedojnë.

Një lapidar tjetër në Shkëmbin e shqiponjave. Me gërma të kuqe është shkruar emri i të riut Ethem Muka. Djersa kulloi rrëke kësaj gryke, por edhe pika gjaku u derdhën, gjersa ajo u bë luginë me rrugë të asfaltuara, me liqen të bukur, me diga të fuqishme e hidrocentrale.

Në shtëpi, ushtari la nënën, la dhe fshatarët të mbledhur grumbull dhe iku.

— Qendro, s'bëhet kiameti për një ditë, as për dy, kur ndodhin raste të tilla! — i thanë disa.

— Jo, — kish thënë ushtari dhe kish qafuar nënën. Dhe nënës së ushtarit i ranë një vrushkull lotësh. Edhe ndonjë tjetër lotoi. Ndërsa ushtari, edhe pse më i ri në moshë, e mbajti veten. U nis ushtar Hekurani për në repart. Duhej të ishte atje në thirrjen e mbrëmjes në radhë me shokët.

... Ngjitja e fundit, po dalim nga gryka. Si gjithnjë, vazhdon të bjerë shi. «Skoda» e ngadalësoi shpejtësinë. Ushtari shqetësohet, ai do me çdo kusht të arrijë sa më parë në repart, të jetë me shokët

në kohën e thirrjes së mbrëmjes. Nga shprehja e fytyrës mundëm të kuptonim se një dëshpërim i rëndonte ushtarit. E pyetëm.

— Më ka vdekë baba, — tha ushtar Hekurani.

— Të rroni vetë, — ndërhyri shoferi.

— Kur kështu?

— Sot në mesditë e varrosëm.

— Sot varrosët babën?

Shoferi hesht, ngjarja e ushtarit la te ai mbresa të forta; ushtari gjithashtu hesht. Mundohem të zbuloj ndjenjat e brendshme të ushtarit. Ai e ndjen thellë humbjen e babait 55 vjeçar. Po, mbi të gjitha, ai vë detyrën, vlerëson rregullin ushtarak, disiplinën ushtarake. Ato kanë një kuptim të lartë për ushtar Hekuranin, një kuptim më të lartë se ndjenjat e tij.

...Po afron çasti të ndahemi. Ata të dy shikojnë njëri tjetrin dhe këmbëjnë fjalë. Unë vërej ata dhe them: «Ja njerëzit tanë!..»

Përpara kazermës, në orët e vona të natës, nënrepartit, ku bën pjesë ushtar Hekurani, bënte thirrjen e mbrëmjes. Kujdestari, nënoficer E. lexonte emrat.

— Ushtar Hekuran....

— Këtu! — foli ushtari. Kujdestari ngriti kokën, e shikoi ushtarin dhe buzëqeshi. «E dija, — tha me vete, — e dija që ai do të ishte në rresht!»

Ditën e nesërme, ushtar Hekurani shkoi në stërvitje bashkë me shokët. Të gjithë ushtarët e ngushëlluan për humbjen e babait, mundoheshin t'ja lehtësonin dhimbjen. S'kishte njeri në shtëpi ushtar Hekurani, veç babanë e nënën...

Kur shkova në repartin ushtarak, më thanë për të se, në qitje, e godit shenjën me predhën e parë;

në detyrë, si telegrafist, është i shkëlqyer, punëtor i palodhur në ekonomi. E, mbi të gjitha, ushtar i rregullt, i disiplinuar.

...Disa orë më vonë, shokët e përcollën Hekuranin për të kaluar disa ditë pranë familjes.

NË DËBORË E NË TUFAN...

Ky ishte një vit i vështirë dhe marsi, papritur, në vend të vërshtimeve të nxitura të ujrave, ende po mbarte ngrica dhe tufane mbi shpinën e bardhë.

Sekretari hyri në zyrën e ftohtë, ku ruhej ende frymëmarrja e ngrirë e natës së shkuar. Ngriti perdet e rënda të dritares dhe vuri re se, përtej arabeskave që kish endur nata, nuk dukej më se si grindej e shfrynte tufani, i mbyllur si në një kafaz të gurtë midis shtëpive të dendura të qytetit. Nxori duart e mardhura nga xhepet e palltos ushtarake bojë vaji, të rjepur në bërrylet nga fërkimi, dhe ngriti dorëzën e telefonit. Nga dera e hapur hyri, pa u ndjerë, shërbyesja, një plakë e pakët, që solli një krah dru për zjarrin.

— Mos e ndiz zjarrin, nënë Marë, — tha ai. — Nuk do të qendroj në zyrë.

— Ku do të vesh në këtë kohë, bir? Kjo erë kërkon shpirt njeriu! — tha plaka.

— Eh, moj nënë! — psherëtiu ai. — Ka tufane më të këqija se ky, po unë nuk e kam pasur kurrë më vështirë se këto ditë: madje as atëhere kur u fsheha nga ndjekjet në qilarin e ftohtë të shtëpisë sate të vjetër.

— Ç'të ka ndodhur, bir? — pyeti plaka. — As tani, pasi hoqe të zitë e ullirit dhe u ngjalle së vdekuri, s'po gjen dot prehje?

— Për ne nuk do të ketë prehje derisa të vdesim! Këtë detyrë i dha historia brezit tonë, — tha ai.

Sekretarit po i bëhej natyrë e dytë që të fliste shpeshherë si në mbledhje dhe kjo nuk i pëlqeu aspak, se e dinte që nënë Mara s'para e kuptonte këtë gjuhë; mirëpo shpesh njeriu, edhe pse e di që nuk shprehet ashtu siç ka dëshirë, nuk i gjen dot fjalët e duhura. Këtë plakë të pakët ai e donte si nënën e tij, po mendoj se ishte më mirë që edhe ajo të mos e dinte se fshatrat e malësisë po mbeteshin pa bukë

Në fshatrat përtej lumit, në zonën D, kishin mundur të grumbullonin sasi të mëdha drithi dhe të gjitha maqinat e parkut të automobilave ishin nisur për të sjellë drithin në qytet. Kur, befas, nisi dëbora, shpërthyen prej maleve erërat e forta të veriut dhe u përtërinë tufane si një janar, kështu që rruga u zu. Maqinat kishin mbetur në një rrugë të zveshur, ku nuk pushonin korentet e erërave dhe ku tani dukej sikur ish shkarkuar gjithë ngarkesa e bardhë, që fshihej brenda reve të ulta e të zymta. Më në fund në telefon u përgjegj ai që kërkonte sekretari, po zëri i tij ishte shumë i mbytur dhe, meqë ai fliste shpejt, sekretari nuk kuptoi asgjë, prandaj e urdhëroi prerë:

— Mos u nxito! Folë ngadalë!

— Nuk ka ardhur asnjë maqinë, — tha zëri.

— A kanë dërguar ndonjë lajm nga gryka?

— Jo...

— Pra, rruga s'është hapur... — tha më shumë me vete se sa për atë që e dëgjonte.

— Nuk është hapur!.. — tha zëri. Ai vuri dorëzën në vend, futi duart në xhepet e palltos dhe i ra kryq e tërthor dhomës.

Plaka, që kish mbaruar së fshiri, e vërente dhe mendonte se ky njeri, sa më shumë vjete shkonin, aq më shumë thahej, sikur ushqehej me piper. Ajo e dinte se ai ishte sëmurrur pesë vjet më parë, në dimrin e vitit 1943, kur fjeti dy muaj në jamën e vjetër, me muret e mykur nga lagështia e përhershme. Edhe fytyrën e kish të zbetë, kurse kockat e dala të shpatullave, nën pallton e vjetër, dukeshin si dy biga të mprehta të një druri të drejtë. Balli i ishte zhubrosur shumë nga brazda të thella. Ajo dinte gjithashtu se sekretari vuante nga tuberkulozi; madje njëherë kishte pështyrë gjak, mirëpo këto ai ua fshihte të gjithëve, rrëmbehej pas punës dhe e linte veten pasdore. Plaka pa se si e rrëmbeu nga muri kapelen prej lëkure leçuri, që i kishin vënë emrin e çuditshëm «kokore», se si e kopsiti jakën e palltos dhe dëgjoi se si u nis me potere maqina e tij e vogël.

Mbi qytetin e gurtë dhe mbi fushën e bardhë përsëri frynin erërat e mëdha të veriut, që mbësh-tillnin në gjirin e tyre re me fërfëlliza dëbore. Mbi gjithë zërat e tjerë zotëronin e shpërthenin zërat e frikshëm të tufanit dhe dukej sikur bota, e platitur nën peshën e tij, nuk mendonte gjë tjetër veç tufanit. Nëpër të çarat e dyerve që s'puthiteshin mirë, hynte era dhe ai ndjente se si po i mbërdhinin gjithnjë më shumë këmbët e duart. Shoferi shante nëpër dhëmbë dhe mundohej të mos dilte jashtë vazhdës së thellë të gjurmave të rrotave, po, nëpër vendet e thella, edhe gjurma nuk dukej më, prandaj ai shkonte shumë ngadalë. Atij i dukej sikur erërat do

ta rrëmbenin maqinën e lehtë e të vogël dhe do ta hidhnin poshtë greminave, ose do ta përplasnin pas shkëmbinjve të zveshur, po megjithatë, maqina ecte drejt grykës.

— Kur fryn këtu kaq shumë, merre me mend se sa fryn në Grykën e Povës, — tha shoferi. — Atje era ulurin sikur të jenë mbledhur të gjithë ujëqit e botës. Sekretari nuk foli, hoqi kokoren dhe fërkoji flokët e rrallë. Ndjeu se kish temperaturë dhe se duart i kishin djersirë. Nga pasqyra e turbullt, që ish lidhur me një llastik, e shihte një fytyrë e huaj, e përskuqur dhe e lagur. Më tej, rruga u keqësua shumë, meteriset e dëborës u bënë më të thella e të padukshme dhe shoferi vështroi me pikëllim se si maqina u fut në një grackë të tillë e nuk lëvizi më. Këtu sekretari zbriti dhe u nis më këmbë. Në fushë të hapur ndjehej edhe më fort zemërimi i papërmbajtur i natyrës, pluhuri i bardhë vërtitej si një shtjellje uji dhe ngrihej si shtëllungë lart, derisa humbiste në kubënë e ulët të qiellit. Drurët e vegjël të plepave, që ishin mbjellë para dy vjetësh anës së rrugës, ishin shtrirë lakuriq mbi dëborë, si të prerë nga një sharrë e padukshme. Gjurmata e humbisnin menjëherë formën e tyre dhe treteshin e fshiheshin nga era.

«Keq!» — tha me vete ai.

Në grykë ish një rrëmuje e madhe. Maqinat e vjetra, ca «Trentokuatro» të mëdha, plaçkë lufte, kishin mbetur në buzë të pjerrësisë si një karvan i zi. Nën mushamatë e zeza dukeshin format e thasëve me drithë. Dhjetë punëtorë, me lopata, rropateshin të hapnin udhën dhe pas gjurmës së tyre nisej maqina e parë deri në një farë vendi. Pastaj maqina niste e uturinte si një bishë e plagosur,

mundohet të shtynte me hundën e gjatë grumbujt e dëborës, po, e pafuqishme, zinte e rrëshqiste prapa, ku prisnin shoferët me gurë të mëdhenj në duar. Punëtorët, të lodhur, fillonin të hidhnin anës dëborën që kish grumbulluar maqina, po erërat që gërryenin dëborën e vendeve të larta, i mbushnin shpejt e shpejt gjurmat e punës së tyre dhe krijohej përsëri një shtrojë e re, e pacënuar. Njerëzit kishin mbetur në mëdyshje, sepse s'dinin si ta mposhtnin këtë këmbëngulje të natyrës. Veç kësaj, nuk mund të punonin asnjëherë më shumë se dhjetë veta, se s'kishte vegla.

Sekretari ndjeu t'i acarohen nervat e në majë të gjuhës i erdhën sharje të shumta për atë burrin e shkurtër, që ish drejtor i ndërmarrjes së ndërtimit dhe që s'kish mundur të sjellë dot më shumë se dhjetë punëtorë. Po ai e dinte se kjo nuk sillte tani asnjë dobi, prandaj u mundua të tregohet i qeshur, sikur s'po ndodhte asgjë e veçantë, sikur pas një çasti rruga do të hapej. Drejtori, i lodhur dhe i hutuar nga ajo natë e vrullshme, gjatë se cilës s'kish mundur t'i lëvizë asnjë hap më tej maqinat, u turbullua fare, sepse priste prej tij qortime. Sekretari u përshëndet me të gjithë. Era i valaviste anët e kokores që ai nuk i kish lidhur. Ai vuri re se vendi ishte tepër i shkretë. Vetëm aty këtu nxirrnin krye mbi dëborë ca degëza të holla dëllinjash, kurse, në buzë të rrugës, si një send i harruar e i kotë, kish mbetur një barakë e shtrembër, e mbuluar me dëborë deri në strehët e çatisë. Dukej sikur do të shembej nga çasti në çast dhe prej saj do të mbetej vetëm një grumbull dërrasash e letër katrama.

— E, shokë, — tha. — Malësia po pret bukë.

A do t'i lemë shokët tanë të maleve të vuajnë për bukën e gojës?

Zëri i tij i pakët, nën fishkëllimën e mprehtë të erës, mezi u ndie nga ata që ishin më afër. Në mënyrë të pavetdijshme, të gjithë u mblodhën rreth tij dhe ai mbeti në mes, duke vështruar frymën e ngrirë që dilte nga gojët e hapura. Ai vuri re se fytyrat që e vështronin ishin të mpira e të mbërthyer nga ankthi i pritjes, kurse nëpër flokët, që u dilnin jashtë kasketave pa ngjyrë, dëbora e ngrirë kish krijuar ca qerpikë të vegjël akulli.

— Vetëm kur të pushojë era, mund të fillojmë punën për të hapur rrugën, — foli një burrë i shkurtër, i mbështjellë në një pallto shumë të madhe, prej së cilës dilte vetëm fytyra e tij e vogël dhe e mprehtë si e një dhelpre.

«Ky duhet të jetë shofer», — mendoi ai.

— Këtu era nuk pushon kurrë, — tha një tjetër, zeshkan, i gjatë, i mbështjellë me një mushama të zezë.

— Ç'është kjo barakë këtu? — pyeti papritur sekretari.

— Është e braktisur, — tha shoferi zeshkan. — Dëbora i ka zënë hyrjen.

— Duhet hapur. Njerëzit kanë ngrirë. Me njerëz të rraskapitur nuk hapet rruga. Aty mund të ndezim zjarr.

— Ajo do të shembet nga pesha e dëborës së çatisë, — tha shoferi i mbështjellë me pallto.

— Atëhere duhet qeruar dëbora e çatisë. Le të hipin dy veta, ndërsa ne të tjerët të thyejmë ose të presim degë dëllinje.

— Mua më kujtohet se pranë barakës kishte një vathë, — tha zeshkani.

— Nuk kishte, — tha shoferi tjetër me fytyrë si të dhelprës.

— Në vjeshtë vatha ka qenë aty, — tha një punëtor.

— E pra, duhet ta gjejmë vathën dhe të prishim gardhin, — tha ai dhe i pëshpëriti drejtorit ngadalë: — Duhet të mendoni më shumë për njerëzit, shok!

Mbas një gjysmë ore, në barakë ishte ndezur zjarri.

— Të mbliidhemi të gjithë brenda — tha ai. — Asnjëri s'mund ta gjejë vetë se si t'i nxjerrim makinat nga gryka, prandaj duhet të bisedojmë, se prej shumë mendimesh, mund të nxjerrësh kurdoherë një zgjidhje të mirë. Vetëm se nuk do të qendrojmë brenda më shumë se gjysmë ore dhe gjatë kësaj kohe duhet të thotë secili mendimin e tij.

Brenda barakës së anuar ra heshtje. Ndihej vetëm kërcitja e halave të dëllinjës dhe shushurima e shkrirjes së dëborës në truallin rreth zjarrit. Tymi i dëllinjës e mbushi shpejt barakën dhe fytyrat e njerëzve u zbehën e mbetën si hije brenda një tyli mjegulle blu, mjegull me erë të fortë dëllinje. I pari u mat të flasë shoferi zeshkan, të cilit i arrinte kryet deri në letrën e zezë, me të cilën ishte mbuluar baraka.

— Po sikur... — tha

— E?

— Eh! Mendova se duhet të lajmërojmë që të vinë punëtorë nga qyteti, po është shumë larg!

— Më i vështiri është ky kilometër, derisa të kalojmë grykën, pastaj besoj se do ta kemi në lehtë, — tha drejtori.

— Po sikur ta shtrojmë rrugën deri në majë me shkurre që të mos xhirojnë maqinat?

— Ku t'i gjejmë gjithë këto shkurre?

— Nën dëborë. Shpati është i veshur me dëllinjë.

— Do të duhej një ditë që të bridhnim e të nblidhnim dëllinja!

— Të prishim edhe barakën dhe të përdorim dërrasat, — tha i pari.

— Ti s'je shofer dhe s'e merr vesh se në këto dërrasa të ngrira e të veshura me akull s'mund të kalohet kurrë.

— Do të na duheshin njëqind baraka deri në majë!

— Pra, mbetet vetëm një rrugëdalje: të vijnë forca nga qyteti, — tha drejtori.

Heshtje. Zjarri u shua dhe s'u kujtua njeri t'i hedhë më karthje. Tymi shfrynte nga dera dhe humbiste e përzihej me pluhurin e intë të dëborës që merrte era me vete. Lopatat, të hedhura njëra nibi tjetrën përpara hyrjes, po mbuloheshin nga dëbora.

— Me leje? — tha një zë i vrazhdë, po si i mbytur. Zjarrit ju afrua një punëtor shtatmadh, që mezi i lëvizte shpatullat e gjera, të rënda e pak të kërrusura. — Kjo rrugë nuk hapet kështu! — Zëri i tij i ngjiste një gjëmimi.

— Si? — pyeti sekretari, sikur s'e kish dëgjuar fare.

— Thashë se kjo rrugë nuk hapet kështu. Unë kam njëzet vjet punëtor rrugësh dhe s'mbaj mend të ketë guxuar njeri të hapë rrugën në një tufan të tillë. Ti sot mund ta hapësh, po deri në mbrëmje ajo do të zihet prapë.

— Dëgjo, shok, — tha rreptë e me inat ai. — Si të quajnë?

— Rakip Selmani më quajnë, — tha vigani.

— Ti, Rakip, mund të kesh edhe njëqind vjet këtu, mund të kesh parë e dëgjuar shumë, po mëso tani se kjo rrugë ne na duhet dhe do ta hapim.

— Nesër do të zihet përsëri, — tha ai.

— Dhe ne do të hapim përsëri!

— Mirë, — tha ngadalë vigani. — Rruga mund të hapet, po vetëm mbasi të pushojë tufani.

— Jo, — tha sekretari. — Rrugën do ta hapim edhe sikur të mos pushojë tufani. Tani ora është dymbëdhjetë. Deri në orën dhjetë të natës duhet ta kemi shpënë drithin në Qafën e Prepasit. Ne do ta shpiem edhe sikur të na duhet ta mbartim më shpinë deri në qytet!

— Atëhere!.. — tha mendueshëm vigani.

— Folë!

— Ndofta mund të na ndihmojë fshati Dushkër! Aty ka mbi njëqind burra dhe që të gjithë kanë vegla.

Të njëzetët në kasolle i përshkoi një dridhje, si t'u kish kaluar një rrymë e ftohtë. Kjo rrymë ish shpresa e ringjallur për hapjen e rrugës. Sekretari, që kish një copë herë që mendohej në mund të shkonin në fshatin më të afërt, po që nuk e njihnte këtë zonë, pyeti:

— Sa larg është fshati?

— Në verë, dy orë. Udha është e përpjetë, po nuk besoj që të jetë hapur. Unë e di udhën.

— Pse, tunden fshatarët nga shtëpia në këtë tufan? a? — tha shoferi me fytyrë si të dhelprës.

— Do të vinë, — tha sekretari. — Ti, Rakip, do të na heqësh rrugën. Me ne do të vish edhe ti,

— ju drejtua ai shoferit zeshkash, që kish maqinën e fundit në kolonë.

— Rakipi ka për ta humbur rrugën në këtë tu-fan, — tha përsëri surratdhelpra.

— Kush je ti që flet gjithnjë sëprapthi? — bërtiti sekretari.

— Mos ja vini re, shoku sekretar! — tha zeshkani. — Është shofer, shoku ynë, po kështu ters flet gjithnjë.

— Mos harro, shofer, se, në luftë, ai që nuk ka besim, është vetëm një hap larg nga dezertori, — tha sekretari dhe vuri përsëri kokoren. — Ti, drejtor, do të nisesh për në qytet dhe do të sjellësh punëtorë të tjerë. Ju që mbeteni, duhet të hapni rrugën të paktën deri te kthesa.

— Është e vështirë, — pëshpëriti, — zeshkani.

— E di, — tha ai me zë të ulët. — Po njerëzit duhet të kenë përpara një detyrë, të cilën duhet ta arrijnë. Ata duhet të hapin të paktën dyqind metra rrugë. Ne do të kthehemi këtu pas pesë orësh me njëqind njerëz pas!

* * *

Kështu ata të tre u nisën nëpër një shteg të padukshëm. Era u fshikte si me jele kali fytyrën, që e kishin shumë të mpirë, dhe sekretari nuk po i lidhte dot mbulesat e veshëve të kokores. Rakipi mendohej të mos shkëputej shumë nga rrjedha e padukshme e përroit.

— Udhën do ta çajmë me radhë, — tha sekretari. — Një çerek ore secili.

— Jo, — tha prerë Rakipi. — Udhën do ta hap unë. Ju nuk e dini drejtimin.

— Do ta hapim të tre me radhë, — tha vrazhdë

ai. — Ti do të qendrosh pas të parit dhe do të tregosh drejtimin.

— Po...

— S'ka po, — tha ai.

— Na e lini neve, — tha zeshkani. — Ju nuk jeni aq mirë me shëndet.

— Kush tha? — u përgjegj dhe e vështroi zeshkanin drejt e në sytë e mëdhenj, të butë e shumë të zinj. — Unë jam fare mirë.

Kështu, në krye të çdo një të katërt ore, nga larg dukej se si printe në krye të grupit herë një pallto bojë vaji dhe fytyra e thatë e sekretarit, herë trupi vigan i Rakipit, herë silueta e mbështjellë në një mushama të zezë e shoferit. Në një farë vendi, prijisi bënte një hap anash dhe linte në krye tjetrin. Shkonin pothuaj pa folur. Ata e dinin se çdo fjalë ishte një harxhim i tepërt fryme dhe force. Aty era ishte më e dobët, po trashësia e dëborës më e madhe.

Kur doli për herë të tretë në krye të grupit, ai e ndjeu se ishte lodhur tepër dhe se hapat po i bënte më të vogla. Këmbët nuk i bindeshin më aq lehtë dhe lagështia i kish depërtuar deri mbi gju. Ai e kuptoi se po vononte edhe ecjen e të tjerëve, prandaj u mundua të ecë më shpejt. Ndjeu në zverk frymën e ngrohtë të Rakipit, që ishte shumë pranë.

«Mos kujton ky se do të rrëzohem e kërkon të më mbajë» — mendoi dhe ndjeu t'i vërshojë një ndjenjë e ngrohtë për atë burrë shtatmadh e të vrazhdë.

— Më lerë të dal në krye, — tha me zë të ulët.

Sekretari thujse nuk e dëgjoï. Atëhere po e mbulonin kujtime të viteve të shkuara, kur karvani i gjatë i partizanëve gjarpëronte drejt veriut dhe,

padashur, vetvetiu, në qenien e tij lindi, si një nevojë e domosdoshme, dëshira që të këndonte. Në fillim askush nuk e dëgjo, se kënga ishte pothuaj si një pëshpërimë. Pastaj, gjithnjë nën pushtetin e asaj ndjenje të valë kujtimesh, bredhjes, krismash e fytyrash, këndoi me forcë, me gjithë zërin e tij dhe ky gjëmoi, sikur rrukulliseshin me potere ujra nga ujvara. Shoferi u habit se si mund të këndonte aq fort ky njeri, që fliste me zë të ulët dhe që ishte aq i dobët.

*...në dëborë e në tufan,
ngritën flamurin e kuq-e...*

Një zë tjetër, si një buçimë e dheut, zë i thellësive, e pasoi dhe kënga fluturoi larg:

gjer përtej në oqean!..

Ky ish zëri i trashë i Rakipit dhe kështu, një copë herë, erërat morën me vete njëren pas tjetrës copa melodish të forta, të ashpra e fragmente fjalësh edhe më të forta.

Sekretari as e kuptoi se kur doli para tyre shoferi dhe e hapi rrugën deri në majë të kodrës. Papritur, zëri i trashë pushoi dhe tha vetëm një fjalë:

— Atje!

— Sa larg është?

— As një orë. Kemi ecur mirë!

Të tre mbetën një çast në majë si hije të palëvizshme drurësh. Gjuhët e erërave e kishin lëpirë kreshtën shkëmbore dhe askujt s'i bëhej të besonte se ai send i mpirë, i verdhë e i ftohtë, ku shkëlqin këmbët e tyre, ishte toka!

Sekretari ish pushtuar i tëri nga kujtimet. Ai nuk përfytyronte aspak se si do të zbriste kësaj rruge karvani i gjatë, që do të futej në luftë me armikun kryeneç, të akullt e të fortë. Të tjera vegime të zjarra, të tjera vargane njerëzish me pushkë mbi plagët e supeve i mbinin në trurin e lodhur. Kujtonte pastaj fytyrën e vogël flokëverdhë të Sanijes së brishtë e të njomë, me ato këpucë të rënda të një ushtari të vrarë dhe sytë e saj të kaltër, që kishin mbetur edhe pas vdekjes pakëz të hapur, si të pulitur nga dita e fortë.

Oh, ky ishte një kujtim tepër i dhimbshëm, po kurdoherë ai kujtim i përtërinte mendimet e forcat, si një gurrë mali udhëtarin e etur.

Deri në fshat, edhe në kthim, ai ish i tëri një tufan i vërtetë forcash e mendimesh. Vargani i njerëzve, me lopata në supet, u nis për udhë.

Mbi rrugë endej erësira e bardhë. Tufani sikur ish strukur diku, prapa maleve, dhe i kish lënë vendin një dëbore të butë, që binte me sillogje të mëdha. Ishin shuar rrezet e fundit të dritës dhe hijet e maqinave dukeshin të stërmëdha në atë dritë të mekur. Ai, zeshkani dhe Rakipi hynë në barakë. Zjarri ish në të shuar dhe kishin mbetur vetëm thëngjinj. Ata hodhën një krah dëllinja dhe u ngrohën pas flakëve disa minuta, që u dukën pafundësisht të gjata.

— Ngrihuni, — tha ai, — Zjarri s'të lëshon kurrë, — dhe doli jashtë. Vështrimi i humbi në sfondin e mjegullt të malit, nga zbriste rruga prej fshatit. Ai e dinte se do t'i duhej t'i ngjitej përsëri asaj rruge, jo për të gjetur krahë pune për hapjen e rrugës, po gjithnjë për rrugë, për rrugë të reja.

TRAU I FUNDIT I SOLETËS

Betonimi kishte filluar qysh në orën shtatë të mëngjezit dhe vazhdoi gjithë ditën pa ndërprerje. Dielli u qëndronte si saç mbi kokë punëtorëve, të cilët nuk dalloheshin në ishin lagur nga të djersiturit, apo ishin futur në lumë me gjithë rroba. Zhurma monotone e transportierit të shurdhonte veshët. Po punëtorëve as që u bënte përshtypje kjo zhurmë, sepse ishin mësuar me të. Ashtu të lodhur, ca nga vapa, ca nga puna e vështirë, ata e kishin përqendruar vëmendjen vetëm te betoni dhe e rrembenin lopatë mbas lopate, duke e vendosur në shtresën e soletës.

Brigadieri Jaho Emiri ngjiste trarët e soletës me anë të vibratorit-cilindër. Ajo soletë kishte pesë trarë të mëdhenj me gjatësi një metër e gjerësi 40 cm, të vendosur secili mbi katër kolona betonarmeje; si dhe njëmbëdhjetë trarë të vegjël 30 me 20 cm, që kryqëzoheshin me trarët e mëdhenj. Duhej kujdes i madh në betonimin e këtyre trarëve, sepse mbi ta do të mbështetej gjithë pesha e soletës.

Kur u plotësua tetorëshi, brigadieri u tha punëtorëve se ai që ishte lodhur e s'mund të qëndronte, ta linte punën. Asnjëri nuk u largua. Të gjithë,

edhe pse ishin lodhur së tepërmi, qenë gati të qendronin deri në fund. Deri në atë kohë ishte betonuar pak më shumë se gjysma e soletës.

— Sa maqina me beton kanë ardhur deri tani? — e pyeti tekniku brigadierin.

— Dymbëdhjetë. Pra, sipas planifikimit, do të na vijnë edhe njëmbëdhjetë. Çdo dyzet e pesë minuta vjen një maqinë, po qe se na vinë pa ndërprerje, i japim fund para orës dymbëdhjetë.

— Ki parasysh se njerzit sa vjen e lodhen më shumë, — vuri në dukje tekniku.

— Jemi mësuar dhe herë të tjera, prandaj do të vazhdojmë me të njëjtin ritëm. Njëqoftëse ke ndonjë punë ikë, se kujdesemi ne për cilësinë e betonit.

Teknikut s'i erdhi mirë. Ju duk sikur brigadieri desh t'i thosh: «Mos e hiq veten sikur të vjen keq për ne që jemi të lodhur; më mirë thuaje troç që përton të rrish vetë».

— E di unë që ti, kujdesesh se të kam parë dhe herë të tjera, — tha duke i varur vetullat poshtë, — po mos na shit mend dhe mos na jep mësim, — shtoi mbas pak.

Brigadieri nuk e merrte dot me mend pse i tha tekniku këto fjalë. Nga kjo harroi vibratorin, i cili, duke qenë i lirë, u fut si zvaranik nëpër hekurat e traut.

— Fike, fike o Pilo! — i tha një puntori që ndodhej pranë çelsit të vibratorit. Pilua e ktheu dorëzën poshtë dhe zhurma pushoi në çast. Ndërkaq tekniku qe larguar. «Ç'njeri! — i erdhi inat Jahos. — Ta le plumbin brenda dhe pastaj fësht ja bën e ikën si hije». E ndezi vibratorin dhe vazhdoi të punojë, po mendja i rrinte gjithmonë te fjalët e tekni-

kut. «Të kam parë dhe herë të tjera». Vibratori fuqej thellë, e shpërndante betonin me vrull dhe Jahos i dukej se po me aq rrëmbim e qëllonin edhe fjalët e teknikut: «mos na jep mësim». E hoqi vibratorin nga vendi ku ishte dhe e vendosi në një vend tjetër, po mendimi vërtitej po aty. «E ka fjalën për betonin e asaj kolonës që doli keq këtu e dy muaj më parë», tha me vete. Jahua është nga ata që, edhe kur u thua çfardo për veten e tyre, nuk nxehen fare, po, po u the një gjysmë fjale të keqe për punën që bëjnë, nuk u del nga mendja për një kohë të gjatë.

«E mbaka mend, s'e paska harruar. Po pse ma tha tani, për të më mundur me fjalë? Po ka edhe të drejtë. Për ne ajo është njollë dhe, gjersa ta shlyejmë, na duhet punë e madhe. Po me punë do ta shlyejmë». U mundua ta hedhë mendjen gjetskë, po i delte parasysh ajo kolona e betonuar dy muaj më parë.

Atë ditë, për të ngjeshur betonin në kolonat dhe për t'i rrahur me sqepar armaturat nga jashtë, Jahua kishte caktuar Liman Rukën. Limani që treguar i vëmendshëm dhe i kujdesshëm, po, aty nga fundi, si duket i që mbaruar durimi dhe nuk e kishte ngjeshur sa duhej. Kështu, kur u hoq armatura, kolonës që qe betonuar e fundit, i kishin mbetur nja dy hekura zbuluar. «Keq, keq, — mendoi përsëri. — Po pësimi do të na bëhet mësim».

Aty rreth orës nëndë e gjysmë mbaroi betoni i maqinës së njëzetë. Deri atëhere, sa mbaronte njëra, vinte tjetra, mirëpo asaj radhe u vonua. Punëtorët u ulën të çlodhen, ata që e pinin duhanin, ndezën nga një cigare. Ndenjën ashtu nja dhjetë

minuta, pastaj, ngaqë ishin të djersitur, filluan të mërdhijnë, sepse edhe moti ishte freskuar.

— More, po na vjen të ftohtë, a lozim më mirë biz, — tha njëri prej tyre. Ishte Haliti, një djalë gjithmonë shakaxhi dhe i gëzuar.

— Këtij i zien gjaku, do që të ngjishet me pëlëmbë, — ja priti një tjetër.

— Rrini, ore, rehat, se jini të lodhur, ç'ju duhet të lozni, kini edhe tri maqina, tha tekniku që sapo kishte hipur lart.

— Po të rrimë shtrirë, pastaj kur të vijë betoni, duhet të na vesh një motor me korent pa të lëvizin krahët, — foli përsëri Haliti. — Hajdeni, ore, ngrehuni! — u tha shokëve.

U ngritën dy veta, pastaj edhe një tjetër. Mbas pak hynë në lojë dhe të tjerë.

Teknikut i vinte çudi me këta njerëz që s'mund të rrinin asnjë minutë të qetë, po donin ta përzinin lodhjen me gjallërinë e tyre të pashtershme. Bëri të largohej që aty, por Haliti e zuri për krahu.

Teknikut i erdhi zor dhe po bënte naze, po më në fund, deshi s'deshi, e pranoi ftesën. I erdhi edhe atij radha të goditej nga të tjerët, po kjo nuk zgjati shumë, sepse erdhi maqina e betonit.

— Edhe më bëje naze, — tha Haliti. Thuaj mirë që erdhi maqina e betonit, se do të kishte mbetur brenda rrethit gjithë natën, duke pritur pëllëmbët tona.

Halitit nuk i zemrohej asnjëri, sepse shakatë e ngacmimet i kishte të tijat, prandaj edhe tekniku nuk ju zemërua.

Loja u ndërpre menjëherë dhe filloi puna më me vrull. Gjithkund rreth e përçark zotëronte errësira dhe heshtja, ndërsa në atë objekt të ndriçuar

nga disa drita elektrike ndjehej hovi i punës ndër-
timtare, vrulli i njerëzve, zhurma e transportierit
dhe e vibratorit.

Tri maqinat e fundit erdhën njëra mbas tjetrës
dhe një pjesë e betonit që mbeti në fund qysh nga
maqina e parë, e humbi aftësinë e duhur, prandaj,
për ta prurë përsëri në markën e nevojshme, e për-
zien me një sasi çimentoje. Kjo punë ua shtoi më
shumë lodhjen.

Kur mbeti nja një metër kub beton, brigadieri
i tha teknikut se nuk do të plotësohej i gjithë trau
i fundit i soletës, prandaj pjesën tjetër duhej ta pre-
gatisnin vetë .

— Prit, të mbarojmë këtë që kemi njëherë,
pastaj shohim e bëjmë. Fundja e plotësojmë nesër
atë pjesë të traut që do të mbetet.

— Po si u ndërpreka trau në këtë mënyrë, nuk
ka rrezik që të shembet?

Teknikut i ra një hije e rëndë në fytyrë.

— Kush ka më shumë përgjegjësi për këtë,
shoku brigadier, ti apo unë?

Jahua nuk i lëshoi rrugë kësaj radhe.

— Nuk na hyn shumë në punë përgjegjësia,
shoku teknik. Përgjegjësia është si ta ndjesh, po
unë mendoj që në radhë të parë është detyra. Pra,
detyrën e kemi të barabartë, si ti, si unë dhe të gjit-
hë shokët e tjerë. Përveç rrezikut të shembjes, po
të mos përfundohet betonimi qysh sot, brigada do
të blokohet nesër, sepse nuk mund të fillojmë mura-
turën e katit të dytë. Prandaj, do s'do ti, trau do ta
betonojmë pa ndërprerje.

Ndërsa tekniku me brigadierin po vazhdonin
të grindeshin, puntorët po hidhnin lopatat e fundit

të betonit. Trau ishte mbushur nja tridhjetë e pesë centimetra, duke kaluar nga kolona e tretë.

— Atëhere në rregull, — u tha tekniku punto-rëve, duke mos ua vënë veshin fjalëve të brigadierit.

— Largësia ndërmjet dy kolonave është 2 metra, pjesa e tretë e traut është mbushur deri në sakomatë, pra në 1,6 e lartësisë midis kolonave. Teknikisht është krejt e lejuar që në këtë vend të ndërpritet betonimi. Ti, Jaho Emiri, derisa të jem unë këtu përgjegjës për punimet, do të zbatosh urdhërat e mia, kur të bëhesh vetë teknik, vepro si të të duket më mirë.

Jahua po rrafshonte sipërfaqet e betonuara të traut me mallë druri. U ngrit që t'i pyesë shokët çfarë thoshin, po... malla i ra nga dora. Nga fjalët e teknikut ata ishin çarmatosur dhe njëri mbas tjetrit zbritën nga soleta, ndërsa punëprishësi e shikonte sikur do t'i thosh: «E, kujt i shkoi fjala?»

— Ke ndikuar keq në ndërgjegjen e antarëve të brigadës, shoku teknik. Fjala jote e mirë do t'u jepte zemër, do t'i inkurajonte shumë.

I la veglat në vend dhe shkoi te shokët. Ata ishin në magazinë, po zhvishnin rrobat e punës dhe po bëheshin gati për të ikur. Te dera u ndodh ballë-përballë me Halitin.

— E di ç'dua nga ty? — i tha duke i vënë dorën në sup dhe, si e pa që tjetri ishte gati ta dëgjonte, vazhdoi: — Ta bësh teknikun të hyjë në vallen e punës, ashtu siç hyri në vallen e lodrës.

— Tani u kujtove ti, kur mbaroi betoni!

— Pikërisht pse mbaroi betoni na duhet ta pre-gatisim vetë e ta kryejmë edhe atë punë që na ka

mbetur. Të mos e prishim gjithë kazanin për një qepë.

Haliti vuri gishtin në tëmthin e majtë dhe, me një qendrim prej oratori shakaxhi, ju drejtua shokëve:

— Dëgjoni këtu, shokë! Përpara na del një detyrë e rëndësishme! — Pastaj u foli njerëzisht. — Të mos e marrim me shaka...

— Ti vetë po e merr me shaka, — ja priti një nga shokët.

— ... Ashtu është, — e mori përsëri fjalën Haliti. — Unë e mora me shaka, por tani po flas me gjithë mend. Brigadieri ka të drejtë, prandaj o burrani t'i përvishemi punës.

Ai u nis i pari dhe mbas tij gjithë të tjerët.

Ndërsa ata punonin me gjithë shpirt, tekniku rrinte në vend i inatosur. «Po pse vepron kështu ai?» mendonte me vete Jahua. Ç'humbet ai po ta mbarojmë sot punën e nesërme? Egoizmi që po ja shkatërrojmë me punën tonë, zemëron!

Tre çerek metra kub beton që duhej, u pregatit brenda një çerek ore dhe mbas kësaj filloi të transportohet. U duk sikur puna shkonte mbarë, po nuk zgjati shumë dhe doli rripi i transportierit.

— O burrani ta ndreqim, — u dëgjua zëri i Jahos, ndërsa tekniku buzëqeshi me ironi.

— Po ky ç'më rri si hu, kur ne po na del shpirti me gjithë këtë derr rripi, — foli Haliti nëpër dhëmbë i nxehur. — Ja tregoj unë tani. — Dhe me qëllim e tërhiqte rripin nga ana e kundërt.

— Jo andej, o Halit, se i more në qafë shokët që po e shtyjnë në drejtim të kundërt.

— Pa rri rehat aty ti dhe mos na çaj kokën! Po të të dhimbsen shokët, vjen e i ndihmon dhe

nuk më rri si djalë beu. Unë kështu di, kështu punoj, po dite ti më mirë, hajde më mëso.

Teknikut ju duk sikur i mori koka flakë.

— Ja kështu shtyhet, — i tha Halitit me inat dhe i dha rripit me forcë.

Rripi i transportierit i mundoj shumë. Kur mbaroi betonimi plotësisht, ora kishte kaluar nga tre.

— E brigadier! A e futa teknikun në punë, apo jo? — ju krekos Haliti Jahos.

— Po, por tani punët e tjera i kemi përpara.

Në mëngjez, kur erdhën brigadat e tjera, të gjithë e shikonin punën e brigadës së Jaho Emirit. Me admirim vërente edhe tekniku, që e njohu për herë të parë forcën e madhe të këtyre puntorëve në betonimin e traut të fundit të soletës.

PEJZAZHI

Është e çuditshme se si lidhen gjërat ngranjëherë. Tek shikoja një ditë një pejzash të një mikut tim piktor, pa dashur m'u kujtua një ngjarje që ndodhi kësaj pranvere në kantierin tonë.

Në vështrimin e parë duket sikur nuk ka asnjë lidhje në mes zanatit tonë dhe punës së piktorit, e, megjithatë, kur vjen rasti për të gjykuar një vepër arti, dashur pa dashur kërkon të gjesh në art atë që ke parë dhe provuar vetë në jetë. Kështu ndodhi edhe me mua, atë ditë kur rrija e sodisja pejzazhin e mikut tim. Shikoja atë vepër dhe sillja ndërmend ato pamje të natyrës sonë që më ka rastisur të shoh.

Pejzazhi i tij paraqiste një qafë mali, që hapej në mes, sikur t'i kish rënë dikush me shpatë dhe që andej të kishin shpërthyer lule plot ngjyra. Lulet ngjiteshin gjer lart, duke përhapur në dy krahët e tablosë një dritë të ëmbël dhe qetësuese. Ishte kjo një bukuri delikate dhe e egër njëkohësisht, bukuria e natyrës shqiptare në një ditë të kthjellët prilli, që ne, njerëzit e kantiereve, e kemi parë sa e sa herë, po që dora e piktorit e kish hedhur me mjeshteri në pëlhurë dhe e kish përmyllur në një kor-

nizë. Pejzazhi aty për aty më pëlqeu; më tërhoqën e më bënë për vete tonet e hapura të ngjyrave, ajo atmosferë plot dritë. Po nuk kaloi shumë dhe përshtypja ime sikur filloi të zbehej. Ndjeva një farë pakënaqësie. Në fillim ja vura fajin syrit tim të pastërvitur, shijes sime të paformuar ende për të ndjerë plotësisht një vepër arti. Po, me sa kuptova më vonë, s'ishte vetëm kjo arësyeja. Pakënaqësia sa vente e bëhej më e madhe. Dhe kjo ndodhi sidomos kur nisa ta gjykoj veprën e mikut tim përmes përshtypjeve e kujtimeve që kisha nga jeta ime nëpër kantierë. Syri s'më gjente qetësi dhe ashtu, i shqetësuar, diç kërkonte dhe s'e gjente gjëkund. Pikërisht në këtë çast më erdhën ndërmend ngjarja që ndodhi kësaj pranvere në kantierin tonë.

Ne punonim prej disa vjetësh për ngritjen e një hidroçentrali. Në kohën kur ndodhi ngjarja, puna në hidroçentral ish në mbarim e sipër dhe kantierit i duhej të largohej prej aty. Prisnim me ditë urdhërin që të shkonim në një vepër tjetër të pesëvjeçarit, sadoqë nuk na vinte mirë, sepse dëshira e të gjithëve ishte të qëndronim deri në fund e të merrnim pjesë në inaugurim. Po, për çudinë tonë, ndërsa prisnim këtë urdhër, papritur na thanë të qëndrojmë gjer në fund. Më thirrën mua, si përgjegjës kantieri, në drejtori dhe më udhëzuan detyrën e re: puntorët e kantierit tonë ngarkohehin të hapnin një rrugë të shkurtër, që do të kalonte përmes një qafe që quhej Qafa e Vetëtimës. Rruga duhej të përfundonte sa më parë, mbasi prej saj varej edhe afati i inaugurimit. Unë, me të marrë detyrën e re, u ktheva në kantier dhe u fola puntorëve. Natyrisht, ata u gëzuan dhe mezi ç'prisnin të fillonin nga puna. Sipas planit që kisha bërë

me inxhinier Nikon, ditën e parë do të punonte një eskavator dhe disa nga puntorët. Më vonë do të hidhnim forcat e tjera. Në mbledhje caktuam puntorët, po, kur erdhi puna te eskavatoristi, nuk e patëm lehtë. Eskavatoristët tanë janë të gjithë çapajeva dhe unë e Nikoja e kishim vështirë të bënim dallim. Kështu që kjo çështje u zgjidh menjëherë në mes tyre. U ngrit Ademi, ai eskavatoristi zeshkan, dhe propozoi xha Petron, Petro Kadenë. Petrua nuk ishte i vjetër, i kish apo s'i kish të pesëdhjetat, po, në mes puntorëve të rinj, ai dukej i moshuar. Kur e shikoje, nuk ta mbushte syrin: një trupvogël, me ca duar të mëdha, me vetullat kalëshë që i mbulonin sytë e vegjël e të thellë, me një palë mustaqe të shkurtëra, të thinjura pothuajse si dhe flokët. Mbante veshur gjithnjë një palë kominoshe të arnuara, Thashë, nuk ta mbushte syrin në të parë, po punën e tij s'e bënte njeri në kantier. Ishte fjalëpakë dhe punën e bënte të saktë e të shpejtë. Prandaj më erdhi mirë që e propozuan vetë shokët.

— Do ta marrësh përsipër, o xha Petro? — i them.

Ai ngre kokën dhe, me atë zërin e tij të trashë, më përgjigjet:

— E marr, shoku përgjegjës, si mos e marr. Fjalë është ajo!

Shokët e tij të rinj rrahën shuplakat. Xha Petros i qeshën sytë. Unë vështroj nga puntorët dhe para se ta mbyll mbledhjen, jap porosinë e fundit:

— Eskavatorin ta çoni atje nesër që pa gdhirë. Për këtë ngarkohet Lamja të ndihmojë me skuadrën e tij.

Të nesërmen, pasi bëra mbledhjen e mëngje-

zit me këshillin teknik, mora inxhinier Nikon dhe të dy së bashku u nisëm te vendi ku do të hapej rruga. Qafa binte pak si larg hidrocentralit. Duhej të kaloje nëpër fshat, pa të arrije atje. Ishte një vend disi i mënjanuar nga gjithë ajo lëvizje e madhe që kish nisur prej vjetësh atyre anëve. Fshatarët nuk di sepse e quanin Qafa e Vetëtimave. Vendi ishte shumë i bukur e ngado që të hidhje sytë, të kënaqte gjelbërimi. Pastaj përreth kishte burime të freskëta. Mëngjezi i bukur i asaj dite pranvere të ftohtë të sodisje natyrën e ringjallur. Po ne, njerëzit e kantierëve, që punojmë në gji të saj e jemi mësuar, si të thuash, me agimet, me diellin dhe shiun, e kemi vështirë të përqendrohemi e të sodisim bukuritë që mund t'i kapë menjëherë njeriu që punon në zyrë a në studjo. Shpesh herë ne na rri mendja te puna që na pret. Kështu dhe unë atë ditë. Mendjen e kisha te puna që duhej të kish filluar. Ndaj, në vend të sodisja horizontin e pastër e të kthjellët që humbiste në pafundësi, më mbetën sytë nga Qafa. Shoh nga larg, atje përtej, eskavatorin e xha Petros me kokën përprjetë, si një lejlek që s'lëviz nga vendi. Toka sa është kafshuar pak. Puntorët janë shpërndarë në të dy krahët e eskavatorit. Shquaj vetëm Llazon e gjatë që ul e ngrë trupin herëpashere. Diçka të tillë bëjnë dhe të tjerët. Maqina gjigante nuk dëgjohet fare. Unë e Nikua shohim njëri tjetrin në sy dhe ngremë supet. Ç'bëjnë këta kështu? Puna duhej të kish filluar me kohë, kurse ata ende rrinë e diç presin. Ç'mund të kish ngjarë? Po dhe sikur t'i kish ngjarë ndonjë avari, duhej të na kishin çuar fjalë. Aq më tepër kësaj here, kur nga hapja e kësaj rruge varej fati i inaugurimit. E pyes inxhinierin i shqetësuar:

— Më bëjnë gjë sytë mua, apo punojnë ata atje?

— As unë s'po marr vesh gjë, — ma ktheu Nikua. — Diçka kanë ata ashtu. . .

E lëmë fjalën me aq dhe nxitojmë çapin. Marrim me vrap të përpjetën që na kish ngelur dhe dalim menjëherë përballë puntorëve. Prapë unë nuk po kuptoj gjë se ç'bëhet. Të gjithë kanë ulur kokën dhe seç kërkojnë përdhe, në mes të barit. Mos u ka humbur ndonjë vegël, mendoj, dhe janë vënë të gjithë për ta kërkuar! Eskavatori është edhe alamet maqine, po ja që dhe për një vidë të vogël të lëka në baltë! U afrohemi puntorëve të heshtur, pa ditur nga t'ja fillojmë. Disa prej tyre na shohin, drejtojnë trupin dhe vënë buzën në gaz. Unë ndjej nofullat e mia të shtrëngohen. Kështu na është bërë zakon ne drejtuesve: një gjë të mos shkojë mirë dhe shqetësohemi. Dëgjoj puntorët që më përshëndesin dhe s'më jepet t'u përgjigjem. Po, kur shoh xha Petron që më afrohet dhe më jep dorën, atëhere s'e përmbaj dot veten dhe i them me zë të rreptë:

— Ç'është kjo që po bëni, o xha Petro? Pse nuk kini filluar ende?

Ai më buzëqeshi, ndërsa sytë sikur i ndizen menjëherë prapa vetullave kaleshe dhe më thotë:

— Po punojmë, shoku drejtor, nuk po rrimë.

Ja kthej unë, jo pa habi:

— Si, mor, po punoni, eskavatori po flë. . .

Ndërkaq puntorët mblidhen përçark nesh. Xha Petrua gjithnjë i qetë vazhdon.

— Punë është dhe kjo që bëjmë, shoku drejtor.

— Ç'punë është kjo? — ja pres unë. — Ju sikur kini dalë për piknik.

Në mes nesh për një çast ndehet një heshtje e çuditshme. Mua pothuaj më janë mjegulluar sytë.

— S'është mirë, shoku drejtor — dëgjoj xha Petron të thotë.

— Çfarë s'është mirë, — ndërhyj unë që mezi mbaj zemërimin. S'është mirë t'i prishësh me hekur.

— Cilat t'i prishësh, more xha Petro?

— Po ja këto, shoku drejtor, lulet. Nuk i shikoni?

Unë përpiqem të mbledh veten dhe, sikur të përmendesha nga një dremitje e lehtë, rrudh sytë dhe shoh me vëmendje përreth. Gjithë vendi për-qark është mbushur me manushaqe. Kaq vë re unë dhe, mjafton kjo që ta ndjej veten ngushtë dhe të mbetem për një çast i nemitur.

Xha Petrua vazhdon të arësyetojë:

— Thashë të mos vejë dëm gjithë kjo bukuri, shoku drejtor. Manushaqja është lule e bukur, paçka se është më e druajtura nga të gjitha shoqet. S'na bëri zemra t'i biem me hekur. Thashë t'i mbledhim njëherë, po pastaj në dorë e kemi. Punojmë sot një çikë më shumë se s'bëhet kiameti...

Ai hesht, unë ngre sytë dhe shoh në duart e tij një tufë manushaqe të freskëta. Pastaj vë re manushaqe nëpër duart e puntorëve, nëpër xhaketat e tyre, pranë veglave të punës, në dritaren e eskavatorit... Kudo manushaqe më zë syri. Shoh ato dhe fytyrat e qeshura të puntorëve dhe më duket vetja për një çast si i huaj në mes tyre. Nuk di ç'të them aty për aty. Ndjej të më dehë era e manushaqes. Një puntor më zgjat një tufë me lule. E marr dhe s'flas. Më vjen turp nga vetja për atë që ndodhi. Megjithatë, xha Petrua përpiqet të më qetësojë. Ai ende pandeh se unë, me heshtjen time, dua ta qortoq për manushaqet. Më thotë:

— Mos e prishni gjakun, shoku drejtor, ja, i mblodhëm këto këtu përpara dhe tani do të fillojmë nga puna...

Unë vë buzën në gaz dhe i them:

— S'ka gjë, xha Petro!

Po ai s'e dëgjon zërin tim. Në këtë kohë, Lamja ka ndezur motorin e eskavatorit. Zhurma e maqinës mbyllet gjithë zërat. Xha Petrua drejtohet nga eskavatori. Punëtorët marrin veglat dhe secili fillon nga puna. Mbetem vetëm me Nikon.

Hapa një bisedë me inxhinierin që vazhdoi pothuaj gjithë atë ditë. Ndenjtëm në Qafë deri afër drekës. Në pushim bëmë një mbledhje të vogël, ku dhashë disa porosi lidhur me punën dhe në fund e hodha fjalën te manushaqet. Tërthorazi u kërkova puntorëve falje për atë që ndodhi. Desha ta mbyll me aq. Po xha Petrua, sikur ta kishte kuptuar bren-gën time, u ngrit nga vendi dhe tha:

— Mos e thuaj atë fjalë. Ti ishe në të drejtën tënde, puna është punë. Po e kisha gjetkë hallin. T'i thoni Kolit, drejtorit tonë të përgjithshëm, që puntorëve të kantierit të gjashtë ua do zemra ta pagëzojnë vetë këtë rrugë. Duam ta quajmë «Rruga e Manushaqes».

Unë nuk u mendova shumë që t'i përgjigjem. Për të larë, si të thuash, atë që bëra, i veshva vetes të drejta që s'më përkisnin dhe ua miratova propozimin aty për aty. Puntorët u gëzuan pa masë dhe rrahën duart të kënaqur.

Tërë atë ditë dhe disa ditë më vonë, s'mu largua nga mendja kjo ngjarje. Kaluan disa kohë dhe kjo ngjarje m'u kujtua, siç ju thashë në fillim, rastësisht, kur shikoja pejzazhin e mikut tim. Nuk di në pata të drejtë të isha i pakënaqur nga ajo

që pashë. Po për një gjë jam i bindur: po ta kish parë miku im atë që ndodhi në Qafën e Vetëtimës, ku punonin puntorët e mi, nuk do ta kish lënë pejzazhin e tij vetëm me qiell, tokë e lule. Me siguri do të vinte aty xha Petron, në mos atë, shokun e tij e në mos ata vetë, patjetër punën e duarve të tyre. Atëhere, syri im, që është mësuar gjithë këto vjet ta shohë pejzazhin shqiptar gjithnjë në ndryshim, nuk do të shqetësohej, siç u shqetësua, po përkundrazi.

LEGJENDA E UJIT

Fshat i madh e i plotë ky Shavari i Poshtëm: fushën e ka të gjerë, arat me tokë tul, vreshtat kundrejt diellit, pllajat me lajthishte, përrrenjtë me thana, kurse tani vonë e përmbyti kodra me fidane e drurë molle; po... ç'e do, ujë për vaditje ka, për të pirë s'ka!

Devolli i gjerë, që i kalon fushës, me ato ujëra të shumta, ja bën me sy e sikur i thotë: «Për të pirë, o Shavar i Poshtëm, për të pirë dhe për të larë faqet, ja ku është tutje, në mal, ai «Kroi i çobanëve», që gurgullon gjithë zulmë e shkumë. Në ke burra, o Shavar, në ke burra e djem e në ua mban, rrëmbeni kazmat e bëni përpjetë!».

Keq e kanë njerëzia, sidomos në të korrat, kur djersa kullon si çurkë dhe dielli djeg si saç, keq e kanë për një pikë ujë të ftohtë e të lehtë. Por të keqen e ndjejnë edhe më fort në shtëpi, kur vjen miku nga larg e kërkon «një gotë ujë». Psherëtinë këto nuset e zënë në gojë dhallën e bardhë të mtisë, verën e kuqe të zamzanes, qumështin e gavetës apo kosin e poçes së madhe... po më kot, miku kërkon ujë, pa «të jetë si të jetë».

Dhe e sjellin me gjysmë zemre atë që ndodhet, po duke mërmëruar:

— Ujë i thënçin, katran është, po ç'ti bësh...

Miku e pi se është i lodhur e s'thotë gjysmë fjale, po i zoti e di ku i pikon shtëpia. Fillojnë spjegimet e kuvendimet, historitë dhe tregimet.

— Një pus të vetëm kemi në fshat. Se kush e quajti egjyptian dhe ashtu i mbeti. Punon me një krah të madh druri e me një katrovë në majë të krahut; një pus për dyqind e sa shtëpi. Ujin e ka si të zier, të trashë si vaj, të bardhë si bozë nga gëlqerja, kur e pi; për të larë... gratë e dinë, për fytyrën është si zhur. Le halli i çupave, kush i dëgjon ato. Tani vonë zunë sjellin ujë nga mali, nëpër shishe, për të larë faqet.

— Jaaa! Çudi!

— Dimrit e kemi keq me gjënë e gjallë. T'i shpiesh gjer në lumë nëpër dëborë, është e pamundur, dëmtohen ato të imtat; kështu, barinj të dalin me dhentë përpara dhe me kopanët e plisave në krah. Me kopanët thyejnë akujt e llokaçeve, sepse në një postaf të vetëm nuk i gazit dot gjithë bagëtinë, sidomos na dështojnë delet. S'është ujë ky, shafran është, po ç'ti bësh!».

Tregojnë pleqtë e betohen se qindra vjet me radhë, njerëzia në Shavar të Poshtëm, e kanë vrarë mendjen për brengën e ujit, kanë çallstisur, se Shavari duket në mes të fushës e përmbi të shquhet që atje tej, si sqep i një përbindshi, ai krahu i madh e i drunj të i pusit egjyptian.

Ja, gjallë është edhe sot e kësaj dite Bido Çili. Gjithë jetën e tij ai është përpjekur për të sjellë ujë të mirë në fshat. Tani i ka kaluar të njëqind vjetët, ka mbetur i verbër që kur ishte shtatëdhjetë, po s'ka ndërmend të vdesë.

Dhe aq gjatë tregohet historia e ujërave aty,

në Shavar të Poshtëm, sa vetë Bido Çili e mbyll
kështu.

— Ç'e pyet, more bir? Përrallë arapi!

Përrallë arapi sot e përrallë arapi mot, gjersa
këta të rinjtë që erdhën vonë, i vunë një emër
tjetër.

Si u zgjerua Shavari, domosdo edhe shkolla
zgjeroi kthinat e hodhi një kat të ri përsipër. Në
fillim, mësonjësit ishin të ardhur, «jabanxhinj» i
quante Bidua, po tani ata, ose më mirë ato, që japin
mësim, janë të gjitha shavarase. Se kështu e solli
koha: gratë po ua rrëmbejnë këto punë burrave
edhe andej nga Shavari dhe u thonë aqik atyre, herë
me shaka e herë me të vërtetë:

— Ju, o djema, ju o burra, merrni nga një
lelek të madh, merrni edhe nga një pallamare¹⁾
më të madhe dhe, o burra, në fushë, se atje ka pëi
të korrur, jo shaka!

Dhe ja kështu, këto shavaraset përrallën e arapit
tani na e quajnë «Legjenda e ujit». Legjenda e ujit
në Shavar ka qindra vjet me radhë...

Kështu u flasin nxënësve në shkollë.

Aty tërviti u kthye nga ushtria në Shavar të
Poshtëm Qemal Çili. Kur shkoi, s'i pat dalë mus-
taqja, tani ka një mjekër të dendur e të fortë, sa
mezi i kalon brisku, edhe kur është prej atyre më
të mirëve. Dhe, si e thotë fjala, dardha bie në dardhë.
Edhe Qemali i ri filloi të ecë në rrugën që patën
shkelur shumë burra të shtëpisë së tij, si i gjyshi,
që, sikurse thamë, ishte i verbër dhe e mbante
mjekrën një pëllëmbë. Dhe thonë në fshat (po hyre

1. Lelek e pallamarë — drapër i madh dhe një ve-
gël druri, që ndihmojnë për të korrur.

në të thellat e po zure mik, ai të thotë vetë) thonë se Bido Çili e ka lënë mjekrën për punën e çezmave, si punë zije. Si e qysh, do ta spjegojmë kur t'i vijë radha. Ka të tjerë që e ngasin e i thonë se e ka lënë mjekrën që kur i vdiq e shoqja. Jo, besa! Të këtilla gjëpura mos i besoni.

Bido Çili tregon ngjarje të lashta për punën e çezmave. Tregon e zë në gojë një aga shumë të pasur atje në Shavar, që kishte ngulur këmbë për jo, sepse do t'i shkonin sulinarët nëpër vreshtat. Rrëfen për një tjetër efendi, që deshi të çajnë kanalet të tjerët e ai të mbante sehir; tregon për një bej, që i vërtiti punët vjete e vjete me radhë, gjersa i hëngri paratë e mbledhura nga fshati.

Bido Çili tregon edhe një rast të tillë:

«Njëherë më ra në kokë një mendje e mirë. Gjumi s'më zuri dhe i shkova herët në mëngjez Reshat beut. «Bej efendi, të falem e të uroj ditën e mbarë, po sonte m'u kujtua që për punën e çezmave...»

Beu më dëgjoi gjer në fund e, pasi mbarova, këceu përperjetë e përpoqi duart, unë u gëzuash, se e pashë që edhe atij i pëlqeu mendimi im, po... ma ktheu duke psherëtirë:

«Bobo, gjynah, o Bido, gjynah, o lumëmadh, gjynah, o fukara, gjynah. Ja, mendje e mirë, e ndritur e drejtë, po... punë që s'bëhet, vajti fir». «Po pse s'bëhet, o bej? — pyes unë. — Po s'bëhet, o qyqar, — ma ktheu ai, — s'bëhet sepse e the ti. Do të thonë në fshat se kjo punë u bë, sepse i shkoi ndërmend Bidos. Ç'më mbetet mua pastaj?».

Ka qenë një kohë, jo më shumë se tridhjetë vjet të shkuara, kur fshati e kishte mbushur mendjen top që ta sillnin ujin e «Kroit të çobanëve»,

pa të dalë ku të dalë. Bile nisen të hapin kanale, filluan të pjekin qyngje, zunë të afronin gurë. E keqja ishte veç te guri vakëf. Jo vetëm se atje kishte shkëmbinj që s'dëgjonin fare as nga vareja, as nga qysqia, po sepse, Vendi ish vakëf e s'afrohej njeri. Dhe, ngaqë shkëmbi ishte shumë i madh, atje mund të thërrisje e oshëtima ta kthente zërin prapë. Po Bido Çili, sado besimtar, e pati pleqësuar punën ndryshe: «Ne ndonjë të keqe s'bëjmë. Kur të gurgullojë uji këtu, edhe vakëfit, edhe zotit do t'i bëhet qejfi».

Dhe Bidua vetë kishte qenë ai, që kishte futur llokumet e dinamitit nëpër brimat që i hapte vetë me qysqi. Po, kur arritën aty nga e njëzeta, nga gazi, nga nxitimi e nga padituria... plasi një minë fare afër dhe ja rrëmbeu Bidos dritën e syve. Fshati ishte trembur nga hieja e vakëfit. Më kot kishte thirrur Bidua vjete me radhë që ta vazhdonin punën, më kot kishte bërë be e rrufe se ishte nxituar. Ja, që atëhere, nga humbja e dritës së syve dhe nga dëshpërimi, Bido Çili la mjekër e mbeti në errësirë për gjithë jetën. Dhe na u mbyll atëhere ai gëzim i Shavarit të Poshtëm, ashtu si kanalet u mbyllën vetiu, se u gremisën dhe i sheshoi koha.

Po koha ndryshoi. Kur u kthye Qemali nga ushtria... Këtu e thamë njëherë, kur zumë në gojë dardhën që bie nën dardhë.

Pra, u ngrit tani Qemali me shokë e shoqe dhe atje, në mbledhje të rinisë, e vendosën me fjalë burri që, së pari, ta bëjnë shesh atë Gurin Vakëf e t'i japin të kuptojë pleqërisë se sa i bën lëkura atij Gurit Vakëf!

— Do ta shkatërrojmë me llokum domosdo, se, kur ke mashën, pse të djegësh dorën!

Qemali me nja dy shoqe shkuan te komandanti i repartit të ushtrisë dhe ju lutën për çka u duhej. Nuk ua prishi komandanti dhe u dha dinamit, u dha fitil, kapsollë.

Sa për zanatin, jo më kot Qemali kish punuar dy vjet në ushtri me dinamit e me fitila. Se Qemali s'ishte gjyshi Abedin.

Po sido që flasim kështu, Qemali me shokë e shoqe, para se të nisnin nga puna, një mbrëmje i shkuan xha Bidos për ta dëgjuar e për t'i marrë një mendje. Ai i priti, i dëgjoi, u gëzua, po u tha:

— Ta dini, t'i kemi fjalët përpara, është vësh-tirë; duhet zemër, punë, krahë, duhen qyngje, duhen edhe para:...

— Jo, babagjysh, s'ka ç'na duhen paratë, ne të gjitha do t'i bëjmë vetë, me krahët tona.

— Unë s'jua shoh krahët, biro, se jam i ver-bër, po e marr me mend që i kini të fortë, se të rinj jini. Hapni sytë mos turpërohi, duhet punë dhe duhen para.

— Ta thamë babagjysh, paratë s'na duhen.

— Duhet, mor djema, duhen, moj vajza, se, si i thonë fjalës, paraja e ngre ujin përpjetë. Ja, ku do ta gjeni dinamitin, fitilin?..

— Ato i gjetëm, babagjysh. Po, kur të sjellim ujin, ç'do të thuash?

— Do t'ju uroj, biro, do t'ju uroj e do vi të laj fytyrën me ujin e «Kroit të çobanëve». Kam shpresë se do më hapen sytë edhe njëherë; po nxitoni, se sot jam e nesër s'jam.

* * *

Në tre fronte filloi puna e çezmave. Një palë punonin kanalet, një palë shkuan në qeramidhanë

për të gatuar e pjekur qyngje, kurse te Guri Vakëf punonte vetë Qemali me pak shokë e shoqe. Tri ditë e tre net ka gjëmuar gryka atje te Guri Vakëf. U tund jo vetëm gryka, jo vetëm Shavari i Posh-tëm dhe ai i Lartmi, po edhe mali vetë. Dhe Bido Çili, kur dëgjonte ato shungullima, mbante dorën në zemër dhe qante nga gëzimi:

— Hej, u vaftë mbarë!

— Hej, sa më gëzohet zemra!

— Hej, sa zili ua kam!

Si u shkatërrua guri dhe u bë cifla-cifla, te gryka mund të thërrisje sa të të hante zëri, po oshë-tima s'ta kthente më zërin. Por sadoqë dinamiti bëri punën e vetë dhe hapi rrugën, duhej ende punë me krahë për të shkukur ata gurët që kishin mbetur anës si dhëmbë të këqinj.

Atëhere mund ta shihje Qemalin çfarë djali ishte: me një palë pantallona të shkurtëra në trup, me ata krahë tërë muskuj të fortë, me gjoks prej divi e me shpatulla një pash të gjera. Djersa i shkonte çurkë e ai hap e ngre ata krahë me varë në duar, bjerë e bot këtyre gurëve, si në gjë të hasmit. Çupat, që punonin aty afër, kur e shihnin atje lart, ashtu, tërë forcë e burrëri, tërë zulmë e djalëri, diç pëshpërisnin kokë më kokë.

Në këtë vërsulje për të shuar legjendën e ujit, u lëshua gjithë fshati, të vegjël e të mëdhenj. Po, me që pyll pa derra s'ka, kështu ndodhi në Shavar edhe një Shaqo Terssi. Shaqo individi, e thërrisnin, se rri mënjanë me ato pak dynymë, me lopën e gomarin e hiç tjetër gjë.

Pra, ky Shaqo Terssi ndenji mënjanë edhe në punën e çezmave. Bile thoshte se edhe kjo vërsulje do të hynte në përrallën e arapit. Kur kërciste

kazma kanaleve, Shaqua me gomarin shkonte në mal për dru; nisej natën e, kur kthehej, hidhte badiava ca «puna mbarë!» përpjetë e tatëpjetë. Po, kur arrinte te Guri Vakëf, Shaqos i hante në gjuhë po të mos lëshonte ca romuze:

— O Qemal-ooo, po të paskan futur çupat në stlok, ooo!

— O Qemal-ooo, atje te shkëmbi do lësh djalërinë-ooo!

Po Qemali me shokë s'ja zgjatnin e s'i flisnin fare.

E rëndë ka genë puna atje, në Shavar të Poshtëm, për të sjellë ujin në fshat. E vështirë dhe e gjatë, afro njëqind e ca ditë, po ditë behari nga të mëdhatë.

Më në fund ai kanali i madh, i gjatë tre sahat rrugë, u ndër e gjarpëroi pyjeve, pllajave, livadheve, grykave e gjer në Shavar të Poshtëm. Kur kanalit ja shtruan qyngjet prej argjili të pjekur punë e madhe, kur qyngjeve u lëshuan ujin dhe ky i njomi sulinarët, atëhere veç ta shihje që nga maja e malit, veç ta shihje që nga «Kroi i Çobanëve» atë ujësje-llës... Dukej si një damar i kuq, si një damar i gjallë, që rrihte nga gulçimet e gurgullimat e ujit.

Festë të madhe kanë bërë asaj vjeshte në Shavar të Poshtëm! U tund fshati që nga themelet e gëzoheshin njerëzia kur shihnin sulinarët që gumëzhnin e shkumëzonin atë ujin e ftohtë e të lehtë të kroit të malit.

Disa nga vajzat shkuan dhe e morën Bido Çilin për dore. E shpunë në çezmën e mesit. Ai ecte duke kërkuar rrugën me majën e shkopit. Njerëzia mbain mend se ai pat thënë: «Po ta sjellin ujin e malit,

do pi e do lahem me të dhe do më vijë drita e syve!»

E afruan te postafi, ai u ul në të, shkopin e flaku tej.

Pas gurgullimës, e gjeti vetë sulinarin. Vuri gojën dhe piu ujë me gllënka të mëdha, piu me zhurmë e potere, si ai kali kur del nga vrahu. Pastaj futi kokën nën sulinar, e hoqi, trazoi rrjedhën me dorë. E prekte ujin sikur ishte i fortë e donte ta shtrëngonte në pëllëmbë. Psherëtiu e u hoq mënjanë.

— Ju lumtë, o bij, ju lumçin duart, moj çupa. U gëzova, por sytë s'm'u hapën. Veç ta dini, gazin tim ju s'mund ta kuptoni.

Nga sytë e verbër i kullonin lotët e i bashkoheshin me bulëzat e ujit nëpër mjekër.

SHKALLËT E GURTA

1.

Një ditë Nkolli i Pergjokajve pruri me vete, nga një fshat i largët, një mëzat. Një mëzat zik me tërë një njollë në turi, që ja pushtonte buzët e përveshura, hundën e shtypur dhe syun e djathtë të gjithë, bashkë me veshin e asaj ane. Ata dy sy të ndryshëm që, ndonse vështronin në të njëjtën mënyrë, dukeshin sikur vëngëronin, Marës së vogël i shtinë frikë.

Po mëzatit i bënë një pritje të madhe në shtëpi: kush e kush t'i gëzohej më shumë. Kishin të drejtë dhe, ndonse kafsha i ngjalli frikë së voglës, edhe Mara ndjeu gëzim. Gjer tani, ata kishin pasur vetëm një ka, larojin, kurse paskëtaj do të bënë një pendë të plotë, dhe me çfarë kau të ri e të shëndoshë! Babai do ta mësonte shpejt në zgjedhë mëzatin.

Për çudi, nëna s'e priti aspak mirë këtë. Që kur u duk mëzati tek e kthyerë e rrugës që futet në tokat e Pergjokajve, nëna e diktoi dhe u sul e i doli përpara me një frymë nga oborri. I fluturonte shamia e zezë në kokë e i hidhej gjoksi që mbante me të dy duart. Mara s'e kish parë t'ëmën të këcejë ashtu kurrë, ndonse ajo nuk ishte si gjithë

nënat: ajo kurdoherë e hedhur ishte, e gjallë, e shpejtë, dhe me babanë — jo si nënat e tjera, po me fjalën pak si të përpjekur. Ndjehej nëna në shtëpi.

E pra, kishte këcyer Dava e Nkollit që nga oborri, sikur t'i kishte këcyer ai damari i saj, dhe me të shoqin këmbëu ca fjalë, që e bija s'i dëgjoji të gjitha. Veç kaq dëgjoji kjo:

— Nuk bëre mirë! Ta kam thënë! E paç më qafë!

Vajza s'mori vesh asgjë, po e pikasi që prindët u zunë për atë mëzat të zi, që iu faneps atje tej, në të kthyer të bregut, midis gjerdheve, si një gjë e frikëshme. Dhe që atë çast iu zgjua një mëri e vërtetë ndaj kafshës, sepse u bë shkak grindje midis prindërve. Dhe kur gjyshja plakë iu gëzua mëzatis si e dëshiruar, kur axha e uroi babanë se kishte ditur të zgjedhë «në haur të Gjinit», kur djali i axhës, Prenga, i erdhi kafshës rrotull, i fërkoji vithet e qafën, dhe kur mëzati, me një lëvizje të kreit, gati sa s'e mbërtheu me brinjët e tij si hej, Marës i ngriu gjaku, ndërsa nëna i tha babait:

— Më ndjell zemra keq, or ti!

Babai i dha një shqelm mëzatis dhe ky u fut në katua me turfullimë. Së voglës i bëhej se, me atë turfullimë, përbindshi, po të tundej fort atje brenda, kulla e tyre e moçme mund të shembej.

Ishte strukur vajza nën thanën që sapo çilte, midis luleve të verdha truma-truma, po thana s'e fshihte aspak. Lulet mbanin një erë të lehtë e të athët, që Marën e këndellte. Vajzës iu bë vërtet sikur u struk në to. Maçoku i shtëpisë, që e pa, rendi tek ajo me zili dhe ninsi t'i fërkohet nëpër këmbë, i ngrohtë. Kish edhe maçoku një pullë të

madhe e të bardhë mbi faqe, dhe që i zinte njërin sy, po turi të frikshëm s'kish, — ndofta se s'ish i zi, po i kuq. Mëzati pëlliti një katër-pesë herë në katua, kulla utëriu përbrenda fort, Mara shtrëngoi maçokun në duar, kulla nuk lojti vendit.

2.

Jo, kulla s'lojti vendit as atë ditë, as të nesërmen. Po ai mëzat abrash, me atë njollë të hatashme mbi turi dhe me ata dy sy të vëngëruar, solli grindjen. Tamam sikundër tha nëna, së cilës i ndillte zemra keq.

Mara s'e kish kuptuar përse nënës i ndillte zemra keq. Po ajo nisi ta ketë frikë me gjithë mend mëzatin, dhe ta ketë mëri, kurse babai u lodh me kafshën e s'e krijoi dot pendën e qeve që kishte shpresuar.

Ziku hyri në zgjedhë, po ama si! Laroj, sikur të kishte gojë, mund të tregonte se ç'pati vuajtur. Se jo vetëm që kau i ri e tërhiqte parmendën si i tërbuar dhe e rrëmbente brazdën shul, po laroj, që s'ja kish aspak fuqinë, hante të shpuarat e hostenit dhe gati sa s'vinte osh pas parmendës, me qafën që mënt i këputej te kulari. Iu rop qafa dhe iu bë plagë, s'ishte më i aftë për punë, se nuk mund ta mbreje, mezi çohet në këmbë kur deshën ta shpien për kullotë, sytë filluan t'i glepen e t'i qajnë, që të dhimsej si njeri me shpirt.

— There përpara se të ngordhë, — i tha grua-ja të shoqit.

Nkoll i dha asaj një të sharë e një thikë kaut, që perëndoi sytë e tij të mëdhenj me një drithë-

rimë, kurse prej katoit u dëgjua pëllitja e mëzatit që mbase ndjeu erën e gjakut. E kështu zikut, ndonse hyri në parmendë dhe ka u bë, emri i mbet mëzat, për egërsinë e tij.

«Ja, atë të kishin therur!» pohoi me vete Mara dhe lëshoi fshehtazi lot të valë për të mjerin laroj.

Sidoqoftë, ato dit hëngrën mish sa për tërë vitin e burrat pinë e bënë qejf. Shtëpia u mbush me farefis e miq. Herët e tjera, për Shmi, Nkolli kishte therur e tepërmja një dash, këtë radhë vuri nën thikë një ka. Buçiti kënga e çiftelia si për dasëm. Po Dava, e shoqja, vetëm steroi ato dit dhe s'e pat një fjalë të mirë as me burrin, as me njeri tjetër, as dhe me të bijën.

Ja dhe Ndoi i Margjinit erdhi e i foli shumë Nkollit në shtëpi për punë të kaut që theri. Ndoit nuk i mbushaj mendja se kau ishte bërë për të therur. Kau mund të mëkëmbej, thosh ai. Akoma me festat Nkolli e me prishje të tilla? Kështu na mëson partia? Puna s'kish për të mbetur me kaq: do t'ja ngrinin e do t'ja bënëin çështje në mbledhjen e frontit. Organizata e partisë e fshatit e kishte ngarkuar Nduen t'ja thotë këto Nkollit e t'ja thotë fort.

Edhe mësuese Agimja kishte folur për këtë gjë në shkollë, duke përmendur për të keq Nkoll Pergjokën. Kishte folur me zemërim mësuesja e kishte thënë se ata prind që bënëin prishje të tilla, pak mendonin për fëmijët e tyre. Mara ishte prekur rëndë e s'kish ditur ç'të bëjë. Ajo e kuptonte se i ati ishte me faj, po prapë s'i vinte mirë që mësuesja foli ashtu për të në mes të klasës. Kur guxoi e ja rrëfeu këto s'ëmës në shtëpi, nëna tha shkurt:

— Mësuesja ka të drejtë.

Mësuesja kish të drejtë, po a s'qe nëna që i tha babait ta therë laroin? Mara s'po merrte vesh! asgjë në tërë këto.

Kur Ndoi i Margjinit e qërtoi babanë për punë të kaut, babai deshi t'i çkarkohet nënës dhe u rrokën keq me fjalë. Marën s'e mirrte gjumi kur ata grindeshin gjer vonë. Nëna tha:

— Sherrin solle në shtëpi, që kur bëre atë që bëre! Shpjerja mëzatin të zot.

— Si, moj? Burri një fjalë ka! Ti mbyll gojën, se po e tepron! — e kërcënoi babai. — Mik si kam zënë unë, s'e ka zënë njeri.

— Sytë mos ja pafsha më keq se s'do t'ja shoh! — mori flakë nëna dhe babai se ç'ulëriti, bile ngriti dhe dorën, po nëna u çua në këmbë dhe, ashtu e lartë e e bukur si një nuse, me ata sy që lëshonin xixa, aq trimëreshë u duk përpara babait, sa ky ulëriti dhe një herë, po nuk guxoi ta godasë.

Marës i mbeti zemra dhe kur e ëma u shtri pranë saj, ajo iu fut e tëra në gjirin e ngrohtë e që mbante atë erë të mirë, dhe në ëndërr pa një thanë të madhe plot lule, ku nëna kish qëndruar e dukej sikur ta mbulonin ca qëndizma tërë bletë. Në katua, mëzati rënkonte tamam si ai laroi i shkretë që babai e kishte therur, kurse nëna, atje midis luleve, i thosh kaut «m'u bëfsh kurban!»

Më të aguar, Mara dëgjoi që nëna prapë bënte fjalë me babanë e i thosh:

— Më qafë e paç!

Vetëm tani e vogla nisi të mendojë për «mikun» që paskish zënë i ati me një ka. Thua ta kishin fejuar? Mara u rrëqeth kur e çoi mendjen te fejesa. Ajo nuk ishte më shumë se nëndë vjeç, po fejesën e dinte: prindi ja fliste çupën e tij një burri

dhe për këtë merrte edhe para (babai mori një mëzat!) Vajzat posa rriteshin, i dërgonin te burri, diku në një fshat tjetër. Ja kështu të kushërirën, Prendën, atë vit e kishin dërguar nuse në Kurbnesh. Ajo ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç. Po atë vit, kishin dërguar në Fang një tjetër kushërirë, Dilën. Për këtë thoshin se nuk ishte as gjashtëmbëdhjetë vjeç, po i ati se si e rregulloi që ta martonte jashtë moshës. Gjashtëmbëdhjetë vjeç ishte mosha, këtë Mara e kish dëgjuar. Kur të bëhej ajo gjashtëmbëdhjetë vjeç...

Mara i mendonte këto gjithë drojë, nemitej në vetvete me një çudi të madhe që ta kishin fejuar. Po ku? S'deshi të mendojë se ku. Dhe i shkuan lot se e kishin fejuar për atë mëzat të zi. Që atë ditë, së voglës i vinte të rrëmbejë sakicën e t'i lëshohet me të në kokë mëzatit, t'i marrë shpirtin. Atij mëzati që kishte sjellë aq të këqia, që kishte marrë më qafë të shkretin laroj, që do ta merrte edhe atë më qafë, si thosh nëna.

Kishin kaluar nja dy vjet. Mëzati sadopak ishte shtruar. Për mbjelljet e vjeshtës, Nkollli i gjente me qira një shok të fortë dhe lëvdohej se ngiste pendën më të mirë të fshatit. Po në shtëpi, me gruan ai shkonte keq e më keq. Mara e kishte harruar fejesën ose, më mirë, kur e kujtonte, i dukej tanimë si diçka e largët dhe e natyrshme. Veç ajo nuk kishte qetësi prej grindjeve të prindërve dhe nuk i shpjegonte dot.

Një ditë, vajza mori vesh se çështja ishte për mikun, të cilin, me sa kuptonte ajo, të gjithë e donin, veç nënës. Mara kish dëgjuar atë ditë gjyshen që i tha nënës:

— Burrë si ai!

Nëna guxoi e iu kthye:

— Që m'i varen qurret, marshalla! Më mirë mbahej im gjysh, Pal Maranaj, se lum miku ku na futi yt bir! Palé që s'kanë qenë të këtij pushteti! Me atë të lidheshim ne?

Gjyshja kishte çfryrë:

— Moj po ti na u bëre gjel në këtë shtëpi! Turp ai yt shoq, që s'të shtroi me dajak!

Marës i erdhi për të qeshur për mikun, ndonse u turpërua. Si tha nëna? I vareshin qurret! Miku s'na paska qenë as me pushtetin! Ç'e kish dashur atë mik babai? Kur ta merrnin vesh bota, ç'do të thoshin? Bota duhej ta kishin marrë vesh.

Nkollli s'ish aty. Mara sapo ishte kthyer nga shkolla dhe po përsëriste në oborr një vjershë mbi festën e çlirimit, kur dëgjoji t'ëmën që bëri fjalë me gjyshen lart në kullë. Plaka e mallkoi të renë e i tha se, që kur ajo futi këmbën në shtëpi të tyre, gjithë të zezat ranë mbi atë kullë, — dhe i numuroi gjyshja me radhë, që nga shirat e mëdha që rrëmbyen të korrat vitin kur u martua Nkollli, gjer te ato dy vjet të fundit që kish bërë thatësirë e madhe, e gjer te kau që therën. Nëna s'deshi t'ja dijë, po u tall, duke iu kthyer plakës:

— Pse s'thua që solla zinë në fshat e në krahinë, moj ti?

Mara e kuptoi talljen dhe, kur gjyshja filloi t'i derdhet edhe më keq nënës, e vogla shkoi e e mori t'ëmën për dorë dhe e nxori jashtë me të butë, që të shuhet sherri.

Ato shkuan të dyja në krua, nëna me bolirën e madhe, vajza me të voglën, të heshtura, dhe kur nëna mbushi bolirën e së bijës, asaj i gufoi gjoksi me një ngashërimë që, po të mos e kishte mbajtur,

do ta kishin dëgjuar bota arave. Çupa guxoi e i tha:

— Po kur të mos duash ti, moj nënë, ajo punë s'bëhet kurrë! Ç'ke ti?

E ëma e largoi pak prej vetes dhe e pa ashtu të trimëruar të bijën, me buzët e fryra në inat, me sytë ku lotët qëndronin e nuk binin, e shtrëngoi në krahë, e lëmoi e i puthi kokën pa fjalë, i lidhi pastaj mirë shaminë e zezë dhe i vuri bolirën në shpinë, u ngarkua dhe vetë e u kthyen si kishin shkuar, të heshtura, nën peshën e bolirave, po edhe të diçkaje tjetër shumë më të rëndë se bolirat. E vogla u harrua duke parë çapin e madh të s'ëmës se si e merre të përpjetën.

Rrugës, ato gjetën dy nga mësueset e katundit, Agimen dhe Zylfinë, që diku shkonin. Dava e Nkolli i desh fort mësueset dhe ato e deshën. Ajo kishte kryer shtatëvjeçaren dhe nuk rrinte pa lexuar ndonjë libër në shtëpi, kur e vidhte kohën. Mësueset vinin e bisedonin me të dhe Dava bënte pjesë edhe në këshillin e gruas së fshatit. Nkolli ishte grindur për këto dhe mësueset kishin filluar të duken rrallë në shtëpi.

— Po a ti je, moj Davë! — u gëzuan ato.

— U bëmë për të puthur, moj motra! — i mori fort në grykë malësorja.

Qëndruan një hop e u çmallën. Gruaja i pyeti për të bijën dhe Agimja vajzën e lëvdoi, duke thënë se, doemos, posa të mbaronte tetëvjeçaren e fshatit, duhej ta dërgonin në Rrëshen, të ndiqte edhe më lart mësimet. Gruaja ja bëri:

— Pa tjetër.

— Pa tjetër, po Nkolli... filloi dhe pastaj e preu fjalën mësuesja.

— Mos ki merak për këtë, tha Dava, gjysëm

si me inat e gjysëm duke buzëqeshur, si ç'e kishte shpesh zakon të shprehet, dhe i kishte vënë dorën te kryet së bijës.

4

Tamam atë natë, në shtëpi krisi një potere shumë më e madhe se të tjerat. Mara nëpër gjumë dëgjoi se nëna mallkoi «nikun e ri» për të cilin baba i kishte folur. Vajza tristoi dhe prindët e prenë bisedën. Të nesërmen, kur gjyshja e quajti edhe këtë mik «burrë që s'e ka shokun», iu hodhën kundër edhe axha me nusen e tij.

Ç'kishte ngjarë? Mos babai donte të fejonte të nipin, Prengën, dhe axha me nusen ishin kundër? Kundër ishte edhe më shumë nëna. Nëna këtë radhë u zemërua edhe më shumë se kur fejuan Marën. Vërtet ajo e donte Prengën fort, po ky tani ishte i rritur dhe po i afrohej koha për martesë. Pse të zemëroheshin këta kështu? Mos bëri gabim babai dhe s'e vuri syun ku duhej? Ç'ishte kjo kështu, që babai veç gabime bënte?

Edhe Prenga vetë dukej i pikëlluar. Po për çudi kur u kthye një ditë nga Shpali, ku vinte për zbor, ai i sollti Marës një kuti të vogël me llokume. Vajza u mat ta urojë, po kishte turp dhe e uroi me zemër, duke u ëmbëlsuar e duke menduar te një nuse perri të bukur, që do të vinte në shtëpi. Ja, si ajo Mrika e Pergjeçit, që kishte ardhur në katund të tyre nuse asaj vjeshte prej Kushneni. Nëna kish thënë se nuse e tillë s'ishte parë ka mot. Apo s'mori dhe atë farë djali ndër Pergjeçaj! Minator i dalluar në Spaç, me dy dekorata Zefi. Ja një nuse si të Zefit të merrte Prenga.

Po nusen e Prengës, me ç'dukej, s'e donte kush në shtëpi veç babait e gjyshes. Si ishte kjo punë? Më kot e çoi mendjen Mara te nusja e minatorit, që erdhi nga Kushneni, dhe më kot u përpoq të ëmbëlsohet. Llokumja iu for në grykë. Bile u hidhërua vërtet, kur Prenga diç i pëshpëriti gjyshes, që e qërtoi se prishi lekët e i solli llokumë cucës.

— Po mos nëm kaq, moj nënëgjyshe! iu lut vajza, duke i dhënë një llokumë.

Plaka, me llokumen në gojë e me sheqerin në buzë, akoma nëma lëshonte. Ja, këto e kishin bërë shtëpinë të paduruar!

Eh, sikur të kthehej në shtëpi vetëm natën vonë prej shkollë Mara, kur gjyshja flinte, kur edhe nënën me babanë t'i kish zënë gjumi e të mos shamatoheshin, dhe të futej tek e ëma, të kishte ngroh-të, të shihte ato ëndërra të bukura! Mësuesja kishte thënë ta dërgonin doemos në Rrëshen dhe nëna iu përgjigj «mos u bëj merak!» Të mos ishte çelur atë vjeshtë klasa e pestë në fshat të tyre, Mara do të ishte tani në shkollë të Rrëshenit. Atje do ta donin të gjithë e askush nuk do të grindej e askush nuk do të nëmte. Të gjithë do të vinin ta shohin me mall, kur të kthehej ajo për pushime, gjyshja vetë do ta priste e përmalluar dhe do ta uronte për llokumet që do t'i sillte e mbesa nga qyteti. Ndofta dhe babai me nënën do të pajtoheshin gjer ahëre dhe, sa për... E vogla nuk deshë ta kujtojë se diku e kishin dhënë, në shtëpi të një miku... Si gjyshi i nënës ishte miku... Vajzës, aty iu qesh, aty ndjeu turp e si tmer, dhe s'dinte ku të futej nga këto mendime që e mundonin e prej të cilave nuk fshihej dot.

Kur babai solli në shtëpi, një tjetër ka, nëna shkalloi dhe vajza u trondit shumë. Po kjo kështu

ç'ishte? Nuk po kuptonte asgjë ose, më mirë, nuk deshi të kuptonte. Të ish puna për fejesën e Prengës, s'kish përse babai të merrte një ka. Mos e fejuan Marën për së dyti dhe prishën fejesën e parë?» «Po si bëhet kjo, moj nëna ime?» donte të gërthasë e vogla dhe u çpërmend. E ëma më kot u përpoq ta sjellë në vete. Vajzën e kapëluan ethe të forta dhe, në përçart, shihte kaun e ri, një kuqoj më i bukur se laroj që u ther, gjithë shëndet edhe ai si mëzati. Tani ja kishin gjetur shokun mëzatis të zi: kuqali e kishte ndërur poshtë dhe e bëri copë me ata brirë të ngërthyer!

Mara nuk dëgjoi asgjë kur e ëma i tha të shoqit se ajo që kish vendosur ai s'kish për t'u bërë kurrë, sa të ishte gjallë gruaja, po kaun ta kthente prapë. Burri u tërbua. Ai këputi një hu prej gardhit dhe iu vërsul së shoqes ta godasë. Dava, si një çetinë, s'lojti vendit. Ajo i briti:

— Mbaj dorën, burrë se mban marren mbi vedi!

Gjela e Nikës që ishte në oborr, pat një kllithëm e u sul midis të dyve:

— Aman, lalë! Për krye të Marës! — iu lut Nkollit e kunata.

Burri flaku dajakun tutje dhe u fut në shtëpi me një qind të shara. E ëma qesëndisi:

— Këtë s'e kam pritur prej teje! E di se s'të vjen era burrë fare?

— Nënë! — gjëmoi Nkolli dhe e bija, që dergjej matanë, ndjeu një ankth të madh nëpër ethe, duke pyetur veten se ç'kishte ngjarë.

Nuk mënoi e në shtëpi erdhi daja i madh, Gjoni. Marën ethet e kishin lëshuar dhe nëna arriti t'ja mbushë mendjen se kuqojin babai e bleu, po shumë shtrenjt, kurse ata s'ja kishin vahtin. Nëna do ta kandiste babanë që t'ja kthente kaun të zot. Kështu tha edhe daja i madh. Mara deshi t'i besojë këto, megjithëse në shtëpi ishte folur për një «mik të ri» dhe, që të bëhej fjalë për nusen e Prengës, ajo s'kishte dëgjuar. Pyeti për nusen e Prengës dhe nëna i tha se Prengës do t'i zinin «një nuse shumë të mirë» dhe se do t'ja merrnin shpejt e kishin harxhe të mëdha, prandaj edhe nuk duhej blerë tani kuqoji.

Gjoni ndejti vetëm një natë. Në shtëpi atë natë ishte vetëm Nkolli me Nikën, të vëllanë. Ai i bëri nderin si i kishte hije, me mish e me raki, po nuk ftoi kend tjetër nga të fisit, që të ishin vetëm. Miku u përpoq t'ja mbushë mendjen me të mirë se kohët s'ishin po ato dhe se duhej sjellë ndryshe me gruan dhe vajzën. Dava kishte dhe shkollë e nuk mund të trajtohej ashtu si ç'bënte burri. Sa për fejesën e dytë të vajzës, këtë as Nika nuk e kish pëlqyer. Të zgjidhej një krushqi e të lidhej një tjetër, kjo nuk vinte fare! Pastaj, edhe mëzati duhej larë, e si do ta lanin? Pa ta mendonin pak me gjak të butë.

Nkolli i kishte kujtuar të kunatit zakon e kanun dhe i kishte lënë të kuptojë se ishte vetë zot në shtëpi. Vetëm vonë ata ranë si në ujdi që megjithatë burri të mendonte dhe një herë e të takoheshin prapë. Po gjer të mendonte Nkolli, rrodhi shumë ujë në krua.

Gjatë një ore mësimi të klasës së pestë, Agimja, duke marrë shkas nga një copë këndimi, foli për zakonet prapanike që ende jetojnë. Ajo tha se në shumë fshatra bëheshin gabime të rënda: disa prindër i fejonin fëmijët e tyre në moshë të njomë, me cilindo që t'u pëlqente dhe çfarëdo moshe që të kish, bile vajzat edhe duke i shitur. Kështu vajzat e djemtë në Mirditë dhe në malësi të tjera nuk martoheshin si donin e tek donin vetë, po si donte dhe tek donte prindi. Të merrte çupa e vogël një plak, si kishte ngjarë e po ngjiste kaq herë! Të shitej e të blihej njeriu me pare, si një kafshë! Kjo ishte një punë e shëmtuar, një krim. Partia ishte kundër këtyre zakoneve.

Kur mësuesja foli për kafshë, Mara u cenua thellë dhe s'dinte ku të futej. I dukej sikur të gjithë atë po shihnin, atë që e kishin këmbyer me një mëzat! Thua se mësuesja e dinte se si e kishin fejuar Marën, pa dhe foli ashtu? Apo ashtu ishin fejuar dhe të tjera?

Mësuesja tregoi me zemërim se ato dit në Kabinar, një çupë e kishin fejuar që në djep dhe fëmijëve u erdhi për të qeshur. Lezja e Gjetës u ngrit e tha:

— Bash si nënën time, zjushë: atë e kishin fejuar që në djep; në djep ish edhe babai; kështu kam dëgjuar në shtëpi.

Kështu tregoi Lezja dhe fëmijët hapën sytë, hem të çuditur, hem për të qeshur, kur mësuesja vuri buzën në gaz dhe e pyeti Lezen:

— Po ty, moj xhane, a mos të kanë fejuar?

Nxënësja shtangu. Faqet iu bënë prush. Sytë

e saj donin të ulen, po ngelën ashtu të ngrirë, të çakëritur. Ta kishin fejuar? Lezja ishte ndër vajzat më të mëdha të klasës, po kishte mbetur e imët dhe dukej më e vogla e shoqeve. Mara, që ishte në një klasë me të dhe ndonjë mot më e vogël, veten e ndjente të madhe përpara Lezes.

Agimes i erdhi keq e i tha fëmijës:

— Ty mbase nuk të kanë fejuar, moj xhane. Po në se është e vërtetë, na e thuaj.

Lezja nuk foli. Ajo s'dinte gjë. Edhe mund që e kishin fejuar. Nënë e saj e kishin fejuar që në djep, pse të mos e kishin fejuar që në djep edhe Lezen? Vajzës i hypi një turp i madh, ajo qëndronte në këmbë dhe shihte mësuesen po me ata sy. Ta kishin fejuar që në djep, si nënën?

Nëna ishte nga një fshat shumë i largët, nga Domshtjefni, dy ditë udhë prej fshatit të tyre. Lezja s'kishte vajtur kurrë në fshat të nënës edhe pse atje kishte gjyshër e daja që vinin rrallë e tek në shtëpi dhe që e donin. Nëna e kishte «plagë në shpirt» se i kish aq larg njerëzit e vet, si thosh. Ku ta kishin fejuar Lezen, në ndonjë fshat të largët si Domshtjefni? Vërtet ta kishin fejuar? Që në djep?

Vajzës i kalonin këto nëpër tru si një histori e ngjethëshme, që aty për aty po shpikëj për të. Fëmijët ishin kthyer nga ajo dhe prisnin të rrëfejë se si e kishin fejuar. Kështu priste edhe Mara. Po Mara ishte mbledhur e bërë sa një dorë atje në bangon e saj, në mes të klasës, dhe sikur kishte humbur ndër shokë.

Mësuesja vajti e iu ul Lezes pranë, e mori me fjalë të mira e me përkëdhelje:

— Ti ç'ke që trembesh, moj shpirte? Kush tha se të kanë fejuar? Unë ashtu pyeta, kot. Ti s'di të të kenë fejuar. Mirë, shumë mirë. Hajde pra, qetohu. Bëji ca vend mësueses, të rri këtu me ty.

Kur mësuesja tha këto fjalë, Lezja u duk se u tremb edhe më fort e u droqth e tëra. Ajo belbëzoi me zërin që i merej dhe me sytë që i venin e i vinin:

— Po, dhe mua më kanë fejuar si nënën, zjushë! Që në djep më kanë fejuar, larg, gjer përtej Domshtjefnit të Pukës!

Në klasë u ngrit një pëshpërimë e madhe. E paskëshin fejuar Lezen! Përtej Domshtjefnit të Pukës! Marës i vajtën sytë mbi hartën e Shqipërisë te muri, kërkoi atje Pukën, e gjeti dhe iu duk kaq larg sa më s'bëhej nga Shpali e Rrësheni. Mësuesja kishte nxjerrë shaminë dhe e kish vënë te sytë. Ajo nisi të kollitet, që nxënësit të mos e kuptojnë se po qan, po se i dalin lot prej kollës. Veçse të vegjlit nuk gënjehen në të tilla raste. Shumë vajzave iu mbushën sytë, kurse Mara fshehu kokën pas shoqes së bangos dhe desh ja dha për pak vajës.

Po sikur ta kishin fejuar edhe atë në fshat të nanës, në Orosh? Këtë pyetje s'ja kish bërë vetes kurrë, ndonse ishte përpjekur të marrë vesh se ku e kanë fejuar. I erdhi gati mirë kur mendoi te Oroshi. Atje kishte një gjyshe tjetërsoj prej gjyshes që kishte në shtëpi. Ajo nuk nëmte kurrë, po mjaltë i rridhte prej goje. Dhe dinte ca përralla gjyshja e Oroshit. Dhe bënte ca lodra për kalamajtë, për cucat! Dhe ca petulla me sherbet! Dhe ç'grua e pashme që ishte, si nëna! Kur shkante ajo

për ujë, bolirën e shpinës e kish dy herë më të madhe se shoqet; kur kthehej nga pylli, barrën e druve e sillte sa një mal! Palë kur milte dhinë, me ato duart e ngarkuara me unaza: zjente kusia nën duart e saj.

Ta kishin fejuar në fshat të gjyshes Marën? Po gjyshen, si e fejuan? Në djep, si Lezen? Po nënën?

Nëna s'fliste për këto. Vetëm një herë kish dëgjuar Mara që nëna të thotë një fjalë për fejesat, kur Gjini Preku fejoj para dy vjetësh Marën e tij në Zajs: një çupë dymbëdhjetë vjeçe me një burrë dyzetësh! Nëna kish buçitur:

— Ç'janë këto që po bëjmë akoma? Kohët ndryshuan dhe ca si ne mbetën po rob pylli!

Nëngjyshja e qërtoi:

— Ti mos fut hundët tek s'të bie! Robi do bëjë si ka urdhëruar zoti.

— Zoti! Ç'është ai zot që e çon Marën në konak të shtriganit!

— Tyt, moj e pafe! përpoqi gjyshja pëllëmbën te vatra dhe nëna i ktheu shpinën e doli, me kindat e fundit të bardhë që i bënin valë, kurse e bija iu vu pas dhe e pyeti, sikur të mos kish-te marrë vesh tamam se ç'ngjau:

— Pse, e fejuan Marën e Gjinit, moj loke?

E ëma s'iu përgjigj, po e rrëmbeu në gji dhe ja plasi të qarit atje pas koçekut në fund të oborrit. Qau edhe e vogla pas asaj dhe as ajo s'e dinte tamam përse, për fjalët e rënda të gjyshes, apo për fejesën e Marës së Gjinit. Sa çupa ishin fejuar e martuar në fshat e s'qante njeri për to? Të qante nëna për Marën e Gjinit? Nëna e kish gjetiu: ajo ishte me sedër të madhe e me gjyshen

ishin parë hëna prapë. Po dhe që të prishte gjakun me gjyshen, a ja vlente barra qeranë? Gjyshja edhe babait s'ja kursente, edhe axhës. Mos e trajtonte më mirë dhe nusen e axhës? Kë merrte me të urtë gjyshja? Ajo të tillë huq kish dhe nuk do ta ndërronte.

Kështu e uli vajin vajza bashkë me t'ëmën, dhe u çuan të dyja të lëshojnë dhinë, se po kalonte vapëhera. Nëna këtë radhë nuk e la vetëm me dhinë Marën, vajti me të dhe këmbyen plot fjalë, po as për Marën e Gjinit folën, as për gjyshen në shtëpi. Ato folën për gjyshen në Orosh dhe për dajat. Nëna bëri hesap se kur mund t'i vinte radha që të merrte vajzën e të shkante me bujtë të vëllezërit. Për fat të keq, ato nuk shkuan në Orosh. Muajin tjetër, babai solli në shtëpi mëzatin dhe, që ahëre, u ndez grindja e madhe që nuk po shuhej për fejesën e çupës.

Tani që Mara i kujtonte gjithë këto, pas fjalëve të mësueses dhe pasi Lezja tregoi se e kishin fejuar që në djep, përtej Domshtjefnit të Pukës, vajza ndjente një të keq të madh që babai ta kish këmbyer me një ka, me një mëzat, — e pse jo dhe me kuqojin? I vinte vërtet të pështirë. Ishte në ankth se mos po e pyet edhe atë mësuese Agimja, si pyeti Lezen. Si t'i përgjigjej? Po ndofta mësuesja e dinte. Bobo! Mësuesja e dinte, që e kishin shitur, shitur për një mëzat. Për një mëzat ta kishin shitur dhe Lezen? Lezja nuk kishte as mëzat as ka në shtëpi. Po atë e kishin fejuar që në djep dhe, që ahëre, mëzati do të kishte ngordhur. E si nuk ngordhi ky mëzati i tyre, si s'e çau një ujk, po babai theri të shkretin laroj! Kuqoji kish për t'ja treguar qejfin mëzatis! Po kuqojin ku e kish gje-

tur babai? Thua vërtet ta kishte blerë, ashtu si thoshte nëna? Mos e kish gënjyer nëna Marën, që ta qetojë? Bobo!

Kur Lezja tha se e kishin fejuar që në djep, mësuesja vuri shaminë te sytë, u koll fort e fort nëpër lot dhe pastaj e pyeti:

— Shpik gjë nga koka, ti moj vajzë, apo e ke me gjithë mend?

Lezja tkurrej e s'merrej vesh se ç'desh të thotë, se po, se jo. Më në fund, ajo mërmëriti:

— S'e di, zjushë!

Në klasë u bë një pështjellim i vërtetë. Mësuesja hem e mori me të mirë Lezen, hem e qortoi. Dhe me kaq, ra zilja e mbaroi ajo orë aq e rëndë.

Në të dalë, Agimja e zuri Marën për dore dhe e pyeti:

— Si e ke nënën?

— Mirë, të falem nderit, u përgjegj e vogla me një fije zëri, e zbetë e gati sikur po i binte të fikët.

— T'i bësh të fala nga unë, shumë të fala. Na dhe këtë libër për të, — dhe nxori nga çanta një libër e ja dha.

Mara lexoi titullin e shtypur me gërma të kuqe, «*Nuk ka perëndi*», dhe e vështroi mësuesen me kureshtë. Kjo, si shkarazi, e pyeti:

— Mos ka sjellë babai në shtëpi një ka këto kohët e fundit, moj cucë?

Marës desh i ra libri nga dora. Ajo nuk pati guxim ta shohë mësuesen në sy dhe nuk iu përgjigj, po tundi kokën në shenjë pohimi.

— Mos e solli nga Bajza? — pyeti prapë mësuesja.

Mara rudhi krahët. Ajo s'e dinte nga e solli kuqalin i ati. E paske sjellë nga Bajza, nga Bajza buzë liqenit të Ulzës.

— T'i thuash nënës se babai nuk bëri hiç, hiç mirë, që e solli atë ka nga Bajza. T'i thuash se do vi të flas unë me të.

Mara deshi t'i tregojë se edhe nëna nuk e priti hiç mirë kaun dhe se ishte shamatuar për këtë me babanë. Asnjeri s'e priti mirë kaun në shtëpi, veç gjyshes. Babai kishte bërë gabim që e bleu, sidomos tani që do të fejonin Prengën. Po si t'ja thosh këto mësueses? Agimja i puthi faqen dhe u ndanë.

Vajza pyeste veten, e turbulluar: në Bajzë ja-në kooperativë dhe fshatarët s'kanë qe të vetët; si e solli kaun prej andej babai? Po mund që e kishte blerë ai miku kasten për të. Mbase dhe në-na s'e kish gënjyer Marën.

7

Mësuesja nuk erdhi në shtëpi.

Ato dit, posa u muar vesh se ç'bisedë kishte pasur ajo me nxënësit, në fshat u bë zhurmë e madhe. Plot qenë ata që folën kundër mësueses. Pse përzihej kjo në zakonet e vendit? Nja dy vetë kishin kërkuar të mblidhej këshilli i frontit dhe t'i jepnin mësueses një dru të mirë. Ajo po ndërhynte në punët e fshatit. E merrte me mend se po ngatërronte njerzit dhe se mund të kriste keq? Kush i pat ndaluar fejesat në mituri? Le të shihte veten mësuesja, që i kish kaluar të njëzetat dhe s'kish gjetur burrë. Po me shpenzimet e martesës,

pse merrej? Mos i dilte gjë prej qeses asaj? Shpenzimet për të blerë nusen s'ishin më si motit, po gjysëm për gjysëm më të vogla, sa për një pajë të thjeshtë, që ajo duhej të sillte me vete...

Mara dëgjoi në shtëpi babanë që fliste me axhën për këto punë. I ati ishte egërsuar vërtet kundër mësueses. Ai ja kishte thënë me kohë nënës se nuk i pëlqente të vinte ajo çupë në shtëpi.

— E ka llapën e madhe, — thosh. — Nuk i rri goja. Të shporret nga katundi.

Babai kishte thënë se edhe organizata e partisë ishte marrë me këtë çështje, po nuk dihej se ç'kishte dalë. Sidoqoftë ai besonte se partia do të mbante anën e mësueses. Shumë shokë nuk e njihnin se çfarë mendje pupël ishte ajo. Kryetari i këshillit qënke i një mendje me babanë, po ai s'ishte në parti. Ai duhej t'u mbushte mendjen dhe atyre të partisë për këtë çështje. Axha i tha babait të mos ngatërrohej në këtë punë, të mos ngutej, se ngjiste ndonjë gjë e papëlqyer. Mësuesja ishte nxituar, po ishte vajzë e mirë. Axha tha dhe një fjalë që Marën e bëri të mendojë: «zakonet e vjetra s'e kanë të gjatë, tha ai; sot, mot, rinia s'ka për t'i mbajtur». Ahere babai u nxe e thirri:

— Sa të jem unë gjallë, zakoni s'luan në shtëpi time! Kur të mos jem unë...

— Urtë e butë, urtë e butë, or vëlla — e këshillonte axha.

Mara ishte trembur se mos e dbojnë mësuesen, por kur e shihte nënën shumë të kënaqur nga ç'kishte ngjarë e po ngjiste, çupës i vinte dhe asaj mirë se po përzejehet fshati për punë të fejesave dhe se, prej kësaj, «veç një e mirë mund të delte»,

si thosh nëna. Nëna i kishte thënë nuses së axhës një ditë kur po ktheheshin nga pylli:

— Po s'u turbullua, nuk kthjellohet, moj Gjelë.

— Aman, motër, pusho! iu lut e kunata. — Do na krisë ligësht në vatër.

— Më keq se ç'ka krisur, ç'do krisë?

— Kam frikë, të keqen motra! Mos! Ne si e gjetëm do ta lemë. Këto zakone zor se ndryshojnë ndonjëherë.

— Do ndryshojnë që ç'ke me të! — U ndez nëna. — Cilit po i mban krah partia, kryetarit tonë apo mësueses? E mbylli gojën kryetari. Më kot shtyret im shoq. Mësuesja nuk është gaberre si kryetari. Të bukur kryetar që kemi zgjedhur! Ai iu bë shkas Gjini Prekut për tri mijë lekë. E se mos vetëm Gjinit. Prit, se për hundësh do t'i dalin të gjitha. Po ç't'i thuash këtij tim shoqi, që nuk po merr vesh se ç'ngjet në këtë dynja!

— Mos folë ashtu, moj Davë! — iu lut nusja e axhës duke i britur pastaj çupës që kishte qëndruar atje përpara e po mbante vesh: — Tutje, moj ti! — e nënës i tha: — Po kryetarin e kemi fis, moj motër.

— Lere cucën të dëgjojë, — ja preu nëna. — Kryetarin fis e kemi, po më fis kam time bijë se kryetarin, a po merr vesh?

Nusja nduku faqet e s'bëri më fjalë. Asaj i kishte hyrë data nga gjithë këto që po ngjisinin, kurse nëna mori sy dhe donte «të turbullohej», sepse ndryshe «s'kishte për t'u kthjelluar gjë». Nëna ishte me mësuesen dhe Mara ndjente një hall, po edhe një gëzim që s'e fshihte dot.

· Në kullë të Pergjokajve thuase kishte rënë

zia. Nkolli hynte e dilte i ngrysur, me fjalën të pakë, po gur hobeje, gati t'i hidhet kujt në fyt për asgjë. Kështu që askush nuk guxonte të ndjehej nëpër shtëpi. Edhe e shoqja s'bënte zë. Po Davës i flisnin sytë. Nika rronte me një hall të madh e nuk përzjehej as ai në fjalë me të vëllanë. Pren-gës i shëndriste nuri, po dhe ai heshtëte, si të tjerët. Gjela hapte sytë sa te njeri e te tjetri, se mos pëlçet këtu apo aty, dhe sillej nëpër shtëpi gati si e shushatur. Nënëgjyshja, që nuk dinte se ç'kish-te ngjarë në shkollë dhe ç'zjente nëpër fshat, nu-haste se diçka shkonte shumë ters, përpiquej të kuptojë gjë nëpër atë heshtje të çuditëshme në-për fytyrat e sjelljet e njerëzve, nënte këtë dhe atë, i ngucte me mënyrat e saj, po më kot. Mara donte me qenë t'i bërtasë në vesh, «po pri-shet dynjaja, gjyshe!», ashtu si ç'passe thënë një plak i fshatit: po ç'mund të bënte e vogla, veç të heshtë, me shpresë se punët kishin marrë për mirë dhe me besimin se mirë e për më mirë do të merrnin?

8.

Një ndajnate, kur ishin mbledhur të gjithë në shtëpi dhe po bëheshin gati të hanë, lehën qentë e trökiti porta. Prenga shkoi e e hapi dhe, kush na ngjitet lart? — Agimja me drejtorin e shkollës!

Nkollit, që kishte marrë një copë prush të ndezë çibukun, i mbeti masha në dorë. Dava, po-sa dëgjoi zërin e mësuesve, nxitoi me kandilë në krye të shkallëve dhe u përqaftua me gaz të madh

me Agimen. Gjyshja që po dremiste pranë vatrës, nuk mori vesh se ç'po bëhej atje matanë.

Më në fund, i zoti i shtëpisë doli në odë të miqve dhe u përfal me ta. Mara përgjonte te dera, kurse e ëma hynte e dilte, me shkak e pa shkak, sillte herë një minder e herë një jastëk, ngacmonte fitilin e llambës, i fuste dhe një dru zjarrit, apo i ulej mësueses pranë për një çast, këmbente me të ndonjë fjalë me zë të ulët, i merrte dorën e i shtrëngonte krahun, tërë përkëdhelje, si një motër e madhe për të voglën.

Nkolli këmbëu edhe ai ndonjë fjalë me drejtorin, po ftohtë-ftohtë, — për kohën që kishte mbajtur mirë e për mbjelljet që u kryen, për dëborën e parë që ra asaj jave e për të tilla, për duhanin, që ai e pinte pa hesap e që i jepte atë flamë kolle. Këtë ves na e paske pasur edhe drejtori, i cili më në fund, vërtet më mundim, po e kishte lënë dhe ra rehat.

— Eh! Sikur ta linte babai duhanin, thoshte Mara «Ç'ishte ky huq i çuditshëm, të fusë e të nxjerrë njeriu tym në bark?» ja bënte nëna, kur desh ta shponte gjyshen, që dhe ajo e pinte duhanin keq dhe bile me çibuk, si burrat. Gjyshja, që në raste të tilla e hante shakanë, ja kthente:

— Prit kur të plakesh, pa dhe ti ke për ta pirë si shoqet, e, në mos me llullë, duhan paqeti. Helbete, ju nuset e sodit!

Gjela e dboi nja dy tri herë vajzën nga dera ku vinte dhe përgjonte edhe ajo vetë, ndonse duhej të gatuante për miqtë, dhe ishte tërë hall, se kush e di ç'do të ndodhë. Dava hynte e dilte e s'i thoshte gjë, as së bijës, as së kunatës.

Nika shkoi te miqtë pasi kreu disa punë në katua dhe nëpër shtëpi. Dhe tamam kur ai hyri në odë, drejtori i shkollës ja nisi:

— Kemi ardhur për një lutje tek ti, shoku Nkoll. Ti je burrë i mençur dhe do na kuptosh drejt. Nusen e ke me shkollë e anëtare të kryesisë së gruas.

Nkoll i dëgjonte e s'bënte zë, po çibuku gati sa s'i kërciste te dhëmbët. Drejtori vazhdoi:

— Shoqja Agime, mësuesja e klasës së pestë, e do fort vajzën tuaj dhe për Davën ajo ka një nderim të veçantë. Grua si Dava, zor se gjendet në fshat, thotë.

— Qoftë me nder, tha nëpër dhëmbë Nkoll dhe ja pështolli fytyrën tymi i çibukut, që iu kap te mustaqet e te vetullat e trasha. — Qoftë me nder.

Drejtori ndoqi fjalën:

— Agimen e kemi mësuese të mirë dhe e çmojmë si ne në shkollë, si partia. Ka ardhur me vullnet të saj në këto malësi, si mund ta dish. Është familje dëshmori e më pëlqen ta them.

— E kemi dëgjuar, — tha Nika. — Kjo parti është e popullit dhe kur u vra për të, është vrarë për ne.

Drejtori vështronte Nkollin që pohonte me kokë dhe shkundte çibukun pas pëllëmbës që iu mbush me hi.

— Fole mirë, — iu kthye drejtori Nikës. — Po e keqja është se këto ditë nëpër katund janë thënë ca fjalë për mësuesen.

— Jo prej nesh, — e ndërpeu Nkoll.

— Jo, besa — e mbështeti këtë i vëllai.

— S'ka rëndësi fundi-fundit që njerëzit nuk

po kuptojnë se janë ca zakone, të cilat me kohën nuk venë fare, apo jo, moj shoqja Davë?

Gruaja nuk foli, po gjithçka në fytyrën e saj tregonte se ajo ishte e një mendje me drejtorin. Nkollit iu kthye bishti i çibukut së përpjekuri pas pëllëmbës dhe e flaku në zjarr. Biseda po merрте keq. Marës i rrihte zemra me vërtik.

Nkolli e urdhëroi të shoqen ashpër:

— Ecë e më sill një çibuk tjetër!

Gruaja doli dhe e bija iu vu pas, vetëm që të jetë pranë saj e të shohë se mos është lënduar nëna. Po nëna gati sa nuk fluturonte nëpër shtëpi. Ajo kërkoi kamaret e pragjet e oxhakëve dhe nuk i gjeti një, po katër a pesë çibukë, të punuar nga babai me dashuri e kujdes, veç të nxirë e të djegur si mos më keq. Pas s'ëmës, gati sa nuk fluturonte dhe vajza. Të dyja ishin të gëzuara, sikur të kishte ardhur për to dita e madhe.

Por kur u kthyen tek oda e miqve dhe Mara qëndroi përsëri prapa derës, Nkolli i thoshte drejtorit:

— Të vdesim ne pleqtë njëherë dhe le të gro-posen pastaj edhe zakonet bashkë me ne.

— Ti je akoma i ri, — qeshi drejtori.

— Aty te pesëdhjetat, — bëri sikur qeshi Nkolli. — Merr robi huqe të tjera në këtë moshë?

— Komunistët këmbyen shumë gjëra, more shok. Kush besonte se do përmbysen Markagjonët? E kishe besuar ti?

Nkolli tundi kokën për jo.

— Zakonet e liga na i lanë Markagjonët, — vërejti drejtori.

— Ato janë më të moçme, — tha Nkolli. — Po a s'i lemë një herë këto fjalë, or shoku Ahmet?

Për këtë punë ne zor se merremi vesh me një darrkë. Ju kam mysafirë e më pëlqen të bisedojmë e të bëjmë qejf. Kur do na sjellësh atë raki, ti moj? — i foli ai së shoqes, që prapë doli ashtu fluturimthi, po këtë radhë me fytyrën të prishur, kurse Mara iu vu pas kokëvarur.

Vajza dëgjoi se mësuesja diç i tha babait, po, kur ktheu te dera, dëgjoi t'anë që u përgjigj:

— Në këto punë, ndër ne, moj mësuese, nuk janë përzjerë kurrë gratë.

— Haha! — qeshi me të përdhunë drejtori. — Po kohët ndryshuan, or ti Nkoll. Mirdita nuk është më ajo e kanunit. Gratë marrin pjesë në pushtet e në parti, në front e gjithëkund, barabar me burrat.

— Barabar, barabar, përçmonte buzët Nkoll. — Po punët e shtëpisë nuk janë punët e hallkut, shoku drejtor. Ç'i duhet tjetrit se ç'bëj unë në shtëpinë time, me gruan time, me fëmijët? Mos erdhi vahti që kalamajtë të na i fejojnë të tjerët? Apo do t'i fejojë shkolla?

Dava pruri një tepsi të ngarkuar me gota e meze, — turshi, djathtë, qepë. Ajo i dëgjoi këto fjalë dhe u ngrys edhe më shumë. Nkoll, që diktoi të bijën pas derës, i gërthiti:

— Marë! Luaj ti!

Vajza nuk diti nga t'ja mbajë. Më në fund, ajo vendosi të hyjë, e turpëruar, e i dha dorën drejtorit, u përqaftua me mësuesen, kurse babai do të kishte dashur të zhdukej e i tha:

— Tani shko.

Se ç'u bë më tej, vajza s'e mori vesh, se nuk pati guxim më të qëndrojë te dera. Po ajo dëgjoi se matanë po binte çiftelia e se po këndonte herë

axha dhe herë drejtori. Drejtori ishte gojanas e çiftelisë ja dinte. Ai këndoi disa këngë të reja për partinë e dëshmorët, por dhe një këngë të vjetër, atë të cucës që mjerohet se kërkojnë t'i japin një plak e «plakut i vjen era cja», dhe që shendohet se merr një të ri «era jasemin». Matanë u dëgjuan të qeshura: qeshte mësuesja dhe qeshte drejtori, qeshte edhe axha me të madhe, qeshte edhe babai si me përtesë. Qeshën e u shkulën gazit edhe nëna me nusen e axhës këndeje, e Mara mezi e mbante gazin që desh t'i shpërthente. Gjyshja nëpër dremkë u lëshoi një nëmë.

Kur u kthye Dava te miqtë, drejtori po thosh:

— Partia është kundër këtyre zakoneve, pra ndaj edhe ne duhet t'i hedhim prapa krahëve, or shokë. Ti Nkoll, merre atë ka që solle në shtëpi e ktheja të zot. S'e kam mirë, o Nikë?

Ky uli kokën e nuk bëzajti, po kuptohej përse: nuk desh t'ja prishë qejfin të vëllait.

— Ç'thua ti, moj Davë? — pyeti mësuesja.

Gruaja nguroi një çast e pastaj ja bëri me zë pak, po prerë:

— Janë dy qe që u duhen kthyer të zotërve.

Nkollit iu errën sytë. Ndonse fytyrën ja rrihte flaka e vatrës, ai u duk si dylli. Vetëm kaq shqiptoi:

— Unë s'e turpëroj veten ndër shokë!

— Do ta nderosh në sy të partisë! ja pat drejtori.

Burri heshti.

— Ti sikur s'paske dëgjuar asgjë për Kongresin e pestë që patëm kësaj vjeshte, — tha me qërtim drejtori.

Nkolli ngriti kokën e ja bëri:

— Unë fola për shtëpinë time... Po si thua? A po sjellim të hamë, or mik? Darkën, moj ti, e urdhëroi ai grua e pastaj si në pendim, foli: — Këto punë do gjejnë udhë, do gjejnë o shoku Ahmet... Me atë çifteli besa na kënaqe sonte. Si thua, ja thomi dhe ndonjë kënge? Hajt, me zemër të mirë. Ty të rrofshin ç'ke për zemër e kësaj mësueses t'i hamë dasmën! T'u turrsha, o Nikë, e trokiti ai me të vëllanë. — Pije dhe merre ti atë çifteli dhe një herë.

Drejtori, sikur të mos i kish dëgjuar këto, iu përgjigj:

— Kongresi i partisë merret me të gjitha. Partinë e kemi të gjithë të parë shtëpie.

— U bëftë ajo e partisë! — uroi Nika. — Të kam gjetur shoku Ahmet!

Nkolli uroi:

— Të bëftë mirë, o Nikë!

Dava doli të sjellë bukën.

9.

S'kaloi as java. Nkolli s'pati kohë ta marrë veten nga kjo bisedë, kur u hap fjala se kudo nëpër malësi po formoheshin kooperativat. Lajmi plasi në shtëpi si bombë. E solli Prenga prej Shpali, bashkë me gazetën. Dava rrëmbeu gazetën dhe nisi ta këndojë me zë. Aty tregohej se në Librazhd e diku tjetër, malësorët ishin ngritur peshë e po formonin kooperativat. Davës sikur i kërciste zëri, Prenga nuk përmbahej nga gëzimi. Ai tha:

— E pat tani! Mori flakë! Është radha e malësisë.

I ungji shtrembëroi fytyrën po nuk foli.

— S'mund të rrinim më prapa shokëve, vërejtji Dava dhe palosi gazetën.

— Çfarë shokësh, moj? — pyeti gjyshja, duke hapur sytë.

— Do bëhemi kooperativë! — i briti Mara në vesh.

— Mos! — u pre gjyshja dhe bëri kryqin. — Folë, more Nkoll!

— Kështu thonë, tundi kokën e shogët i biri.

— Do bëhemi, se s'bën, — tha Prenga dhe pohoi Dava me qejf.

— Pusho, more ti! — iu gërmush i ungji. — Kush të pyet ty? Në Mirditë s'është dëgjuar aq-oma gjë.

— Dashke të të bjerë daullja te dera, ti, — tha Prenga, — Prit se tash po të bjen. Folë baba, — i u kthye ai t'et.

— Kjo është punë e mbaruar, — tha Nika.

U bë një heshtje. Të gjithë vështronin Nkollin. Ai kafshonte thinjat e mustaqeve dhe shkundte me fuqi çibukun pas pëllëmbës së nxirë. Gjyshja ndiqte të rrahurat e çibukut, e mekur, e tretur, sikur atë natë do t'i jepte fund jetës së vet të gjatë e të mundimëshme, me atë lajm, që për të dukej si lajmi i exhelit. Zëri iu hoq zvarrë:

— Demek do na marrin tokën, bagëtinë, qetë! nëkoi e lidhi duart, duke përsëritur: — Pendën e qeve!

— Pendën e qeve, të parën, shtoi Dava si pa të keq.

— A, moj ti e paudhë! nëkoi plaka. — Ti për këso ditësh je lutur e gëzon.

— Ashtu vërtet, — ja ushqeu fjalën Nkollin,

që te këndi i vatrës s'e çonte kokën të shohë njeri me sy, po akoma shkundte kot e kot çibukun.
— Kjo kujton se ç'keni për të fituar po prit, prit.

— Edhe në paçim për të vuajtur në fillim, se s'do t'ja dimë punës, më keq se ç'kemi parë a do shohim? — guxoi e tha gruaja.

— Gëzo, gëzo, zgërdhihej burri dhe s'ngrinte kokën.

Mara u drithtua. Tek do të pëlciste! Ajo rroku nënën pas fustanit, që t'i bëjë të kuptojë të heshtë. Nëna, përkundrazi ja shkrepiti:

— E pse të mos gëzoj? Përse të mos gëzoj dhe unë si tërë bota? Ç'i kemi gëzuar kësaj jete kështu? Pa ecë e shih Perlatin. Që sivjet e bënë bukën. Dy vjet kooperativë... Kanë ndryshuar bota që t'i kesh zili. Ti vetë ke treguar se ç'po bëhet andej nga Lezha e Bregmatja. S'mbeti njeri pa ngritur një shtëpi të re. Pa shih kullën tënde: mirë që s'e gremisën këta murrllanë të fundit.

— Po fryn një murrllan tani... ja bëri pikë e vrer i shoqi.

— Po fryn, besa, po fryn! u hodh përsëri gruaja. — Ka se ç'të gremisë e të shembë.

— Demek ti je që të shëmbet, të përmbysset? — grahu më në fund burri. — Ti me kanunin s'je. Doemos do na jesh me kooperativën. Ndahen këto?

— Me sa duket jo, — ja bëri gruaja.

— T'i lemë këto muhabete, — ndërhyri Nika. — Pa ta gjykojmë mirë.

— Unë e kam gjykuar! — ja pat i vëllai. — Unë s'hyj!

— S'hyn, po... deshi të thotë diçka Prenga.

— S'hyn është një fjalë goje, po ta bisedojmë një herë shtruar, — vijoi Nika.

— I parë shtëpie jam vetë! — u xhindos Nkoll dhe brofi në këmbë e iku nga oda.

Gjela i pëshpëriste të shoqit:

— Mos e verë re. Është me inat. Do ulet, do bjerë. Me të mirë, me të mirë!

Davës i vinte keq për të kunatin që ishte kërrusur mbi vete, këmbëkryq, sikur ta kishin lidhur e ta godisnin me një qind shkopinj.

Prenga, që mezi kish duruar aty mënjanë, u shpraz:

— Ky parillëku po na ha të gjallë! Po unë s'pyes! Unë jam i pari që do të futem! Mall e gjë s'dua! Kam krahët! — u ra ai krahëve.

E ëma i bënte shenjë me dorë që të heshtë, kurse Dava pohonte çdo fjalë të tij me kokë. Gjyshja përsëriste për të katrën a të pestën herë:

— ...edhe pendën e qeve!

— Aman! kur të mos i shoh më në shtëpi! — gulçoi Dava dhe doli edhe ajo prej konakut, duke vënë pëllëmbët te fytyra.

10.

Dita nuk vonoi, që të mblidhte fshatin për të formuar kooperativën.

Gjer atë ditë, Mara rronte me gëzimin e fshehur se shpejt mëzatin e zi, me gjithë kuqoin më nuk do t'i shihte në shtëpi, kurse gjyshes i ishte ngulur në tru vetëm ai hall, se do t'i merrnin «edhe pendën e qeve». Sikur për inat të gjyshes bëhej tërë kjo! Marës i vinte keq për të. Donte t'i

shpjegonte se ç'është kooperativa, po druhej. Një herë, i kish treguar për një kooperativë të Myzeqesë, për të parën kooperativë në Shqipëri, që libri i leximit e rrëfente të lumtur. Plaka kish dëgjuar me interes, po në fund kishte pyetur:

— Mal janë atje apo fushë?

— Fushë.

— Në fushë misri gjithëherët me tre kallinj është bërë. Ne kemi lindur këtu, ku ha pula gur. Këtu njeriu ngordh vetëm e jo me shokë. Sa lugë mund të hanë në këtë çanak? i kish treguar ajo çanakun e dhallit, që sapo e kish mbaruar së gjerburi.

— Po ata të Myzeqesë nuk e kishin fare të veten tokën, moj nënëgjyshe, kishte shpjeguar përsëri e mbesa. — Tokën atje e kishin bejlerët. Ata s'i llinin fukarasë asgjë, po ja merrnin të gjitha. Fukaraja ngordhte për bukë, thotë libri, se punonte në tokë të botës.

— Unë punoj në tokën time! — ja kish këputur plaka. — Denbabaden! Kokrrën e misrit që bëj, e ha vetë!

Flitej me gjyshen? Ajo të përpinte të gjallë. Ajo s'desh të marrë vesh. Si ishte prerë do të grisej, me çibuk në gojë e me nëma. Po babai, i shkreti baba! Për të i vinte keq fort vajzës. Ai, nga një anë, i ngjante gjyshes dhe ishte aq kokëfortë sa ajo, që të mos e desh kooperativën, kur e desh nëna, mësuesja, partia, të gjithë. Babai kishte miq gjer në Krujë e në Shkodër. Po le të shihte Bajzën, prej ku sollti kuqojin. Në Bajzë Mara kishte qenë një herë me shkollën, kur panë hidrocentralin «Karl Marks» vitin e kaluar dhe vizituan edhe kooperativën. Atje punonin traktorët radhë, kodrave e buzë

liqenit. Mara kishte parë edhe një kooperativë të fushës në film, kur erdhi vjet kinemaja në fshat me mushkë. Grunjat ishin si det. Kopeja e derrave sa të bashkoje dhënt'e dhitë e tërë lokalitetit të Shpalit. Kështu kish thënë ahëre babai. Elektriку e radioja brënda. Shkolla si pallat, si në Rrëshen. Nga një kooperativë e tillë thosh se ish mësuese Zylfia, kur u shpjegonte filmin.

— Kjo ditë s'ka për të ardhur ndonjëherë tek ne? — kish bërë e mrekulluar nusja e axhës.

Babai kishte qeshur me të kumatën e i kishte thënë:

— Të hyri cmira, nuse!

— Pse s'kam të drejtë, or lalë? — ish nemitur nusja.

— Keq s'e ke, — i kishte thënë babai.

Tani babai s'i jepte të drejtë nënës e askujt, po mbante tjetër avaz. Atë avaz mbante gjyshja, që s'merrte vesh farëgjëje.

Ditën që do të mblidhej fshati për formimin e kooperativës, Nika i tha të vëllait:

— Unë e kam vendosur të mos ndahem nga bota.

— Nga bota jo, nga vëllai po! Bukuri! — ja pat Nkollli. — Na ndave se na ndave!

— Jo, se na ndave vetë, po mendohu pak! — foli gruaja.

— Mos kërkon dhe ti të bashkohesh me shokë? — u tall e zverëtiu i shoqi.

— Nuk thua keq, po s'më qas njeri pa burrin, — mahiti dhe Dava nëpër buzë.

Nkollli shastisi nga kjo përgjigje.

— Demek, burri po burrë! Kanuni po kanun!

Dhe ti kërkon të lash hesapet me të! — zjeu ai tërë helm.

— Me të i lan hesapet kanuni i partisë! — mori flakë Dava. — Po shiko se e ke keq. Ndërro mendje sa s'është vonë. Në kooperativë do futesh, se tjetër udhë s'ka; po ndryshe është të futesh sot, me gjithë katundin, ndryshe të lutesh për t'u futur nesër e të të thonë, «prit ta shohim njëherë, se ti që s'hyre, palë ç'ke ditur, që s'e paskemi ditur ne». Mos na ndaj shokësh e vëllazërie, se është turp e faqja e zezë.

Nkollin më mirë ta kish goditur rrufeja. Ai nuk tha gjë, po u çua si i tërhuzur, shkoi gjer në fund të odës, u kthye prapë e ngriti dorën t'i bjerë gruas, po i vëllai i mbërtheu krahun, duke iu ngërmuar:

— Përpara meje, jo! Jo kështu! Mblidh mendjen! Kjo s'të ka faj dhe s'të ka pasur kurrë! I ke rënë më qafë kot!

Mara qante në një kënd të odës, midis dy arkash, sikur të kishte marrë fund çdo gjë në shtëpinë e tyre. Dava qëndronte në mes të odës me kokën lart e me duar grusht në kraharor. Gjyshja atje te vatra bënte kryqin dhe diç mërmëriste sa nga i biri, sa nga e reja. Nkolli u ul dhe ai pranë vatrës, këputi kokën mbi gjoksin leshtor dhe ulëriti një dy-tri herë rëndë e më rëndë:

— Posi, bre! Posi, bre!

Në shkallë u dëgjuan këmbë dhe hyri Ndoi i Margjinit me një shok tjetër partie.

— Ngreu, Nkoll! — tha Ndoi, pa u përshëndetur mirë me njerzit. — S'mbeti njeri pa u nisur në mbledhje. Pse ju me kaq vonesë? Ngreu.

— Dhinë e vetme e ha ujku, — ja bëri shoku i tij.

Nkollu u çua dhe zbriti shkallët ngadalë-nga-dalë sikur t'i numuronte. I vëllai i vinte pas, me pushkën hedhur në sup, dhe i tundte kokën Davës buzëqeshur e si me qërtim. Dava qëndronte ashtu siç e kish zakon, e drejtë po shumë e zbetë. Te buza e në sy i dridhej një gaz, që tregonte se kish fituar. Ajo i zgjati dorën së bijës dhe të dyja zbritën pas burrave. Gjela shkonte e fundit, duke bërë fshehurazi nga një kryq. Rrugës, ajo shtrëngohej pas së kunatës e përshpëriste:

— Ah! moj Davë, moj gjarpnushë!

Një herë, e kunata ja ktheu:

— Është puna për ty e për mua, motër.

— Po pse, ç'na ka gjetur, moj?

— Na ka gjetur, që sot e kësaj dite na trajtojnë si kafshë!

— Dhe do na shpëtojë kooperativa?

— Do ta marrish vesh shpejt a vonë se na shpëton.

Mara e dëgjonte dhe s'e dëgjonte bisedën. Ajo e kish mendjen të qetë, që së shpejti nuk do t'i shihte më në shtëpi, sikur gjithë të zezat të zhdukeshin bashkë me mëzatin e kuqojin që do të iknin.

Me vitin e ri, kryesia e kooperativës nisi të mbledhë gjënë e gjallë të tepër nëpër fshat. Nkollit i binte të dorëzojë nëntë kokë dhi.

Po ish vendosur që kryesia e kooperativës të merrte dhe të dy qetë, t'ua dërgonte të zotërve, e kështu të mbyllej ajo histori. Nkollu vetë e kërkoi këtë nder.

Atë ditë, burri ishte si ndër ethe. Si ndër ethe ish e tërë shtëpia. Po Davës i shkëlqente çuditërisht nuri, bënte ndonjë punë e s'bënte asgjë, dhe çqetësohej përse nuk vinin akoma ata të kryesisë. Nja

dy herë, ajo dërgoi edhe Marën matanë bregut, të shohë se mos po vinë, kurse ata vonoheshin dhe tërë shtëpia rronte si ndër ethe, e ndofta më shumë se të tërë Mara.

Nënkryetari, Ndoi i Margjinit, erdhi me dy shokë dhe u fut në vathë bashkë me Nkollin e Nikës. Ata ndanë shtatë dhe u nisën tatëpjetë bregut me Prengën.

Nëna kishte zënë për dore vajzën dhe rrinte nën qemerin e portës së kullës, kur anëtarët e kryesisë hynë në oborr, u përfalën me të dhe u futën në katua. Mëzati pëlliti një herë, pastaj ato të dyja panë turirin e kafshës, të zi pisë e me tërë atë njollë të bardhë përmbi buzët e përveshura, mbi hundën e shtypur dhe syun që vërgëronte. Veshi i tij i djathtë iu duk Marës shumë i madh. Dhe sa e llahtarëshme ajo fytyrë e jargavitur! Mëzati u kaloi përpara, batall, i zi pisë, sikur të dilte nga nata, dhe as e ktheu noçkën nga ato, po shtynte përpara kokën e tij të madhe me ata brirë si hej, duke u mblaçitur me një si mëri të shurdhët. Ai iku tatëpjetë dhe u zhduk si një hije që ta përpinte rruga e bregut. Kuqoji i shkonte pas, i rëndë dhe ai, po me tërë butësinë e një kau të urtë. Ai diç përpoqi këmbën pas një guri, kur kaloi përpara vajzës e nënës, dhe vështroi nga ato me dy sy të hutuar, sikur të desh të kuptonte se ç'po ngjet, se përse po ikën. Nëna s'u mbajt, po nëmi, kur ai u pengua:

— Qafën thefsh!

Së voglës i erdhi keq e zgjati dorën ta prekë, po kau kaloi dhe ajo s'e preku dot.

Ndoi, që kishte vënë qetë përpara, erdhi e i dha dorën nënës, e i fërkoji flokët vajzës. Ai tha:

— Do t'ua kthejmë të zotërve që nesër.

Nëna nuk foli, ndërsa Mara pat një të pështirë të tmershme e u kap pas s'ëmës me të dy duart. Dava kafshoi buzën kur i nguleshin në mish gishtat e së bijës, ajo përcolli ngashërimën që i ishte bërë tokël në fyt, hodhi një vështrim të hakërritur nga rruga teposhtë dhe, kur s'i pa më kafshët e pushtoi një qetim i madh. Lot të lira ja mbuluan fytyrën.

Tutje, mbi ledhin e arës, cicërinin gushëkuqët. Bënte një diell i dashur. Vajza ndjeu mirë kur i vanë sytë te zoqtë e u shtrëngua dhe një herë pas s'ëmës me tërë fuqinë. Babai kaloi përpara tyre kokulur, i vrrarë, i dërmuar. Ai hodhi nga e shoqja dhe e bija një sy fajtor, ato i hapën rrugën dhe burri u fut në shtëpi e ngjiti ngadalë-ngadalë shkallët e gurta.

31 Shoket M. Hako

32 Shoket M. Hako

33 Shoket M. Hako

34 Shoket M. Hako

35 Shoket M. Hako

36 Shoket M. Hako

37 Shoket M. Hako

38 Shoket M. Hako

39 Shoket M. Hako

40 Shoket M. Hako

41 Shoket M. Hako

42 Shoket M. Hako

43 Shoket M. Hako

44 Shoket M. Hako

45 Shoket M. Hako

46 Shoket M. Hako

47 Shoket M. Hako

48 Shoket M. Hako

49 Shoket M. Hako

50 Shoket M. Hako

L E N D A

Fytyrat e thjeshta të heroizmit. <i>R. Brahimi</i>	3
Atje ku ndahen dy botë <i>S. Sallabanda</i> — <i>K. Gjeçi</i> ..	10
Për jetën e shokut <i>F. Kosturi</i>	21
Shokët <i>M. Hako</i>	31
Shoqëruesi <i>Ll. Çuçi</i>	38
Ndërgjegjia e ushtarit <i>R. Bedo</i>	49
Në dëborë e në tufan <i>T. Laço</i>	55
Trau i fundit i soletës. <i>D. Hasani</i>	68
Pejsazhi <i>N. Jorgaqi</i>	76
Legjenda e ujit <i>S. Andoni</i>	84
Shkallët e gurta <i>Dh. S. Shuteriqi</i>	93

Tirazhi 6000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë 1968